



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 1/2021 regjistër (JR)  
Datë 08.01.2021

Nr. 5 i vendimit  
Datë 21.02.2023

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

|                        |                  |
|------------------------|------------------|
| <b>Albana Shtylla</b>  | <b>Kryesuese</b> |
| <b>Ina Rama</b>        | <b>Relatore</b>  |
| <b>Natasha Mulaj</b>   | <b>Anëtare</b>   |
| <b>Mimoza Tasi</b>     | <b>Anëtare</b>   |
| <b>Rezarta Schuetz</b> | <b>Anëtare</b>   |

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 21.02.2023, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Willem Brouwer, me sekretare gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Fjoralba Prifti, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 299, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës; Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, si dhe në parashtrimet para seancës, dëgjoi relatoren e çështjes, gjyqtaren Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Fjoralba Prifti (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës, të miratuar me anë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, ushtronte detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe, për shkak të këtij funksioni, në zbatim të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Për subjektin e rivlerësimit nga Komisioni janë zhvilluar hetime për të tria kriteret e rivlerësimit dhe bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016 janë administruar raportet e vlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).
  - 2.1. ILDKPKI-ja ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera ka përcjellë në Komisionit një raport kontrolli<sup>1</sup>, tek i cili, në përputhje me pikën 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ky organ ka arritur në konkluzionin se:
    - deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
    - nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
    - ka kryer fshehje të pasurie;
    - ka kryer deklarim të rremë;
    - subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave;
  - 2.2. DSIK-ja ka përcjellë në Komision raportin<sup>2</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, më datë 14.02.2018, të hartuar në zbatim të kërkesave të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, me të cilin ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit Fjoralba Prifti.
  - 2.3. KLGj-ja, për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ka përgatitur një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar, i cili i është përcjellë Komisionit.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 299, datë 17.09.2020, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Fjoralba Prifti, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë [...].*
4. Vendimi, për subjektin e rivlerësimit Fjoralba Prifti, është marrë nga Komisioni mbështetur në konkluzionet si vijon.
  - a) **Në lidhje me vlerësimin e pasurisë:** *Nga vlerësimi i përgjithshëm i pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga geramat “b”, “c” dhe “ç”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, të cilat të vlerësuara së bashku, të çojnë në konkluzionin se duhet zbatuar pika 3, e*

<sup>1</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 24.05.2018.

<sup>2</sup> Raporti i DSIK-së mban nr. {\*\*\*} prot., datë 30.01.2017 dhe është përcjellë në Komision me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.01.2019, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 24.01.2019, të KDZh-së.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 13.05.2019.

nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili e vë atë në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, si një shkak ligjor për zbatimin ndaj saj të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

**b) Në lidhje me vlerësimin të figurës:** Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës. Konstatimet e gjetura gjatë hetimit mund të vlerësohen në raport me vlerësimin profesional apo në vlerësimin në tërësi të çështjes, të subjektit të rivlerësimit, znj. Fjoralba Prifti, brenda përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016.

**c) Në lidhje me vlerësimin profesional:** Në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

### **III. Shkaqet e ankimit**

5. Kundër vendimit nr. 299, datë 17.09.2020, të Komisionit ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit Fjoralba Prifti. Nga analizimi i përmbajtjes së ankimit, konstatohet se ai përmban pretendimet e subjektit të rivlerësimit për cenim të procesit të rregullt ligjor, si dhe pretendime që kundërshtojnë konkluzionet e Komisionit për vlerësimin e pasurisë.
6. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”): *Ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 299, datë 17.09.2020, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Fjoralba Prifti.*

#### **A. Shkaqe të ankimit lidhur me procesin e rregullt ligjor**

7. Në drejtim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, lidhur me shqyrtimin e çështjes së saj nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit Fjoralba Prifti, pretendon se:

**7.1.** Vendimi i Komisionit është marrë në shkelje të procedurave dhe të parimeve të procesit të rregullt ligjor pasi:

**(i)** Trupa gjykuese e Komisionit, që ka gjykuar çështjen, duke u përcaktuar si e tillë me short, është në kundërshtim me përcaktimet e nenit C të Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon që Komisioni të ketë 4 trupa gjykuese të përhershme me nga 3 anëtarë secila, duke bërë që kjo trupë gjykuese të jetë formuar në kundërshtim me ligjin; **(ii)** Trupa gjykuese e Komisionit nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme, sikurse e kërkon ligji, pasi: (a) Komisioni duke qenë një organ disiplinor duhet të përbëhet nga gjyqtarë; (b) kur një organ disiplinor si Komisioni luan një rol në hetimin paraprak nuk mund të ketë edhe rol në vendimmarrjen e çështjes, pasi kemi të bëjmë me një dublim të funksioneve, i cili ngre dyshime për objektivitetin dhe paanshmërinë e anëtarëve; **(iii)** Komisioni ka treguar njëanshmëri dhe paragjykim në marrjen e vendimit, pasi ka bazuar vendimin në fakte të pavërteta apo i ka deformuar ato, duke paracaktuar dhënien e masës disiplinore; **(iv)** Komisioni ka mbajtur standarde të dyfishta, lidhur me vlerësimin e pasurisë paramartesore të ndryshme nga jurisprudenca e tij e deritanishme; **(v)** Komisioni nuk i ka akorduar subjektit një kohë të arsyeshme dhe proporcionale për dhënien e përgjigjeve/shpjegimeve gjatë hetimit administrativ; **(vi)** Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrë prove në mënyrë të paarsyeshme dhe jo proporcionale në kundërshtim me nenin D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; **(vii)** Komisioni nuk ka respektuar të drejtën e subjektit për t’u dëgjuar; **(viii)** Komisioni ka cenuar të drejtën e subjektit për një jetë private; **(ix)** Komisioni ka abuzuar në ushtrimin e diskrecionit dhe vlerësimin e pamundësisë objektive të subjektit për të paraqitur dokumente; **(x)** Komisioni ka zbatuar keq ligjin nr. 84/2016.

**7.2.** Vendimi i Komisionit nuk respekton parimin e sigurisë juridike pasi:

(i) Masa disiplinore e dhënë nga Komisioni nuk bazohet në shkelje të konstatuara si të kryera prej subjektit të rivlerësimit, por prej bashkëshortit të saj dhe, si të tilla, ato nuk kanë të bëjnë me sjelljen e gjyqtarit; (ii) Masa disiplinore për subjektin e rivlerësimit nuk mund të jepet nga një këshill disiplinor për shkelje apo mangësi në deklaratimet periodike vjetore të pasurisë (në vijim “DPV”) e të bëra dekada më parë dhe për probleme, që nuk kanë të bëjnë me sjelljen e saj.

## **B. Shkaqe të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

8. Për të ardhurat nga veprimtaria e përkthimit të bashkëshortit provohet burimi i ligjshëm i krijimit të tyre (në periudhën para dhe pas martese) dhe se mosprovimi i pagesës së detyrimeve tatimore, për shkak të pamundësisë së gjetjes së dokumenteve për shkak të kohës së largët, nuk mund t'i bëjë këto të ardhura të konsiderohen si jo të ligjshme, pasi kjo situatë kërkon aplikimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

9. Për pasurinë nr. {\*\*\*}, apartament banimi, me sip. 121,79 m<sup>2</sup>, me vlerë 78.000 euro dhe pasurisë nr. {\*\*\*}, garazh me sip. 17 m<sup>2</sup>, me vlerë 12.000 euro, në Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet e Komisionit, sipas së cilave ajo dhe personi i lidhur gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për financimin e tyre, janë të padrejta e të pabazuara në prova dhe në ligj, duke pretenduar se:

(i) Të gjitha pagesat e bëra për këto dy pasuri (apartament + garazh), si para dhe pas martese janë financuar nga të ardhurat e personit të lidhur me burime të ligjshme nga puna e tij e provuar si përkthyes, duke pretenduar se këto të ardhura duhet të përfshihen në analizën financiare, si të ardhura për çdo rast, vit pas viti, kur provohet kjo marrëdhënie punësimi/angazhimi/shërbimi.

(ii) Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të rremë në deklaratën *vetting*, për sa i përket natyrës së marrëdhënies juridike, nëpërmjet së cilës bashkëshorti ka përfituar shumën 30.000 euro të përdorur si burim për krijimin e pasurisë, është tërësisht i padrejtë dhe i gabuar, pasi: (a) huaja e marrë nga personi i lidhur (bashkëshortit) prej babait të tij, provohet të jetë krijuar me burim dhe të ardhura të ligjshme të krijuara nga familja e origjinës së bashkëshortit, të cilat janë deklaruar në deklaratën *vetting*; (b) subjekti pretendon se kjo hua duhet konsideruar si detyrim para martese dhe vetjak i bashkëshortit të saj dhe jo si një detyrim i bashkësisë familjare.

10. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji rishikimin e analizës financiare të kryer nga Komisioni (për periudhën pas martese), kryesisht në vitet me diferencë negative 2003, 2006, 2007, 2008 dhe 2010.

11. Subjekti i rivlerësimit i kundërshton duke i konsideruar si tërësisht të pabazuara dhe të pavërteta konkluzionet e Komisionit se, duke mosdeklaruar veprimet financiare të kryera prej saj në emër të vëllait (e pajisur me prokurë prej tij) ka synuar t'i përjashtojë ato nga hetimi i ILDKPKI-së, por edhe nga verifikimi i Komisionit gjatë procesit të rivlerësimit, dhe se ka dashur të fshehtë marrëdhënien e saj me pasurinë e vëllait, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 dhe neni 33, pika 5/c e ligjit nr. 84/2016.

12. Subjekti i rivlerësimit pretendon që çështja e saj duhet të analizohet në Kolegji, në kuptim të përcaktimeve të nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi edhe në versionin kur për një pjesë të të ardhurave të siguruara nga puna e bashkëshortit nuk pranohet pagesa e detyrimeve tatimore, këto të ardhura nuk janë më shumë se 2-fishi i pasurisë së ligjshme, për të cilën provohet pagesa e detyrimeve tatimore që ajo dhe bashkëshorti disponojnë.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Shqyrtimi i çështjen në Kolegjin e Posaçëm të Apeliimi

###### a) Juridiksioni i Kolegjit

13. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashkuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit Fjoralba Prifti, vendim të cilin nëpërmjet ankimit subjekti synon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### b) Legjitimimi i ankuesit

14. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 e ligjit nr. 84/2016.

###### c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

15. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 299, datë 17.09.2020, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Fjoralba Prifti, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.

15.1. Kolegji shqyrtoi fillimisht parashtrimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në Kolegji<sup>4</sup> 7 ditë para seancës gjyqësore, si dhe aktet<sup>5</sup> bashkëlidhur tyre, në të cilat ajo i qëndron të gjitha pretendimeve të ngritura me ankimin, kërkon ndryshimin e vendimit objekt ankimi dhe konfirmimin në detyrë. Kolegji konstatoi se në parashtrime subjekti i rivlerësimit sjelljen e akteve bashkëlidhur tyre nuk e lidh dhe as e analizon, në kuptim të përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se barrën e provës për shkeljet e konstatuara nga Komisioni e ka vetë subjekti i rivlerësimit dhe as argumenton ekzistencën, në kushtet e kërkuara nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim ligji nr. 49/2012), e cila ka passjellë mosmarrjen/sigurimin e këtyre akteve përgjatë hetimit administrativ në Komision. Nga përmbajtja e akteve të sjella nga subjekti me parashtrimet para seancës gjyqësore, Kolegji konstaton se kërkimet e subjektit për marrjen e tyre i përkasin kohës pas dhënies së vendimit të Komisioni objekt shqyrtimi, e dhënë e cila përjashton aplikimin e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.

<sup>4</sup> Në datën 13.02.2023.

<sup>5</sup> Aktet që subjekti i ka bashkëlidhur parashtrimeve të saj të datës 13.02.2023, janë përkatësisht: (i) shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 09.02.2023, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë; (ii) kërkesa e subjektit pranë DRT-së Tiranë, protokolluar me nr. {\*\*\*} prot., datë 06.02.2023; (iii) fotokopje të prokurës nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 24.12.2015; (iv) fotokopje të shkresave nr. {\*\*\*} prot., datë 12.02.2020, nr. {\*\*\*} prot., datë 29.06.2020 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 30.07.2020, të DRT-së Tiranë, kopje e të cilave ndodhen në dosjen e Komisionit; (v) kopje të deklaratave të z. E. P., si person fizik tregtar me NIPT {\*\*\*}, për vitet 2020, 2021 dhe 2022; (vi) të dhënat e llogarisë bankare për E. P., në “Alpha Bank”, për vitet 2005-2006.

15.2. Në përfundim, për sa u përket akteve të paraqitura me parashtrimet para seancës gjyqësore, Kolegji vlerëson se, në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk legjitimohet që këtij akti procedural t'i bashkëlidhë akte me pretendimin për marrjen e tyre si provë, sepse afati për të paraqitur prova të reja shtrihet maksimalisht deri me paraqitjen e ankimit dhe nuk mund të zgjatet përtej tij.

15.3. Kolegji vlerësoi, gjithashtu, edhe nevojën e marrjes së këtyre akteve, në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, parë lidhur me zbatimin e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 dhe duke analizuar nevojën për të shqyrtuar këto prova të reja në seancë gjyqësore publike, në funksion të zgjidhjes së çështjes. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji konstatoi se informacioni që japin aktet e sjella nga subjekti, bashkëlidhur parashtrimeve, i referohet informacionit për detyrimet tatimore të bashkëshortit të subjektit për vitet 2020, 2021 dhe 2022, të cilat i përkasin periudhës pas rivlerësimit apo risjellje të akteve, tashmë të administruara në fashikullin e hetimit administrativ të Komisionit, siç janë shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 12.02.2020, nr. {\*\*\*} prot., datë 29.06.2020 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 30.07.2020, të DRT-së Tiranë apo të dhënat e llogarisë bankare për E. P., në “Alpha Bank”, për vitet 2005-2006. Në analizë të kësaj situatë faktike, Kolegji çmoi se ekzistojnë kushtet për refuzimin e marrjes së këtyre provave, sipas parashikimit të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016,

15.4. Në këto rrethana, Kolegji vlerësoi se çështja mund të zgjidhej në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi, duke u mbështetur në të gjitha aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, që referon te neni 49 i ligjit nr. 49/2012.

## **B. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit**

### ***I. Shkaqe lidhur me pretendimet për cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit***

16. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *trupa gjyqësore e Komisionit që ka gjykuar çështjen, duke u përcaktuar si e tillë me short, është në kundërshtim me përcaktimet e nenit C të Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon që Komisioni të ketë katër trupa gjyqësore të përhershme me nga 3 anëtarë secila, duke bërë që kjo trupë gjyqësore të jetë formuar në kundërshtim me ligjin*, analizohet sa vijon.

16.1 Subjekti këtë shkak ankimi e ngre në drejtim të formimit në tërësi të trupave gjyqësore prej Komisionit, përfshirë edhe trupën që ka kryer procesin e saj të rivlerësimit kalimtar, duke pretenduar krijimin e tyre në kundërshtim me ligjin, duke e krahasuar këtë proces me procedurat e përzgjedhjes së trupit gjyqësor nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji fillimisht vëren se Komisioni veprimtarinë e tij e kryen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, i cili në nenin 15 të emërtuar “Organizimi i Komisionit” përcakton rregullat për shpërndarjen e çështjeve në trupat gjyqësore të Komisionit, përzgjedhjen e komisionerit relator dhe atij kryesues. Duke iu referuar veprimtarisë së Komisionit, konstatohet se ky organ veprimtarinë e tij e kryen nëpërmjet 4 trupave gjyqësore të përhershme të përbëra me nga 3 komisioner secila dhe hedhjen e shortit e organizon për një listë subjektësh, duke përzgjedhur se cila nga 4 trupat gjyqësore të përhershme të krijuara tashmë do ta gjykojë një çështjen konkrete. Pas përzgjedhjes së trupës gjyqësore, po me short, përcaktohet edhe komisioneri relator.

16.2 Për sa i përket pretendimit të subjektit se termi “trupa e përhershme” nënkupton që ato të vazhdonin të tilla të pandryshueshme deri në përfundimin e mandatit, Kolegji e konsideron si një qëndrim jo të bazuar ligjërisht dhe në situatën faktike, duke sjellë në vëmendje se zbatimi i kësaj dispozite në mënyrë të unifikuar ka demonstruar se kuptimi i termit “trupa e

përhershme” i referohet përcaktimit të një trupe, sipas një shorti të hedhur për një grup të caktuar subjektsh.

Trupa e përhershme, sipas interpretimit të subjektit, do të zvogëlonte mundësitë teorike dhe praktike të një përzgjedhje rastësore për trupat gjykues, duke ulur ndjeshëm transparencën dhe spontanitetin në përcaktimin e trupave gjykues, si elementë të shtuar që garantojnë objektivitetin dhe paanësinë e procesit të rivlerësimit. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pretendimi i ngritur prej subjektit, jo vetëm që nuk është i mbështetur në ligj, por edhe do të çonte procesin në një drejtim të kundërt, për sa i përket garancive për një proces të rregullt, ndërsa mënyra se si Komisioni ka përcaktuar trupat gjykuese dhe ka interpretuar dispozitën e cituar më lart ka prodhuar rritje të transparencës dhe të garancive procedurale në drejtim të paanësisë e objektivitetit të trupave gjykues. Për më tepër që subjekti në çdo rast ka pasur të drejtë të ngrejë konkretisht pretendimet e saj për konflikte interesi për secilin nga anëtarët e trupës, nëse këto situata do të provoheshin, si një mjet për të garantuar sërish gjykimin e paanshëm dhe objektiv, pretendime të cilat nuk rezultojnë të jetë ngritur në rastin objekt gjykimi.

**16.3** Për sa i përket pretendimit të nënshkakut se: *Trupa gjykuese e Komisionit nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme, sikurse e kërkon ligji, pasi: (a) Komisioni duke qenë një organ disiplinor duhet të përbëhet nga gjyqtarë; (b) kur një organ disiplinor si Komisioni luan një rol në hetimin paraprak nuk mund të ketë edhe rol në vendimmarrjen e çështjes, pasi kemi të bëjmë me një dublim të funksioneve, e cila ngre dyshime për objektivitetin dhe paanshmërinë e anëtarëve*, Kolegji konstaton se:

**16.4** Këto pretendime të subjektit janë çështje, të cilat janë trajtuar tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit, e cila i ka konsideruar ato të pabazuara ligjërisht, qëndrim të cilin, gjithashtu, e ka konfirmuar edhe GjEDNj-ja në arsyetimin e çështjes *A. Xhoxhaj vs Shqipërisë*, në të cilën analizohen këto aspekte të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri<sup>6</sup>.

**16.5** Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se *Komisioni ka treguar njëanshmëri dhe paragjykim në marrjen e vendimit, pasi ka bazuar vendimin në fakte të pavërteta apo i ka deformuar ato, duke paracaktuar dhënien e masës disiplinore*, Kolegji analizon sa vijon.

---

<sup>6</sup> Në vendimin e GjEDNj-së në çështjen *A. Xhoxhaj vs Shqipërisë*, në paragrafët 284, 286 dhe 288, lidhur me funksionet e Komisionit dhe Kolegjit, konkludohet sa vijon:

284. *Krijimi dhe funksionimi i Komisionit dhe Kolegjit janë parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës, plotësuar më tej nga nenet C dhe F të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, të miratuar nga Parlamenti. Sipas mendimit të gjykatës, ato ofrojnë një bazë ligjore mjaft të qartë për krijimin e organeve të rivlerësimit, përgjegjëse për kryerjen e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë (shih paragrafët 103, 106, 112, dhe 122-128 më lart). Fakti se organet e rivlerësimit u krijuan vetëm me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, u parashtrua edhe në vendimin nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafin 169 më lart). Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se, për qëllimet e nenit 6/1, një gjykatë nuk ka nevojë të jetë një gjykatë e integruar brenda mekanizmit standard gjyqësor. Ajo mund të krijohet për të shqyrtuar një çështje specifike, e cila mund të administrohet në mënyrë të përshtatshme jashtë sistemit të zakonshëm të gjykatës (shih Mutu dhe Pechstein, cituar më lart, paragrafi 139) [...].*

286. *Në çështjen në fjalë, trupat gjykuese të Komisionit dhe Kolegjit u krijuan në përputhje me ligjin, domethënë më anë shortimi. Kërkesja nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë specifike në lidhje me procedurën e formimit të trupave gjykuese. Pas shqyrtimit të të gjitha çështjeve të faktit dhe ligjit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi për çështjen e kërkuarës. Në shkallën e dytë, atë të apelit, Kolegji shqyrtoi shkaqet e ankimit të paraqitura nga kërkuarja dhe kishte juridiksion të plotë mbi çështjet e fakteve dhe ligjit [...].*

288. *Në këto rrethana, gjykata arrin në përfundimin se, duke pasur parasysh faktin se si Komisioni, ashtu dhe Kolegji ishin krijuar dhe formuar në një mënyrë legjitime duke përmbushur kërkesat e një “gjykatë të krijuar me ligj”, kërkesja i ishte adresuar “Gjykatës”, sipas kuptimit të kushtit të parë të testit Vilho Eskelinen. Për këtë arsye, neni 6/1 i Konventës gjen zbatim nën aspektin civil të saj.*

**16.6** Subjekti i rivlerësimit këtë pretendim të ankimit e lidh me disa të dhëna të referuara në vendimin e Komisionit, për të cilat ajo pretendon se deklaratimet e saj lidhur me këto fakte nuk kanë qenë të njëjta me përmbajtjen që është përshkruar/zbardhur në këto paragrafë të vendimit.

**16.7** Në funksion të analizimit të këtij pretendimi, Kolegji vëren se mënyra se si trupa gjyquese e Komisionit i ka zbardhur në vendim qëndrimet/shpjegimet e subjektit duket se nuk është një riprodhim literal i deklaratimeve të saj. Pavarësisht këtij elementi, Kolegji vlerëson se jo domosdoshmërisht, Komisioni ka për detyrë të kryejë pasqyrime literale të asaj që deklarojnë subjektet, madje ndonjëherë kjo është e pamundur dhe e pakuptimtë, por, ajo që është e rëndësishme dhe duhet garantuar, lidhet me moscenimin e vërtetësisë së deklaratimeve dhe mosnxjerrjes së tyre jashtë kontekstit, në të cilat ato janë bërë, duke krijuar një imazh të deformuar të këtyre të dhënave. Konkretisht, në rastin në analizë (*që ka të bëjë me mënyrën e marrjes së fondeve të huas nga bashkëshorti i subjektit, si dhe me saktësimin e kohës së bashkëjetesës*), Komisioni, siç edhe vepron përgjithësisht, ka vlerësuar të japë një përmbledhje të informacionit që japin këto shpjegime, si dhe të informacionit që ka rezultuar nga kontrolli që ka kryer vetë Komisioni për llogaritë bankare të nënës së bashkëshortit të subjektit.

**16.8** Për sa më sipër, rezulton se subjekti, me përgjigjet e pyetjeve të Komisionit të datës 16.12.2019, ka shpjeguar për huan në shumën 30.000 euro se *bashkëshorti im më deklaron se shuma atij i është dhënë cash nga babai i tij dhe një pjesë e saj me sa kujton është tërhequr nga nëna e tij në bankë*. Për faktin që subjekti ka deklaruar se një pjesë e shumës është marrë nga nëna e bashkëshortit në bankë, Komisioni ka kryer hetim mbi lëvizjet e llogarive bankare të nënës së bashkëshortit, nga i cili ka rezultuar se kjo e dhënë nuk provohet. Për këtë arsye, duket se në vendim Komisioni ka pasqyruar në mënyrë të përmbledhur situatën, duke cituar deklarinimin e subjektit dhe bankat nga të cilat ka verifikuar të dhënat dhe më pas ka konkluduar se subjekti nuk arriti të provonte deklarinimin me dokumente ligjore.

**16.9** *Për sa i përket qëndrimit tjetër të Komisionit, të cilin subjekti e konsideron si referim të gabuar dhe të pavërtetë në vendim, që lidhet me momentin e fillimit të bashkëjetesës, që cilësohet se ka nisur kohë më parë se lidhja e martesës më datë 08.02.2006 (duke u nisur nga fakti se nga të dhënat e sistemit TIMS, rezulton se subjekti ka udhëtuar para martesë në vitin 2005 me z. P.), Kolegji vlerëson se:*

Fakti që ka të dhëna nga sistemi TIMS se subjekti ka udhëtuar me z. E. P. jashtë vendit, një vit më parë se ajo të lidhë martesë, nuk mjafton për të arritur në konkluzionin se midis tyre ka pasur një marrëdhënie bashkëjetese që në atë kohë, por duket se Komisioni e ka përdorur këtë të dhënë së bashku me kohën e lindjes së fëmijës së parë, si një element që ka lindur dyshimet për bashkëjetesën e tyre. Kolegji vlerëson se duke dalë nga konteksti i analizës së të dhënave private e personale të subjektit, ndonëse ato konsiderohen si të mbrojtura deri në nivelin që parashikon neni A i Aneksit të Kushtetutës, këto të dhëna nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se bashkëjetesa mes tyre ka nisur në një kohë të ndryshme nga ajo e martesës ligjore. Ky konkluzion ka rëndësi për këtë proces duke qenë se potencon dhe fokuson kontrollin e pasurive si një entitet i përbashkët gjatë kësaj periudhe, që përkon para lidhjes së martesës ligjore. Në këtë kuptim, ndonëse qëllimi i Komisionit duket se ka qenë vetëm në funksion të qartësisimit të kësaj të dhëne, Kolegji vlerëson se të dhënat e raportuara, ndonëse nuk provojnë faktin se bashkëjetesa e subjektit me bashkëshortin ka ekzistuar më parë, krijojnë prezumimin logjik se interesat e përbashkëta të bashkëshortëve të ardhshëm kishin filluar të krijoheshin para lidhjes së martesës së tyre ligjore.

**16.10** Për sa më sipër, këto situata të pretenduara si të referuara gabim në vendim nga Komisioni, Kolegji vlerëson se janë përfshirë në tekstin e tij me qëllimin për të dhënë informacion të përmbledhur, si për pretendimet e subjektit, ashtu edhe për hetimet e kryera. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se këto dy situata që subjekti identifikon, si me të dhëna të



referuara gabim në vendim, nuk duket se kanë pasur një rol përcaktues në vendimmarrjen e çështjes aq sa të pretendohet se shkelin parimet e procesit të rregullt ligjor.

**16.11** Lidhur me pretendimin e subjekti se Komisioni ka mbajtur standarde të dyfishta për vlerësimin e pasurisë paramartesore të ndryshme nga jurisprudenca e tij e deritanishme, Kolegji vlerëson se:

Në ankim, për këtë shkak, subjekti referon vendimmarrje të tjera të Komisionit <sup>7</sup>, në të cilat pretendon se nga ky organ janë trajtuar në mënyrë të ndryshme çështjet e pasurisë paramartesore. Në lidhje me këtë pretendim, për sa kohë shqyrtimi i ankimit të subjektit është kryer në Kolegji, duke u referuar në aktet e çështjes që i përkasin asaj të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, është e panevojshme dhe e paarsyeshme të kryhen kontrole apo referime mbi elementë të caktuar të vlerësimit të pasurisë që Komisioni ka bërë në një vendim tjetër të tij, i cili, për më tepër, nuk i është nënshtruar juridiksionit kontrollues të Kolegjit. Për pasojë, ky pretendim i subjektit mbetet i pamundur për t'u verifikuar e vlerësuar dhe, gjithsesi, nuk pengon Kolegjin të bëjë një vlerësim të pavarur të shkaqeve të ankimit objekt shqyrtimi pavarësisht, qëndrimeve që ka mbajtur Komisioni në raste të tjera, të cilat janë të pavlerësuara prej Kolegjit.

**16.12** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se nuk i është lënë kohë e mjaftueshme dhe e përshtatshme për t'ju përgjigjur kërkesave të Komisionit gjatë hetimit administrativ, pasi rezultatet paraprake të hetimit i janë përcjellë në muajin gusht, periudhë pushimesh dhe i është lënë vetëm tre ditë kohë për të dhënë përgjigjet e pyetësorit të datës 16.12.2019, konstatohet sa vijon:

**16.13** Nga analiza e të dhënave të akteve që ndodhen në dosje, rezulton se Komisioni i ka akorduar kohë shtesë subjektit, kur ajo e ka kërkuar<sup>8</sup>. Ndërsa, për sa i përket pretendimit se subjektit i është dashur të kthejë përgjigje në periudhë pushimesh, Kolegji çmon se ky pretendim nuk duket realisht i drejtë dhe objektiv, duke e vlerësuar atë në raport me faktin që organet e rivlerësimit, në zbatim të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda një mandati të përkohshëm, i cili përcakton edhe kohën limit brenda të cilës duhet të përfundojë procesi i rivlerësimit kalimtar për të gjithë subjektet e rivlerësimit. Në këto kushte, këto dy elementë, përkatësisht fakti që komunikimet përgjatë hetimit administrativ provojnë se Komisioni i ka akorduar subjektit të gjithë kohën e kërkuar për dhënien e përgjigjeve/shpjegimeve, duke i dhënë kohë shtesë kur subjekti e ka kërkuar atë, si dhe fakti që ligjërisht organet e rivlerësimit kanë detyrimin të përmbushin rivlerësimin kalimtar brenda një kohe të caktuar, nuk mbështesin pretendimin për vënien e subjektit në pamundësi për t'u përgjigjur Komisionit, për shkak të mungesës së kohës dhe as evidentojnë situata diskriminuese, për sa i përket afateve për dhënien e përgjigjeve, në raport

---

<sup>7</sup> Në ankim, subjekti referon në mbështetje të këtij shkakut ankimi vendimet e Komisionit nr. 262, datë 17.06.2020 dhe nr. 181, datë 18.07.2019.

<sup>8</sup> Nga të dhënat e fashikullit administrativ, për sa i përket komunikimeve të subjektit me Komisionin rezulton se:

- Me anë të komunikimit elektronik, subjekti më datë 07.01.2020 i ka bërë me dije Komisionit se ka marrë dijeni efektive me vonesë lidhur me pyetjet e dërguara, pasi ato i janë përcjellë nga Komisioni në adresën elektronike {\*\*\*}, e cila nuk është ajo e deklaruar në deklaratën vetting, dhe se në zbatim të nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 ajo kërkon që komunikimi të bëhet në adresën e deklaruar në këtë deklaratë, {\*\*\*}. Për këtë arsye, subjekti ka kërkuar prej Komisionit kohë më të gjatë për t'u përgjigjur se afati i përcaktuar në komunikimin fillestar.
- Në përgjigje të këtij qëndrimi dhe kërimit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni me anë të e-mail-it të datës 08.01.2020, i kthen përgjigje subjektit se nuk ka problem lidhur me afatin e kthimit të përgjigjes dhe se adresa e parë elektronike me të cilin ka komunikuar është marrë nga të dhënat e disa dokumenteve që vetë subjekti ka paraqitur dhe se nuk ka asnjë problem për të vijuar komunikimin me adresën elektronike të deklaruar në deklaratën vetting.

me ato që u janë akorduar subjekteve të tjerë dhe në kontekstin e përgjithshëm të afateve ligjore brenda të cilave do të kryhet procesi i rivlerësimit për të gjithë subjektet.

Për sa më sipër, ky pretendim i subjektit, referuar akteve të fashikullit të hetimit administrativ, si dhe praktikave të deritanishme të aplikuara nga Komisionit, gjendet i padrejtë dhe i pambështetur në prova dhe në ligj.

**16.14** *Për sa i përket pretendimit të subjektit se Komisioni i ka kaluar barrë prove në mënyrë të paarsyeshme dhe jo proporcionale, në kundërshtim me nenin D, pika 4 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji analizon sa vijon:*

**16.15** Subjekti i rivlerësimit këtë pretendim konstatohet se e lidh me dy çështje: **(i)** me faktin që Komisioni në mënyrë të paarsyeshme i ka kaluar barrë prove, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të ardhurat e bashkëshortit dhe prindërve të tij, për periudhën para martesës; **(ii)** si dhe me faktin se Komisioni nuk ka qenë i qartë në përcaktimin e barrës së provës që subjekti i rivlerësimit kishte lidhur me problematikat që Komisioni kishte konstatuar për vëllain e saj (E. Q.).

**16.16** Lidhur me këtë pretendim (i cili gjen analizim të plotë në pjesën vijuese të këtij vendimi, që lidhet me vlerësimin e pasurisë), Kolegji konstaton se Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar burimet e ligjshme të apartamentit në Tiranë, i cili, prej saj, është deklaruar si apartament në të cilin banon, në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në këtë kuptim, duke iu referuar përcaktimeve të neneve 30, 32 pika 4 dhe 33, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, me të drejtë, në aplikim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektit për të provuar burimet e financimit të kësaj pasurie. Në kushtet kur, si një nga burimet e krijimit të apartamentit në Tiranë, vetë subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat e bashkëshortit para martese, si dhe të familjes së tij të origjinës, atëherë me të drejtë Komisioni, në referim të dispozitave të sipërcituara, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar ligjshmërinë e të këtyre të ardhurave.

**16.17** Në vijim të këtij arsytimi edhe veprimtaria hetimore e Komisionit, në drejtim të vëllait të subjektit E. Q. (e cila, gjithashtu, do të analizohet në pjesën vijuese të këtij vendimi), duket se ka nisur nga disa të dhëna të marra në funksion të hetimit administrativ, pasi Komisioni ka marrë të dhëna nga organet ndihmëse si Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave (në vijim DPPP) se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime bankare për llogari të vëllait të saj dhe për të hetuar në mënyrë të plotë këtë situatë ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, rezulton se kur Komisioni ka konstatuar problematika, për sa i përket momentit kur vëllai i subjektit ka blerë pasuri të paluajtshme në Shqipëri, në të cilin ai nuk rezultonte të ishte prezent në vend, sipas të dhënave të sistemit *TIMS*, i ka kërkuar sërish shpjegime subjektit, veprime këto të cilat duken se përfshihen brenda diskrecionit për veprimtarinë hetimore të Komisionit gjatë procesit administrativ.

**16.18** Në vlerësimin e Kolegjit, ecuria e hetimit administrativ prej Komisionit, për sa i përket marrëdhënies së subjektit me vëllain E. Q., duket të jenë normale dhe e arsyeshme për natyrën dhe objektin e hetimit administrativ, në kushtet kur neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kërkon të verifikohet jo vetëm nëse subjektet e rivlerësimit kanë burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë që disponojnë, por edhe të kontrollohet nëse ata kanë pasuri të fshehura apo kanë bërë deklarime të rreme për sa i përket atyre. Në këtë kuptim, kjo pistë e hetimit administrativ ka pasur për qëllim apo synim të verifikonte të drejtat reale të subjektit të rivlerësimit për veprimet juridike të kryera prej saj në emër të vëllait, si edhe në raport me pasuritë që janë të regjistruara në emër të vëllait të saj. Në funksion të këtij qëllimi, subjekti të rivlerësimit i është kaluar barra e provës, e cila vjen në përputhje me qëllimin e këtij procesi drejt vlerësimit të besueshmërisë së subjektit të

rivlerësimit, lidhur me pasuritë që disponohen prej saj apo për të cilat ka dyshime se mund të qëndrojnë me të në një raport të ndryshëm nga ai i deklaruar.

**16.19** Në rastin konkret, nga përmbajtja e rezultateve paraprake të hetimit administrativ të datës 05.08.2020, rezulton se Komisioni i ka bërë me dije subjektit të rivlerësimi se duhet:

*i) Të provoni me dokumentacion ligjor shpjegimet tuaja në lidhje me dhënien e shumës prej 780.000 lekësh nga vëllai juaj [...].*

*ii) Nga hetimi administrativ i Komisionit dhe nga verifikimi në sistemin TIMS, për z. E. F. Q., rezulton se: 1. Për kontratat e shitjes së mësipërme me nr. {\*\*\*}, datë 07.08.2013 dhe nr. {\*\*\*}, datë 21.08.2015, z. E. F. Q. nuk rezulton të ketë qenë në Shqipëri në datat e caktuara për firmosjen e këtyre kontratave dhe nuk rezulton të ketë lëshuar prokurë të tretët për firmosjen e tyre [sipas sistemit TIMS, z. E. Q. ka dalë nga Shqipëria më datë 22.07.2013 dhe ka hyrë në Shqipëri më datë 23.12.2013. Ndërsa, më datë 25.07.2015 rezulton të ketë hyrë në Shqipëri dhe më datë 14.08.2015 rezulton të ketë dalë nga Shqipëria].*

*iii) Duket e dyshimtë dhe e paqartë arsyeja e blerjes së apartamentit të dytë në Shëngjin, nga E. Q., në vitin 2015, kur tashmë e zotëronte një apartament në këtë zonë të blerë në vitin 2013.*

*Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Ju si subjekt rivlerësimi keni barrën e provës për të provuar lidhur me problematikat e mësipërme, të cilat janë konstatuar nga hetimi i Komisionit.*

**16.20** Sa më sipër, rezulton se prej Komisionit kjo situatë është çmuar se duhet të hetohet e më pas të vlerësohet në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, si një situatë që lë vend për mundësinë për t’u konsideruar si pasuri të fshehura të subjektit. Në këto kushte, duket se Komisioni ka pasur shkaqe të arsyeshme që justifikojnë klasifikimin e kësaj situate si të dyshimtë dhe të paqartë, e cila ka mbështetur kalimin e barrës së provës, për të provuar të kundërtën e asaj çfarë ka rezultuar nga hetimi *prima facie*.

**16.21** Në referim të sa më sipër, pretendimin e subjektit se Komisioni, për prindërit e bashkëshortit dhe vëllain e saj, i ka kaluar barrë prove në mënyrë të paarsyeshme dhe joprofesionale, Kolegji e gjen të pambështetur në situatën faktike, ndonëse ka një vlerësim të ndryshëm për tërësinë e veprimeve hetimore të kryera dhe për qartësinë e fakteve për të cilat ka kaluar barrën e provës, të cilat do të arsyetohen në vijim.

**16.22** *Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka respektuar të drejtën e saj për t’u dëgjuar, Kolegji analizon sa vijon.*

**16.23** Subjekti cenimin e të drejtës për t’u dëgjuar, si një parim thelbësor i procesit të rregullt ligjor, e lidh me faktin që Komisioni përgjatë seancës dëgjimore publike i ka kërkuar të përmbledhë shpjegimet e saj, rrethanë, e cila i ka kufizuar asaj të drejtën për t’u mbrojtur dhe e ka vënë në pamundësi për të dhënë shpjegime të plota, jo vetëm për trupën, por edhe për publikun, të cilit, sipas subjektit, ju serviren vetëm rezultatet paraprake të hetimit administrativ.

**16.24** Në funksion të verifikimit të këtij shkakut ankimi, Kolegji mori në analizë procesverbalin e seancës dëgjimore të zhvilluar në Komision. Sipas përmbajtjes së këtij procesverbali rezulton që subjekti ka dhënë shpjegime për problematikat që lidhen me burimet e pasurisë, çështjen e pagesës së tatimeve dhe pasuritë e vëllait të saj, si dhe ka pasur një sërë pyetjesh nga anëtarët e trupës së Komisionit. Në këto kushte, zhvillimi i seancës dëgjimore në Komision, për subjektin e rivlerësimit Fjoralba Prifti, përveç se nuk gjendet i ndryshëm nga ato të zhvilluara për subjektet e tjerë të rivlerësimit, por edhe nuk konstatohen problematika në drejtim të cenimit të së drejtës së subjektit për t’u shprehur. Gjithashtu, rezulton se subjekti ka deklaruar se ka dhënë shpjegime të hollësishme në observacionet e saj për rezultatet paraprake të hetimit, duke zgjedhur me vullnet se për çfarë ka përcaktuar të shprehet verbalisht në seancë, si dhe duke analizuar edhe aspekte të detajuara të analizës financiare të përgatitur nga Komisioni. Nga

procesverbali i seancës dëgjimore konstatohet se trupa e Komisionit i ka tërhequr vëmendjen subjektit, duke i bërë me dije se është e panevojshme të citojë shkresat, të cilat Komisioni i ka tashmë të administruara, duke i kërkuar të jetë më efikase në shpjegimet e saj, në kushtet kur Komisioni tashmë ka administruar shpjegimet gjerësisht të subjektit. Ky qëndrim i Komisionit, gjendet në koherencë me përcaktimin e nenit 55, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se *Komisioni ka të drejtë të kufizojë në mënyrë të arsyeshme kohën e parashikuar për t'u shprehur nga ana e subjektit*. Në këtë kuptim, si element të arsyeshëm që mund të justifikojnë një kufizim të kohës për t'u shpjeguar të subjektit është edhe përsëritja e shpjegimeve apo detajimi i tepërt i tyre, sidomos në kushtet kur subjekti të gjitha këto shpjegime të detajuara i ka paraqitur para trupës gjykuese edhe në formë shkresore.

**16.25** Në këto kushte, pretendimit i subjektit se prej Komisionit i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar gjendet i pambështetur në fakte dhe ligj.

**16.26** *Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka cenuar të drejtën e saj për një jetë private, duke kërkuar të dhëna shumë personale, si dhe ka kërkuar të dhëna shumë sensitive, Kolegji analizon sa vijon.*

**16.27** Këtë pretendim, subjekti e sheh të lidhur me pyetjet<sup>9</sup> që Komisioni i ka drejtuar për të deklaruar qartë, nëse ka bashkëjetuar me bashkëshortin para martese, si dhe të specifikojë periudhën e njohjes me të. Sipas subjektit, kërkesa për marrjen e një informacioni të tillë prej Komisioni, përveçse konsiderohet cenim i jetës private, ai ka të bëjë me të dhëna sensitive.

**16.28** Kolegji çmon se ky pretendim duhet vlerësuar duke konsideruar përcaktimet e nenit A të Aneksit të Kushtetutës, i cili për realizimin e procesin të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve ka parashikuar kufizimin e disa të drejtave të parashikuara nga Kushtetuta, siç janë e drejta për respektimin e jetës private apo ato që lidhen me barrën e provës. Në këto kushte, Kolegji çmon se në momentin kur subjektet e rivlerësimit kanë plotësuar deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, kanë pranuar edhe kufizimet e të drejtave të parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës. Duke u kthyer në rastin konkret, nisur edhe nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit<sup>10</sup>, konstatohet se pyetjet e hetimit administrativ që kërkojnë prej subjekteve të saktësojnë/evidentojnë momentin kur kanë filluar bashkëjetesën me bashkëshortet apo bashkëjetuesit, lidhen me përcaktimin e elementeve të rëndësishëm të analizës financiare dhe të kontrollit të pasurisë që kanë subjekti dhe personat e lidhur. Përcaktimi i saktë i elementëve të kësaj natyre ndihmon Komisionin në evidentimin e përgjegjësisë së subjektit në raport me pasuritë e vendosura prej personit të lidhur dhe se sa ato janë të ndikuara prej ushtrimit të funksionit të subjektit të rivlerësimit. I gjithë ky proces vlen dhe shërben edhe për të vlerësuar në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit të gjithë elementët që përcaktojnë vlerësimin e kriterit të pasurisë. Në këtë këndvështrim, Kolegji e gjen të drejtë dhe proporcional procesin hetimor që Komisioni ka zhvilluar në këtë drejtim dhe brenda kufizimeve që ka parashikuar neni A i Aneksit të Kushtetutës.

**16.29** Në këto kushte, këto pretendime të subjektit të rivlerësimit nuk gjendet të argumentuara, të drejta dhe të mbështetura në ligj.

- 17.** Kolegji, gjithashtu, mori në shqyrtim *edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit nuk respekton parimin e sigurisë juridike, pasi: (i) Masa disiplinore e dhënë nga Komisioni bazohet jo në shkelje të konstatuara si të kryera prej subjektit të rivlerësimit, por prej bashkëshortit të saj e, si të tilla, ato nuk kanë të bëjnë me sjelljen e gjyqtarit. (ii) Masa*

<sup>9</sup> Të bëra nga Komisioni me pyetëtorin e datës 31.01.2020.

<sup>10</sup> Shih vendimet e Kolegjit: nr. 37/2022 (JR), datë 11.10.2022; nr. 34/2022 (JR), datë 21.09.2022; nr. 15/2021 (JR), datë 18.06.2021; nr. 29/2022 (JR,) datë 21.07.2022; nr. 17/2022 (JR), datë 27.05.2022; nr. 11/2022 (JR), datë 27.04.2022; dhe nr. 2/2022 (JR), datë 15.02.2022.

*disiplinore nuk mund të jepet nga një këshill disiplinor për shkelje apo mangësi të DVP-ve të bëra dekada më parë dhe për probleme që nuk kanë të bëjnë me sjelljen e saj.*

**17.1.** Sipas këtij shkak, subjekti i rivlerësimit pretendon se parimi i sigurisë juridike, si element thelbësor i shtetit të së drejtës, nënkupton sundimin e ligjit, mënjanimin e arbitraritetit dhe garantimin e besueshmërisë së individit të shtetit, institucionet e tij, si edhe aktet që ato nxjerrin. Mbi këtë kuptim të parimit të sigurisë juridike, subjekti i rivlerësimit pretendon se në procesin e saj të rivlerësimit janë cenuar përcaktimet dhe të drejtat e ofruara nga ligji nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e gjyqësorit në Shqipëri”, neni 34/2 dhe ligji nr. 96/2016 “Për Statusin e Magjistratit”, neni 117/1, të cilët parashikojnë afate kohore ose afatet e kufizimit deri në 5-së vjet për shkeljet disiplinore ose shkeljet e tjera në procedurat kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Subjekti pretendon se ajo nuk mund të penalizohet për veprimet e bashkëshortit të saj para martesës, si dhe nuk mund të shkarkohet nga detyra me një vendimmarrje për mangësi në deklarimin e pasurisë që datojnë shumë vite më parë dhe që janë probleme që nuk lidhen me sjelljen e gjyqtarit.

**17.2.** Lidhur me këto pretendime, Kolegji sjell në vëmendje se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve u miratua si një domosdoshmëri për të rikthyer besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, nëpërmjet rivlerësimit kalimtar të tyre, për sa i përket vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale. Për të garantuar ecurinë e këtij procesi në Kushtetutë me një konsensus të gjerë, siç u argumentua edhe më lart, u vendosën kufizime të të drejtave të subjekteve të rivlerësimit dhe sanksione për shkarkimin nga detyra, të cilat kaluan edhe testin e kontrollit kushtetues, si norma që në thelb nuk cenojnë në mënyrë permanente të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit. Aktualisht, në jurisprudencën e GjEDNj-së, të përfaqësuar në vendimmarrjet që kjo gjykatë ka dhënë për çështje që kanë të bëjnë me rivlerësimin e gjyqtarëve [shih çështja *A. Xhoxhaj kundër Shqipërisë*], nuk janë konstatuar elementë të hetimit administrativ për kontrollin e pasurisë, figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, që cenojnë parimin e sigurisë juridike.

**17.3.** Duke u kthyer në rastin objekt shqyrtimi, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka qenë subjekt deklarues i pasurisë që në vitin 2003, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.03.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. “9049/2003”), i cili në përcaktimet e nenit 1 parashikon se qëllimi i ligjit është kontrolli i pasurisë, i legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, i detyrimeve financiarë për subjektet deklarues *dhe të personave të lidhur me ta*. Në këtë kuptim, subjektet deklaruese referuar këtij ligji kanë pasur dhe kanë detyrimin për të provuar ligjshmërinë e pasurive që ata dhe personat e lidhur disponojnë. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse ka qenë apo jo subjekt i një kontrolli të plotë nga organi kompetent i ILDKPKI-së, ka pasur detyrimin të dispononte dokumentacionin justifikues të pasurisë së saj dhe të personit të lidhur edhe përgjatë deklarimit nën përcaktimet e këtij ligji. Fakti që procesi i rivlerësimit kalimtar të pasurisë së gjyqtarëve, që u mundësua me miratimin e ndryshimeve kushtetuese të bëra me ligjin nr. 76/2016 dhe ligjin nr. 84/2016, e potencoi në kohë këtë detyrim nuk mohon ekzistencën e këtij detyrimi për këtë kategori edhe në zbatim të ligjit nr. 9049/2003. Në këtë kuptim, detyrimi për deklarimin dhe provimin e burimeve të ligjshme, jo vetëm të subjektit, por edhe të personave të lidhur (bashkëshortit në këtë rast), përveç se ka qenë e përcaktuar që në ligjin nr. 9049/2003 është mbartur dhe përforcuar edhe në parashikimet e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, i cili, në drejtim të kontrollit të pasurisë, vendos të njëjtat nivele kontrolli, si për subjektin, ashtu edhe për personat e lidhur me të, të cilët, sipas parashikimit të nenin 3, pika 13, janë bashkëshorti e fëmijët madhorë apo persona të tjerë pjesë e certifikatës familjare në periudhën e rivlerësimit.

**17.4.** Për këto arsye, në kushtet kur legjislacioni i aplikueshëm për deklarimin e pasurive në mënyrë konstante, nga momenti i hyrjes në fuqi, prill 2003 e deri aktualisht, kërkon justifikimin

e burimeve të ligjshme për pasuritë që subjekti dhe personat e lidhur disponojnë, nuk gjenden të drejta pretendimet e subjektit se kontrolli i pasurisë së personave të lidhur të gjyqtareve dhe prokurorëve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, shkakton cenim të parimit të sigurisë juridike.

## **II. Shkaqe që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

18. Kolegji fillimisht mori në analizë pretendimin e subjektit të rivlerësimit, i cili shoqëron pothuaj të gjithë pretendimet për kundërshtimin e analizës financiare të kryer nga Komisioni, që, sipas saj, ka sjellë një vlerësim të gabuar të vlerësimit të pasurisë, me anë të të cilit pretendon se *për të ardhurat nga veprimtaria e përkthimit të bashkëshortit provohet burimi i ligjshëm i krijimit të tyre dhe se mosprovimi i pagesës së detyrimeve tatimore, për shkak të pamundësisë së gjetjes së dokumenteve për shkak të kohës së largët, nuk mund t'i bëjë këto të ardhura të konsiderohen si jo të ligjshme, pasi kjo situatë kërkon aplikimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016*. Me këtë pretendim, subjekti konsideron si të padrejtë dhe të pabazuar në ligj mospërfshirjen në analizën financiare të kryer nga Komisioni të shumave të siguruara nga veprimtaria e përkthimit të bashkëshortit, për të cilat nuk ka mundur të provojë pagesën e detyrimeve tatimore. Subjekti ka pretenduar se pagimi i tyre më së shumti nuk ka qenë detyrim për t'u përmbushur nga bashkëshorti i saj dhe se pamundësia për të provuar përmbushjen e detyrimeve tatimore ka ardhur për shkaqe si koha e largët apo mosvënia në dispozicion e këtij informacioni nga organet tatimore apo subjektet/palët, që ishin të detyruar për pagimin e tyre, duke theksuar se bashkëshorti i saj nuk ka pasur detyrim për të ruajtur dokumentacionin që provon pagesat e detyrimeve tatimore.

18.1. Sipas ankimit të subjektit të rivlerësimit të dhënat dhe arsyet, të cilat duhet të çojnë Kolegjin drejt aplikimit të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, janë:

a) Shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 12.02.2020 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 29.06.2020, të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (në vijim "DRT Tiranë"), kanë konfirmuar faktin që organet tatimore janë në pamundësi të vërtetojnë pagesën e tatimit, për angazhimet e përkthimit të bashkëshortit të identifikuar në këtë shkresë, për shkak të mospasjes së të dhënave të plota dhe mungesës së një sistemi unik informatik për këtë periudhë.

b) Paguesit e shumave (*domethënë kërkesit e shërbimit të përkthimit nga bashkëshorti i subjektit*) në shumë raste nuk i janë përgjigjur kërkesave të subjektit për të provuar shumën e përfituar nga bashkëshorti, si dhe pagesën e detyrimeve tatimore apo dhe në ato raste kur janë përgjigjur kanë shpjeguar se nuk disponojnë dokumentacion, për shkak të kalimit të kohës së gjatë nga momenti kur ai duhej të ishte prodhuar.

c) Nga ana e bashkëshortit të subjektit informacioni për angazhimet e tij si përkthyes, si dhe për pagimin e detyrimeve tatimore nuk është ruajtur, për shkak se ka kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (në vijim "ligji nr. 9920/2008"), apo se ka kaluar afati 6-vjeçar i ruajtjes së dokumentacionit të përcaktuar në nenin 7 të ligjit nr. 7758, datë 12.10.1993 "Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet" (në vijim "ligji nr. 7758/1993", i shfuqizuar, me ligjin nr. 9920/2008).

d) Bashkëshorti i saj ka ofruar shërbime përkthimi për organizata dhe fondacione jo rezidente në Shqipëri dhe se është në pamundësi për të pasur informacion (duke konsideruar kohën e largët kur janë ofruar shërbimet e përkthimit), se si këto entitete mund të kenë përmbushur detyrimet tatimore, duke sugjeruar që ato mund të jenë paguar prej tyre edhe në vendin ku këto organizma ushtrojnë aktivitetet.

18.2. Kolegji, nga analizimi i pretendimeve të ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit për kontrollin e pasurisë, është ndalur në verifikimin e detajuar të atyre pretendimeve që synojnë ndryshimin e analizës financiare të kryer nga Komisioni në ato vite, për të cilat ky

organ ka konkluduar se subjekti apo personi i lidhur gjendet me mungesë të burimeve të ligjshme për të përballuar krijimin e pasurive dhe shpenzimet e jetesës, por krahas këtyre pretendimeve ka marrë në shqyrtim, si në vijim, pretendimin për zbatimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si element që afekton qëndrimin dhe trajtimin e pretendimeve konkrete mbi rezultatet e analizës financiare.

**18.3.** Nga analiza e akteve të fashikullit rezulton se bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e personit të lidhur me të, në deklaratën *vetting*, si edhe më parë në deklaratat periodike vjetore, ka deklaruar se si burime të ligjshme për financimin e pasurisë apartament, në Tiranë, si edhe të likuiditeteve në bankë, kanë shërbyer të ardhurat që ai ka siguruar nga veprimtaria si përkthyes i gjuhës gjermane. Në drejtim të të ardhurave të siguruara nga veprimtaria e përkthimit, konstatohet se bashkëshorti i subjektit, në deklaratën *vetting*, si dhe në deklaratimet periodike vjetore, ka identifikuar çdo veprimtari përkthimi të realizuar prej tij, si dhe ka deklaruar vlerat e përfituara për shërbimin që ai ka ofruar. Subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, për të provuar të ardhurat e siguruara nga veprimtaria si përkthyes i personit të lidhur, ka paraqitur kontrata apo marrëveshje angazhimi, të lidhura nëpërmjet bashkëshortit të saj si ofrues i shërbimit të përkthimit dhe kërkuesve të këtij shërbimi apo edhe thjesht ka pretenduar përfitimin e këtyre të ardhurave mbështetur në deklaratimin e tyre si të përfituara në deklaratat periodike vjetore apo se provohej kalimi i shumave në llogaritë bankare të bashkëshortit.

**18.4.** Në këto kushte, në zbatim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni përgjatë hetimit administrativ i ka kërkuar subjektit të provojë pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e siguruara nga veprimtaria si përkthyes e bashkëshortit të saj, për të cilat kishte paraqitur dokumentacion provues për kryerjen e këtij shërbimi apo që ajo pretendonte se kishte siguruar të ardhura edhe pse nuk mund ta faktonte realizimin e shërbimit/ekzistencën e marrëdhënies së punës.

**18.5.** Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisionit, subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka pretenduar se për një pjesë të këtyre të ardhurave të siguruara nga ofrimi i shërbimeve të përkthimit nga bashkëshorti ajo gjendet në kushtet e pamundësisë objektive, sipas neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të provuar pagimin e detyrimeve tatimore. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur si provë në Komision shkresën nr. {\*\*\*}<sup>11</sup> prot., datë 12.02.2020, të lëshuar nga DRT-ja Tiranë, në të cilën pasqyrohet se nuk ka të dhëna të plota dhe një sistem unik informatik dhe është në pamundësi të vërtetimit të pagesës së tatimit në burim për të ardhurat e pretenduara, deri në dhjetor të vitit 2014. I njëjti organ, me shkresën tjetër nr. {\*\*\*}<sup>12</sup> prot., datë 29.06.2020, konfirmon që *Ambasada Austriake, Fondacioni "Friedrich Hebert", Fondacioni "Robert Ebert", kanë shlyer detyrime për tatimin në burim, por nuk identifikohet në përshkrim se cilit individ i takon.*

**18.6.** Gjendur para një situatë të tillë të paprovueshmërisë së ligjshmërisë së të ardhurave të pretenduara, në kushtet kur subjekti ka barrën e provës, në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar, në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka konkluduar se *subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaratimit të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit për pasurinë apartament banimi me sip. 121,29 m<sup>2</sup> dhe garazh me sip. 17 m<sup>2</sup>, në*

---

<sup>11</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 12.02.2020, e DRT-së Tiranë, është dhënë në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit të datës 04.02.2020, për t'i dhënë informacion për pagesat e tatimit në burim, që janë bërë në emër të bashkëshortit të saj E. P., për shërbimet e përkthimit që ai ju ka ofruar/dhënë enteve/organizatave të ndryshme.

<sup>12</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 29.06.2020, e DRT-së Tiranë, është dhënë në përgjigje të kërkesës të subjektit të rivlerësimit të datës 25.06.2020 me anë të së cilës kërkohet konfirmim për pagesat e kryera për tatimin në burim për të ardhurat e përfituara nga honorarët si përkthyes të bashkëshortit të subjektit në shoqëritë, që vetë subjekti ka evidentuar në kërkesën e saj.

*Tiranë, duke mosjustifikuar me burime të ligjshme financiare në masën prej (-) 7.200.201 lekësh (nga të cilat para martese në vlerën 5.801.415 lekë dhe pas martese në vlerën 1.398.786 lekë) krijimin e kësaj pasurie [...].*

*Lidhur me kërkesën e subjektit për të konsideruar si të ardhura të ligjshme të ardhurat e tjera të përfituara prej tij, për të cilat subjekti nuk ka mundur të provojë pagimin e detyrimeve tatimore sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni nuk ka pranuar shpjegimet e subjektit, pasi nuk i gjen ato në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016 dhe me nenin D të Aneksit të Kushtetutës. [...] Mbështetur në kërkesën e subjektit gjatë hetimit, Komisioni i ka kërkuar ILDKPKI-së dokumentacionin mbështetës të dërguar nga subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratimet e saj ndër vite, nga i cili nuk ka rezultuar, gjithashtu, ndonjë dokument që të provonte se subjekti i rivlerësimit është kujdesur për të provuar ndër vite, pagimin e detyrimeve tatimore të të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti i saj ndër vite dhe, në disa raste, as dokumentacion ligjor provues se marrëdhënia e punës ka ekzistuar. [...] Shkresa e marrë prej subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, por edhe nga Komisioni, nga organet tatimore, nuk provonte rregullin e përcaktuar në pikën 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, se ky informacion nuk gjendej në regjistrat elektronikë (në sistemin informatik) dhe se subjekti nuk arriti t'i vërtetojë Komisionit se dokumentacioni provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave objekt vlerësimi është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër e se subjekti nuk ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive, sipas pikës 2, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.*

**18.7.** Në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion të Komisionit, duke pretenduar se prej Kolegjit duhet të rivlerësohen disa të ardhura, të cilat nuk janë konsideruar nga ana e Komisionit për shkak të mungesës së dokumentacionit justifikues, në drejtim të ekzistencës së marrëdhënies së punës dhe krijimit të tyre, të konfirmimit të kryerjes së transaksionit, si dhe të shlyerjes së detyrimeve tatimore. Këto të ardhura, sipas subjektit, janë siguruar nga shërbime të përkthimit të ofruara nga bashkëshorti i saj në periudhën para martese e pas martese, që në disa raste janë shërbimeve të ofruara për entitete/organizata të huaja, për të cilët subjekti pretendon se është në pamundësi për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore.

**18.8.** Kolegji mori në shqyrtim situatën faktike në raport me legjislacionin e zbatueshëm për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi të subjektit. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit administrativ, konstatohet se bashkëshorti i subjektit, si në periudhën para martesës, ashtu edhe më pas, deri në vitin 2018, ka ofruar shërbime si përkthyes i gjuhës gjermane pa qenë i regjistruar në organet tatimore si person fizik apo juridik. Nga aktet konstatohet se personi i lidhur shërbimin e përkthimit e ka ofruar mbi bazën e kontratave të ndryshme të cilat kërkesit e shërbimit rast pas rasti specifikonin edhe se cilës palë i përkiste detyrimi për pagesën e detyrimeve tatimore. Nga aktet e administruara, gjithashtu, rezulton se marrëdhënia, e cila i ka siguruar të ardhura bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ka qenë ajo e dhënies së shërbimit të përkthimit nga gjuha gjermane për operatorë/individë të ndryshëm, mbi bazën e kontratave të lidhura dhe jo si shërbim përkthimi i kryer për një kompani/organizatë apo entitet, ku bashkëshorti i subjektit të ishte i punësuar si përkthyes, për të cilin ai do të përfitonte *pagë* si shpërblim për punën e kryer. Duke analizuar legjislacionin tatimor në fuqi, përgjatë kohës së marrë në shqyrtim, rezulton se ka pasur parashikime ligjore që rregullojnë literalisht taksimin e shërbimit të përkthimit që prej vitit 2001, në ligjin nr. 8842, datë 11.12.2001 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”*”<sup>13</sup>, tek i cili përcaktohet se për kategorinë “D”, për profesione si: ekonomist kontabël i miratuar, ekspert kontabël i autorizuar, mësues, veteriner, agronom, *përkthyes* e profesione të tjerë, parashikohej tatim me kuotë fikse, sipas kategorive të qyteteve ku ndodhej ofruesi i shërbimit. Parashikimi ligjor i përshkruar më sipër evidenton faktin që ndonëse ka qenë e

<sup>13</sup> Shih [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al), fletoren zyrtare nr. 58 te vitit 2001, faqe 1833.



rregulluar në ligj detyrimi, mënyra dhe procedura e vjeljes së detyrimeve tatimore për shërbimin e përkthimit, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka zgjedhur të mos i nënshtrohet këtij regjimi ligjor për realizimin e veprimtarisë së tij si përkthyes, në raport me detyrimet tatimore në formën e *person fizik*, sipas legjislacionit në fuqi, duke preferuar që shërbimin e përkthimit ta ushtrojë duke lidhur kontrata të ndryshme individuale me kërkues të këtij shërbimi. Në këto kushte, të ardhurat e përfituara nga ky shërbim kanë qenë objekt i aplikimit të tatimit në burim mbi të ardhurat personale<sup>14</sup>, për të cilat ligji i kohës ndër vite ka variuar në vlerat nga 10% deri në 15% të pagesës së përfituar. Kjo zgjedhje e personit të lidhur, për raportin e tij me organet tatimore, ka lënë minimalisht në neglizhencë permanente vëmendjen e tij ndaj pagimit të këtyre detyrimeve, meqenëse ato duhej t'i takonin kërkuesve të shërbimit dhe maksimalisht me qëllim ka krijuar një situatë e cila ka mundësuar përfitimin e shumave në vlera *bruto*, duke shmangur, nëpërmjet një mekanizimi persistent të vepruari, pagimin e detyrimeve tatimore.

**18.9.** Në këndvështrim të sa më sipër, lidhur me pretendimin e subjektit se në të gjitha rastet kur provohet se në kontratat e shërbimit për përkthim kërkuesit kanë qenë entitete/organizata/shoqëri të regjistruar në organet tatimore, duhet konsideruar se këto të fundit, sipas neneve 33 dhe 35 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, kishin detyrimet për mbajtjen në burim të tatimit mbi të ardhurat, Kolegji konstaton se:

(i) Nga analizimi i një pjese të kontratave/marrëveshjeve<sup>15</sup> të lidhura ndërmjet kërkuesve të shërbimit të përkthimit dhe bashkëshortit të subjektit si ofrues i tij, rezulton se është parashikuar se është pikërisht ofruesi i shërbimit, pra, bashkëshorti i subjektit, ai që merr përsipër pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurën e siguruar nga përkthimi. Subjekti, edhe pse këto kontrata kanë të mirëpërcaktuar se cila palë merr përsipër të paguajë detyrimet tatimore, sërish pretendon se duke qenë se kërkuesit kanë qenë entitete/organizata/shoqëri të regjistruar në organet tatimore, duhet konsideruar se këto të fundit, sipas neneve 33 dhe 35 të ligjit nr. 8438/1998, kishin detyrimin për mbajtjen në burim të tatimit mbi të ardhurat.

(ii) Ndërsa pamundësinë për të provuar se kërkuesit e shërbimit të përkthimit kanë shlyer detyrimet tatimore, subjekti e justifikon me kohën e largët që ka kaluar dhe me faktin që nuk ka pasur detyrim të ruaj një dokumentacion të tillë, duke e konsideruar këtë pamundësi si situatë që duhen konsideruar, sipas parashikimeve të neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**18.10.** Në këto rrethana, Kolegji konstaton se nëpërmjet aplikimit të parashikimit të neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti synon të ligjërohen në kuptim të këtij ligji të gjithë të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti prej një shërbimi, që duhej t'i nënshtrohej regjimit tatimor në fuqi, ndërsa ky fakt nuk provohet se ka ndodhur, sepse bashkëshorti i subjektit ka zgjedhur të mosregjistrohet në organet tatimore dhe as të kujdeset për të ruajtur

---

<sup>14</sup> Pagimi i tatimit në burim për të ardhurat personale ka qenë e rregulluar që në vitin 1994 me ligjin nr. 7786, datë 27.01.1994 “Për tatimin mbi të ardhurat personale” (i cili në nenin 2 parashikon si të ardhura të tatueshme ato të siguruar nga shërbime individuale), i cili ka pësuar ndryshime të shumta duke u konsoliduar më pas me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” (në vijim ligji nr. 8438/1998). Në vijim të kësaj analize, ky ligj përcakton në nenin 6 “Fusha e veprimit të tatimit mbi të ardhurat personale” parashikon se: “Tatimi mbi të ardhurat personale, që më poshtë do të quhen “të ardhura”, llogaritet mbi të ardhurat e individëve”. Në nenin 8, të emërtuar “E ardhura e tatueshme” në pikën “g” parashikohet se: “Si të tatueshme janë edhe “të ardhura të tjera”, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>15</sup> “Pagesë Honorari”, e lidhur midis Kulture Kontakt Austria dhe z. E. P. për shërbim përkthimi në shumën 270 euro, në të cilën z. E. P. deklaroi se taksimi brenda vendit është përgjegjësi personale; Marrëveshje “Për marrje pagese” e datës 02.05.2008 e ligjit midis shoqërisë së përkthimit “{\*\*\*}” dhe z. E. P., i cili deklaroi se shpërblimi i mësipërm përfshin edhe shumën e tatimit mbi të ardhurat, për të cilin personi në fjalë është vetë përgjegjës; “Kontratë për bashkëpunim”, e lidhur midis Dhomës së Zejeve Sofje dhe z. E. P., në të cilën ai deklaroi përfitimin e shumës 150 euro bruto.

dokumentacionin provues të pagesës së detyrimeve tatimore nga njëra palë apo tjetra e përfshirë në këto marrëdhënie për shërbim përkthimi.

**18.11.** Përcaktimi i pikës 2<sup>16</sup>, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 ka pasur si qëllim të zgjidhë situata të caktuara, në të cilat mund të gjenden subjektet, kur ka elementë të mjaftueshëm që tregojnë për ngjarjen/faktin juridik që duhet të provojë dokumenti, i cili nuk gjendet, është dëmtuar apo zhdukur. Në rastin e personit të lidhur, rezulton se ai ka zgjedhur me vullnetin e tij, para por edhe pas martese, të mos i nënshtrohet një regjimi të qartë ligjor që do të krijonte dhe dokumentonte të ardhurat e tij si përkthyes. Ndonëse bashkëshort i një subjekti deklarues, që prej vitit 2006 është sjellë të paktën me neglizhencë të pajustificuar drejt legjitimitetit të të ardhurave të tij, në kuptim të zbatimit të legjislacionit tatimor. Ai ka vijuar të ofrojë shërbimin e përkthimit, ndaj subjekteve kërkues, pa u kujdesur dhe siguruar në asnjë rast, qoftë edhe për faktin nëse detyrimet tatimore për pagesat e përfituara prej tij janë kryer ose jo. Fakti që edhe në rastet kur sipas subjektit, ligji ka parashikuar detyrimin e mbajtjes në burim të vlerës së tatimit nga personat juridike, ka kontrata të paraqitura prej vetë subjektit, në të cilat parashikohet shprehimisht se ky detyrim i takonte ofruesit të shërbimit, pra, personit të lidhur dhe ky detyrim nuk është paguar prej tij, por pretendohet se duhet të jetë paguar prej personit juridik për shkak të ligjit, rrethanë e cila nuk provohet, për shkak të përcaktimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit, përforcon bindjen e Kolegjit se personi i lidhur ka pasur dijeni të plotë për mungesën e pagimit të detyrimit tatimor dhe është pajtuar me këtë situatë në një periudhë kohe të gjatë dhe të shpeshtë të ushtrimit të aktivitetit. Për shkak të kësaj qasje, që duket se ka lejuar personin e lidhur të subjektit të përfitojë shuma të patatuara në rastet kur ky përfitim provohet, Kolegji e gjen të padrejtë aplikimin e nenit 32, pika 2, i cili tipikisht zhvesh nga përgjegjësia ata që kanë qenë në mirëbesim, kanë ditur ose prezumohet për shkak të rrethanave që kanë besuar se detyrimet tatimore kanë qenë paguar, por kjo nuk mund të provohet për fakte që nuk varen prej tyre. Situata e personit të lidhur është e ndryshme dhe, për shkak të mënyrës së ushtrimit të aktivitetit, Kolegji çmon se ai e ka ditur dhe duhej të dinte se të paktën në kontratat ku detyrimi tatimor i përkiste shprehimisht atij, ai nuk ishte paguar prej askujt tjetër përderisa ai vetë, si personi që kishte marrë përsipër këtë detyrim, nuk e kishte paguar atë.

**18.12.** Pretendimi i subjektit se ligji i kohës, nr. 7758, datë 12.10.1993 “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”, nuk e detyronte të ruante dokumentacion përtej afatit 6-vjeçar të përcaktuar prej tij, vlerësohet nga Kolegji si një pretendim i superuar tashmë nga zbatimi i ligjit nr. 84/2016, i cili ka përcaktuar në themel të tij barrën e provës për subjektin për të provuar deklaratimet në kuadër të këtij procesi, përtej parashikimeve të tjera ligjore që kanë rregulluar marrëdhënie të ndryshme në kohë. Përveç këtij këndvështrimi, vlerësohet të nënvizohet fakti që subjekti dhe personi i lidhur gjenden në të njëjta kushte të mosparaqitjes së asnjë dokumentacioni edhe për periudha të cilat nuk mbulohen nga ky parashikim ligjor me regjimin e mosruajtjes së dokumentacionit. Rezulton se personi i lidhur ka zgjedhur të regjistrohet dhe të veprojë si person fizik vetëm në vitin 2018, duke anashkaluar të gjithë periudhën para kësaj kohe për shkak të vullnetit të tij, vullnet i cili konsiderohet si shkaku që ai gjendet në kushtet e mospasjes së dokumentacionit të kërkuar nga ligji. Për pasojë, thirrja për zbatim e nenit 32, pika 2 e ligjit, vlerësohet si një artificë për të shmangur përgjegjësinë e subjektit nga detyrimi për të provuar të ardhurat e deklaruara, që vjen nga zbatimi i ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>16</sup> Kjo dispozitë parashikon se: “Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”.

**18.13.** Në disa nga situatat që pretendohet se është përfituar e ardhura, Kolegji konstaton se subjekti nuk e provon marrëdhënien e shërbimit dhe as përfitimin e të ardhurës, rrethana të cilat do të analizohen në mënyrë të dedikuar për secilin rast në vijim, por që qartazi e bëjnë të pabesueshëm pretendimin e subjektit për aplikimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si edhe pretendimin se Komisioni duhej të pranonte si të vërtetë deklaratimet e subjektit mbi këto të ardhura. Deklarimet e subjekteve në deklaratën *vetting* duhet t'i nënshtrohen verifikimit të vërtetësisë së tyre edhe në raport me të ardhurat, të cilat, nëse nuk dokumentohen me anë të dokumentacionit provues, mbeten thjesht në nivel deklarativ dhe nuk mund të konsiderohen të provuara.

**18.14.** Kolegji, gjithashtu, konstaton se sipas Komisionit dokumentacioni i paraqitur prej subjektit gjatë hetimit administrativ për justifikimin e të ardhurave të periudhës para martese, por edhe dokumentacioni i disponuar në fashikullin e krijuar nga Komisioni, i administruar nëpërmjet korrespondencës zyrtare me organet tatimore, nuk provojnë rrethanat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Përgjigja e organeve tatimore drejtuar Komisionit, e dhënë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.07.2020, tek e cila shpjegohet se *kemi pamundësi të vërtetojmë pagesat e tatimit në burim për periudhat e sipërcituara, pasi deri në dhjetor 2014 këto të dhëna kanë qenë pagesa të kryera jashtë sistemit informativ (manualisht)*, jep informacionin se në sistemin elektronik nuk ka të dhëna për pagesat e kryera deri në dhjetor 2014, duke shpjeguar se deri në këtë kohë pagesat janë kryer manualisht. Nga ana tjetër, konstatohet se, për sa kohë, as organet tatimore dhe as subjekti nuk kanë sjellë prova të këtyre pagesave të kryera manualisht, pagimi i detyrimeve tatimore për këto të ardhura mbetet i paprovuar. Mungesa e të dhënave në sistemin elektronik nuk mund të konsiderohet si një situatë e parashikuar nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë DRT-ja Tiranë nuk përcakton ndonjë nga situatat që shkaktojnë pamundësi objektive për të gjetur pagesat, por orienton kërkuesin (bashkëshortin e subjektit) të kërkojë evidenca të pagesave manuale të tatimeve. Rrjedhimisht, edhe për shkak të kësaj analize, krahas asaj që lidhet me dijeninë /ndërgjegjësimin për mospagimin e detyrimeve tatimore, të analizuar më lart, subjekti gjendet në kushtet kur nuk arriti të vërtetojë se dokumentacioni provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave objekt vlerësimi është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër.

**18.15.** Në përfundim të analizës së bërë më sipër, Kolegji çmon se subjekti nuk ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, për provimin e pagimit të detyrimeve tatimore dhe se ajo nuk mund të zhvishet nga përgjegjësia/barra e provës që ka në funksion të këtij procesi, për të provuar përfitimin dhe pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruara prej bashkëshortit të saj që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë së tyre.

**18.16.** Në përfundim të gjithë të ardhurat e pretenduara më sipër, si të krijuara gjatë periudhës para martese, por edhe ato pas martese, nuk mund të bëhen pjesë e analizës financiare si burime të cilat janë përdorur për blerjen e apartamentit në vitin 2006 apo për krijimin e pasurive likuiditet, për të gjitha ato raste kur për to mungon dokumentacioni justifikues i kryerjes së shërbimit, kryerjes së transaksionit të pagesës në favor të bashkëshortit të subjektit, si dhe mungon konfirmimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e krijuara. Në këto kushte, referuar në sa më sipër, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimi për një pjesë të të ardhurave të deklaruara në deklaratën *vetting*, si dhe në deklaratimet periodike të pasurisë me burim nga veprimtaria e përkthimit të bashkëshortit, për të cilat ajo nuk ka arritur të provojë një nga elementët e mësipërm, nuk do të konsiderohen si të ardhura, të cilat plotësojnë kriteret e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 dhe nuk do të përfshihen në analizën financiare si të tilla. Trajtimi individual i çdo pretendimi të subjektit në

raport me këto të ardhura do të analizohet në vijim në zërat përkatës të analizës financiare të kontestuar prej subjektit të rivlerësimit në ankim.

19. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në drejtim të analizës financiare të kryer për kontrollin e burimeve të krijimit të apartamentit me kursimet e bashkëshortit të saj të siguruara nga puna para martesë se provohet burimi i ligjshëm i krijimit të tyre dhe se mosprovimi i pagesës së detyrimeve tatimore, për shkak të pamundësisë së gjetjes së dokumenteve për shkak të kohës së largët, nuk mund t'i bëjë këto të ardhura të konsiderohen si jo të ligjshme, pasi kjo situatë kërkon aplikimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji, duke mbajtur në konsideratë analizën për zbatimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, mori në shqyrtim dhe analizoi çdo të ardhur të pretenduar e deklaruar prej subjektit, për të cilën Komisioni ka konkluduar me mospërfshirje në analizën ekonomike, në funksion të përcaktimit të ndikimit që këto të ardhura do të kenë në drejtim të kontrollit të burimeve të ligjshme të përdorura para martesës së subjektit, për financimin e pasurisë apartament e garazh.

19.1. Nga të dhënat e akteve rezulton se bashkëshorti i subjektit më datë 15.03.2004 ka lidhur një kontratë sipërmarrje me shoqërinë e ndërtimit “{\*\*\*}” ShA, për blerjen e një apartamenti dhe vendparkimi me vlerë 83.500 euro, për të cilin kishte shlyer shumën prej 78.500 eurosh deri në momentin e martesës<sup>17</sup> me subjektin dhe se pas martesë janë shlyer shumat, përkatësisht: 12.000 euro, në datën 30.05.2007; si dhe 5.190 euro, në datën 05.07.2013.

19.2. Nga analizimi i vendimit, Kolegji konstaton se Komisioni, në analizën për blerjen e apartamentit dhe garazhit, ka konsideruar të ardhurat e bashkëshortit, si pedagog i gjuhës gjermane në shumën 2.438.070 lekë (22.819 euro), të cilat i takojnë periudhës 1997-2005, të ardhurat prej 1.000 eurosh të realizuara në Gjermani në muajt tetor-dhjetor 1999, si dhe një pjesë të të ardhurave në shumën 14.770 euro, me burim nga bursat e përfituara prej tij gjatë periudhës 1996-2005. Për pjesën tjetër të të ardhurave të pretenduara se janë krijuar gjatë kësaj periudhe, vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar që nga bashkëshorti i saj nuk janë ruajtur fatura për këto shërbime, pasi ka kaluar afati 6-vjeçar i ruajtjes, i përcaktuar në nenin 7 të ligjit nr. 7758/1993 “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”, duke kërkuar aplikimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe njohjen e pamundësisë për të disponuar dokumentet provuese të ligjshmërisë së të ardhurave. Në këto kushte, Komisioni ka argumentuar që këto të ardhura nuk mund të konsiderohen/përfshihen në analizë, pasi për to mungon dokumentacioni justifikues që provon deklaratimet e subjektit.

19.3. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për apartamentin konstatohet se nga shuma e paguar para martesë, e cila, sipas shlyerjeve (*likuidimit nëpërmjet mandatpagesave në cash*) pranë shoqërisë së ndërtimit në shumën totale prej 78.500 eurosh, është njohur si e ardhur e ligjshme vetëm shuma prej 38.589 eurosh. Diferenca e pambuluar rezulton në shumën 39.910 euro<sup>18</sup> e korrektuar, sipas analizës në Kolegji në vlerën (-) 4.892.290 lekë<sup>19</sup>.

19.4. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se Kolegji duhet të rivlerësojë disa të ardhura të bashkëshortit për periudhën para martesë, të cilat nuk janë konsideruar nga ana e Komisionit për shkak të mungesës së dokumentacionit justifikues në drejtim të ekzistencës së marrëdhënies së punës dhe krijimit të tyre, të konfirmimit të kryerjes së transaksionit, si dhe shlyerjes së

<sup>17</sup> Subjekti ka lidhur martesë më datë 08.02.2006.

<sup>18</sup>  $78.500 \text{ euro} - 38.589 \text{ euro} = 39.910 \text{ euro} \times 122.5818 = 4.892.290 \text{ lekë}$ .

<sup>19</sup> Në vendimin e Komisionit diferenca e pambuluar për pagesat e bëra para martesë rezulton në shumën (-) 5.801.415<sup>19</sup> lekë. Nga përlllogaritjet e kryera në Kolegji kjo diferencë rezulton në shumën (-) 4.892.290 lekë, shumë e cila është e ndryshme me rezultatin e pasqyruar nga ana e Komisionit, për të cilën në vendim nuk ka ndonjë shpjegim të hollësishëm se nga rrjedh. Por, si për Komisionin, ashtu edhe për Kolegjin, nga llogaritjet e kryera shifra e të ardhurave të njohura me burim të ligjshëm është e njëjtë prej 38.589 eurosh dhe, rrjedhimisht diferenca e pambuluar është 39.910 euro, pavarësisht se si është konvertuar ajo nga Komisioni apo nga Kolegji.

detyrimeve tatimore. Në ankim, subjekti evidenton shërbimet dhe punësimet e bashkëshortit, të cilat kanë prodhuar të ardhurat e pretenduara se duhet të përfshihen në analizë, pasi, sipas saj, ato përmbushin kriteret ligjore për të qenë të ardhura të ligjshme.

**19.5.** Kolegji mori në analizë këto pretendime të ngritura në ankim nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të evidentimit të të ardhurave të ligjshme që bashkëshorti ka krijuar para martese si vijon.

**19.5.1.** *Lidhur me të ardhurat që subjekti pretendon se janë përfituara në muajt janar - korrik 2000, në shumën 4.000 euro (rreth 8.000 marka ose 1.100 marka në muaj) nga bashkëshorti i saj nga puna, në Golm, Gjermani,<sup>20</sup> si punonjës biblioteke në institutin “{\*\*\*}”, Kolegji konstaton e vlerëson si më poshtë.*

**i.** Nga aktet e administruara gjatë hetimit rezulton se në muajin dhjetor 1999, bashkëshorti i subjektit E. P. kishte filluar një marrëdhënie punësimi me kohë të pjesshme në institutin “{\*\*\*}”, marrëdhënie, e cila ka vijuar deri më korrik 2000. Të ardhurat nga puna e realizuar në Gjermani, në muajt tetor-dhjetor 1999, janë njohur nga Komisioni për shkak të ruajtjes së librezës së shlyerjes së detyrimeve tatimore, ndërsa për periudhën janar - korrik 2000 këto të ardhura nuk janë njohur për shkak se ky dokumentacion nuk disponohet. Sipas subjektit, për të provuar këto të ardhura nuk disponohet dokumentacion për shkak se nuk është ruajtur librezë e tatimeve për këtë periudhë. Subjekti pretendon që Komisioni, nëse do kishte dyshime mbi saktësinë e këtij deklarami, mund ta verifikonte atë sipas kërkesave të nenit 50, pikat 1 dhe 7 të ligjit nr. 84/2016, pasi vetë subjekti është në pamundësi për të paraqitur dokumentacion, ndërkohë që faktet e deklaruara nga bashkëshorti, se ai ka punuar si punonjës biblioteke, në Gjermani, në institutin “{\*\*\*}”, Golm, japin të dhëna të qarta mbi identitetin e punëdhënësit dhe periudhën e punësimit.

**ii.** Subjekti kërkon nga Kolegji që këtë deklarami ta vlerësojë, në përputhje me nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për shkak se është në pamundësi për të paraqitur dokumentacion për të vërtetuar këto të ardhura të bashkëshortit, të ardhura që janë realizuar 20 vjet më parë në një shtet të huaj, nga një punëdhënësi, i cili nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion.

**iii.** Kolegji, lidhur me këtë pretendim të subjektit, për të ardhurat në shumën 4.000 euro nga puna e bashkëshortit, në Golm, Gjermani, vlerëson se nisur nga fakti që në kuptim të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit, si i ngarkuar me barrën e provës, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që provon ekzistencën e marrëdhënies së punës së bashkëshortit për këtë periudhë, kryerjen e shërbimit apo përfitimin e pagesës, si dhe nuk ka konfirmim të shlyerjes së detyrimeve tatimore, në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të të njëjtit ligj, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme dhe, për këtë arsye, nuk mund të bëhen pjesë e analizës financiare si të tilla.

**19.5.2.** *Lidhur me të ardhurat përfaqësues prej 6.000 eurosh, që subjekti i pretendon se janë përfituar nga bashkëshorti nga angazhimi si asistent i projektit të Kulture Kontakt Austria<sup>21</sup> në*

---

<sup>20</sup> Sipas shpjegime të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit, bashkëshorti i subjektit i është drejtuar me e-mail këtij instituti më datë 13.09.2019, për të kërkuar të dhënat e punësimit, por nuk ka marrë një përgjigje nga instituti {\*\*\*}. Korrespondenca me e-mail i është komunikuar Komisionit.

<sup>21</sup> Në shpjegimet e subjektit gjatë procesit administrativ në lidhje me këto të ardhura ajo deklaroi se: Sipas vërtetimit të datës 17.01.2017, të zyrës së Kulture Kontakt Austria, Regional Project Office Albania, Macedonia and Kosovo, depozituar bashkë me deklaratën vetting, rezulton se nuk disponohen fatura për shërbimet e kryera nga bashkëshorti, por konfirmohet fakti i kryerjes së këtij shërbimi në periudhën 2000-2001. Në përgjigjen e e-mail-it të drejtueses aktuale të zyrës së KKA Austria {\*\*\*} dërguar më 24.06.2020, rezulton se kjo zyrë e ruan dokumentacionin deri në 10 vjet. E-mail-i i datës 24.06.2020, me tekst “To my knowledge, OeAD/former KKA, following the respective procedures, archives the invoices for 10 years only, so that it is possible that your request related to payments from 2006 and 2007 cannot be processed. However, we will do our best to provide you with information within the given possibilities”.

*periudhën shtator 2000 - shtator 2001 dhe një pagesë të përafërt prej 1.000 marka/ekuivalent 500 euro në muaj, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

**i.** Lidhur me situatën faktike të kësaj marrëdhënie punësimi/angazhimi si përkthyes të bashkëshortit, subjekti i rivlerësimit deklaroi që nuk disponon dokumentacion të saktë për të vërtetuar shumën e saktë të të ardhurave. Sipas subjektit, pagesi i shumës ka rezidencë në Shqipëri dhe, si i tillë, ka detyrimin e mbajtjes së tatimit në burim, sipas neneve 13, 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998. Gjithashtu, subjekti shpjegon se dokumentacioni nuk është ruajtur nga bashkëshorti, për shkak se ka kaluar afati 6-vjeçar i ruajtjes, sipas nenit 7<sup>22</sup> të ligjit nr. 7758/1993 “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”. Subjekti shpjegon se “Kulture Kontakt”, me e-mal-in e datës 17.01.2017, ka informuar/deklaruar se z. E. P. ka punuar me kohë të pjesshme si asistent për “Kulture Kontakt”, Zyra e Austrisë, në Tiranë, ndërmjet vitit 2000 dhe 2001, si dhe që ai ka punuar me bazë honorarësh edhe si interpret dhe përkthyes i pavarur për “Kulture Kontakt” ndërmjet viteve 2001 dhe 2008.

**ii.** Nisur nga kjo situatë faktike, subjekti pretendon se meqenëse pagesi i shumës (Kulture Kontakt) ka vënë në dispozicion informacion me të cilin konfirmon kryerjen e shërbimit, por nuk më ka vënë në dispozicion dokumentacion me të cilin mund të konfirmojë apo mohojë pagesën e tatimit në burim, kërkon aplikimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të pamundësisë që ka për të disponuar dokumentin që justifikon të ardhurën dhe ligjshmërinë e krijimit të saj.

**iii.** Kolegji, lidhur me pretendim për përfshirjen në analizë si të ardhur të ligjshme të shumës 1.000 marka/ekuivalent me 500 euro në muaj, për periudhën shtator 2000 - shtator 2001, çmon se për sa kohë prej subjektit, për këto të ardhura, në kuptim të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nuk është paraqitur asnjë dokument i kohës, si transaksion bankar, mandatpagesë në *cash* apo *check*, që të provojë përfitimin e pagesës për kryerjen e shërbimit, si dhe mungon konfirmimi i pagimit të detyrimeve tatimore lidhur me to, shuma në total 6.000 euro e pretenduar si e ardhur nga ky angazhim, referuar përcaktimeve të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të të njëjtit ligj, nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme dhe, për këtë arsye, ato nuk mund të bëhen pjesë e analizës financiare si të tilla.

**19.5.3.** *Lidhur me të ardhurat prej 10.000 eurosh (me përafërsi) nga angazhimi si përkthyes i bashkëshortit të subjektit për llogari të nevojave dhe aktiviteteve<sup>23</sup> të realizuara nga Kulture Kontakt Austria në periudhën 2001-2005, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

**i.** Lidhur me situatën faktike të kësaj marrëdhënie punësimi/angazhimi si përkthyes të bashkëshortit, subjekti pretendon se ka shpjeguar në Komision se nuk disponon dokumentacion për të vërtetuar shumën e saktë të të ardhurave të përfituara, por sipas vërtetimit të datës 17.01.2017 të zyrës së “Kulture Kontakt Austria”, Regional Project Office Albania, Macedonia and Kosovo, depozituar bashkë me deklaratën *vetting* (të cituar në paragrafin e mësipërm)

---

*Nga shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 12.02.2020 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 29.06.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, sipas të cilës për periudhën 2006-2014 nuk ka të dhëna të plota dhe nuk ka një sistem unik informatik për pagesën e tatimit në burim deri në dhjetor të vitit 2014, si dhe me përgjigjen e datës 17.01.2017 të zyrës së Kulture Kontakt Austria, Regional project Office Albania, Macedonia and Kosovo, subjekti pretendon se ka provuar se është në pamundësi për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive.*

<sup>22</sup> Neni 7 i ligjit nr. 7758, datë 12.10.1993, parashikon se shitësi është i detyruar të lëshojë faturë dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes a të kryerjes së punimit ose shërbimit. Fatura tatimore përgatitet nga shitësi në jo më pak se ekzemplarë, nga të cilët njërin e merr dhe e ruan blerësi, kurse kopjen e mban dhe e ruan shitësi. Faturat përgatiten me numër rendor progresiv. Me rezervën e dispozitave të kundërta faturat tatimore ruhen për gjashtë vjet.

<sup>23</sup> Shpjegime të dhëna nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ në Komisioni.

Subjekti, deklaroi që bashkëshorti në kompjuterin e tij ka ruajtur disa foto të aktiviteteve ku ka ofruar shërbimin e përkthimit apo dokumente të përkthyer, ndërkohë që me referencën e datës 25.02.2003, lëshuar për të nga znj. G. T. përfaqësuese e “Kultur Kontakt Austria”, në atë periudhë, konfirmohet, ndër të tjera, kryerja e shërbimeve të përkthimit në vitet 2000 -2002, në kuadër të Projektit “ECO NET”.

rezulton se konfirmohet kryerja e këtij shërbimi në këtë periudhë, por nuk disponohen fatura për shërbimet e kryera nga bashkëshorti i saj.

**ii.** Nisur nga kjo situatë faktike edhe në këtë rast, subjekti pretendon se meqenëse pagesi i shumës (nga zyra “Kulture Kontakt Austria”) ka vënë në dispozicion informacion me të cilin konfirmon kryerjen e shërbimit, por nuk i ka vënë në dispozicion dokumentacion me të cilin mund të konfirmojë apo mohojë pagesën e tatimit në burim, kërkon aplikimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të pamundësisë që ka për të disponuar dokumentin që justifikon të ardhurën dhe ligjshmërinë e krijimit të saj.

**iii.** Kolegji, lidhur me pretendimin për të përfshirë në analizë si të ardhura të ligjshme shumën prej 10.000 eurosh, e cila, sipas subjektit, përfaqëson vlerën e siguruar nga angazhimi i bashkëshortit pranë programit/zyrës “Kulture Kontakt” Austri, si përkthyes në vitet 2001-2005, çmon se, për ka kohë, për këto të ardhura, në kuptim të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion, si transaksion bankar, mandatpagesë në *cash* apo *check*, që të provojë përfitimin e pagesës për kryerjen e shërbimit, si dhe konstaton se mungon konfirmimi i pagimit të detyrimeve tatimore lidhur me to, vlera e pretenduar si e ardhur nga ky angazhim, referuar përcaktimeve të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të të njëjtit ligj, nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme dhe, për këtë arsye, ajo nuk mund të bëhen pjesë e analizën financiare si e tillë.

**19.5.4.** Lidhur me të ardhurat prej rreth 1.300.000 lekësh të pretenduara nga subjekti, si të përfituara nga bashkëshorti i saj nga mësimdhënia e gjuhës gjermane në Liceun “{\*\*\*}” në periudhën 1998-2005 gjatë kohës së qëndrimit të bashkëshortit në Shqipëri, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

**i.** Në drejtim të situatës faktike, rezulton se të ardhurat nga kjo veprimtari në vlerën prej 270.000 lekësh, për vitin 2006, vërtetohen nga vërtetimi i lëshuar bashkëshortit nga subjekti tregtar “{\*\*\*}”, në kohën e plotësimit të deklaratës periodike të pasurisë të vitit 2006, për ILDKPKI-në. Sipas subjektit, nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, bashkëshortit të saj i janë paguar honorarët për përkthim në periudhën 1998-2006 me lekë në dorë. Për vitin 2006, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK konfirmon marrjen e shërbimit nga bashkëshorti me vërtetimin që është paraqitur bashkë me deklaratën *vetting*.

**ii.** Referuar të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit<sup>24</sup> (në vijim “QKB”), rezulton se aktualisht shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, ka statusin “Pezulluar”. Lidhur me këtë moment, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nga kontakti me telefon administratorja e kësaj shoqërie i ka konfirmuar se aktiviteti i shkollës ishte mbyllur në vitin 2013, shoqëria kishte status të pezulluar dhe nuk mund të lëshonte asnjë dokument në emër të saj, si dhe konfirmoi shërbimin e kryer nga bashkëshorti në periudhat e përmendura më sipër dhe sqaroi se nuk kishte ruajtur dokumentacion për kryerjen e pagesave. Në këto kushte, subjekti pretendon se, sipas parashikimeve të neneve 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998, tatimi në burim duhet të mbahet nga pagesi i shumave. Subjekti vijon shpjegimet duke u shprehur se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, e cila ka pezulluar aktivitetin, nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së saj për ta informuar për kryerjen e pagesës dhe mbajtjen e tatimit në burim, duke parashtruar, gjithashtu, se edhe DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.06.2020, ka shpjeguar se ka pamundësi të vërtetojë pagesat e tatimit në burim nga “{\*\*\*}” ShPK, pasi deri në dhjetor të vitit 2014 të dhënat kanë qenë pagesa të kryera jashtë sistemit informatik (manualisht). Për këto të ardhura, subjekti ka kërkuar nga Kolegji që për këtë rast të zbatojë përcaktimet e nenit 32, pika 2 të ligjit

<sup>24</sup> Sipas të dhënave të Regjistrat Tregtar subjekti “{\*\*\*}” ShPK ka për objekt veprimtarie: “Tregtimi me shumicë e pakicë, import eksport të mallrave të ndryshëm industrial, bujqësor, blegtoral, ushqimor, pajisje elektroshtëpiake, materiale ndërtimi. Arsim i lartë, arsim pasuniversitar, arsim 9-vjeçar, arsim para shkollor, si dhe trajnime dhe kurse kualifikimi.

Shih faqen zyrtare <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>

nr. 84/2016, duke pretenduar se është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që dokumenton të ardhurën dhe justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, pasi ai nuk mund të merret në rrugë tjetër, për aq kohë sa DRT-ja Tiranë është në pamundësi të vërtetimit të pagesës së tatimit në burim, ndërkohë që nuk është ruajtur dokument për kryerjen e pagesës nga bashkëshorti i saj dhe as shoqëria nuk i është përgjigjur kërkesës së saj.

**iii.** Kolegji, për të ardhurat e pretenduara si të siguruara nga angazhimi i bashkëshortit si përkthyes pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për sa kohë, sipas nenit 52, pika 2 e ligjit, ka pasur barrën e provës të provojë ligjshmërinë e këtyre të ardhurave dhe rezulton se mungon dokumentacioni ligjor, transaksioni bankar apo mandatpagesë në *cash* apo *check* që provon përfitimin e pagesës për shërbimin e përkthimit nga bashkëshortit edhe pagimin e detyrimeve tatimore për to, çmon se në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të të njëjtit ligj, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme dhe, për këtë arsye, nuk mund të bëhen pjesë e analizës financiare si të tilla.

**19.5.5.** *Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga subjekti si të përfituara prej bashkëshortit nga përkthimet me shkrim për institucione të ndryshme si, gjykata, prokurori apo noterë, të ardhura nga mësimdhënia private e gjuhës gjermane për individë shqiptarë dhe gjuhë shqipe për individë të huaj në periudhën 1997-2005 si përkthyes, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

**i.** Në drejtim të saktësisimit të vlerës së përfituar nga bashkëshorti nga këto angazhime përkthimi, subjekti shpjegon se nuk mund të paraqesë një shifër të saktë, pasi bashkëshorti nuk disponon fatura për shërbimet e kryera, pasi ka kaluar afati 6-vjeçar i ruajtjes së tyre i përcaktuar në nenin 7 të ligjit nr. 7758/1993 (në rastin e lëshimit të faturës nga blerësi). Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.02.2020, DRT-ja Tiranë pohon se nuk ka të dhëna të plota, nuk ka një sistem unik informatik dhe është në pamundësi të vërtetimit të pagesës së tatimit në burim deri në dhjetor të vitit 2014.

**ii.** Për këtë pretendim të subjektit, Kolegji konstaton se ai mbetet deklarativ dhe i pambështetur me dokumentacion provues. Në këto kushte, për sa kohë vetë subjekti në kundërshtim me barrën e provës, sipas parashikimit të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nuk identifikon asnjë marrëdhënie konkrete mbështetur në dokumentacion ligjor që ka prodhuar shumën e pretenduar si të përfituar nga bashkëshorti nga këto angazhime përkthimi, Kolegji çmon se pamundësohet kryerja e një kontrolli dhe vlerësimi lidhur me to, sepse objekti i kontrollit dhe verifikimit duket se nuk ekziston. Për sa kohë subjekti deklarohet evaziv dhe i përgjithëson këto të ardhura të pretenduara, ato nuk plotësojnë kriteret e nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të të njëjtit ligj, për pasojë këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizën financiare, sipas pretendimit të subjektit.

**19.5.6.** *Lidhur me të ardhura në vlerën 200.000 lekë të pretenduara nga subjekti si të përfituara nga bashkëshorti rreth viteve 2003-2004-2005 nga korrektimi i fjalorit<sup>25</sup> të gjuhës Gjermanisht-Shqip, i autorit A. Dh., Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

**i.** Në drejtim të situatës faktike që provon sigurimin e kësaj të ardhure, subjekti ka shpjeguar se bashkëshorti nuk disponon fatura për shërbimin e kryer, por kryerja e këtij shërbimi konfirmohet edhe nga përmbajtja në hyrjen e fjalorit, në të cilin është pasqyruar roli i tij.

---

<sup>25</sup> Subjekti, në lidhje me këto të ardhura gjatë procesit administrativ në Komision, ka shprehur sa vijon: Shërbimi i korrektimit të fjalorit Gjermanisht-Shqip, sa i përket gjuhës gjermane është një punë voluminoze që kërkon njohuri të shkëlqyera të gjuhës, kohë e përkushtim dhe nuk mund të përbëjë një punë vullnetare. Se shërbimi i korrektimit është kryer dokumentohet nga përmbajtja e vetë pjesës hyrëse të fjalorit, ndërsa nuk disponohet dokumentacion që vërteton kryerjen e pagesës nga shtëpia botuese, apo mbajtja e tatimit në burim për shkak se kanë kaluar afatet e ruajtjes së dokumentacionit. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.02.2020, DRT-ja Tiranë pohon se nuk ka të dhëna të plota dhe nuk ka një sistem unik informatik dhe është në pamundësi të vërtetimit të pagesës së tatimit në burim deri në dhjetor të vitit 2014.



Subjekti kërkon nga Kolegji që për këto të ardhura të zbatohet nenin 32, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, pasi ajo gjendet në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që dokumenton të ardhurën dhe justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, pasi ai nuk mund të merret në rrugë tjetër, për aq kohë sa DRT-ja Tiranë është në pamundësi të vërtetimit të pagesës së tatimit në burim. Ndërkohë që nuk është ruajtur dokument për kryerjen e pagesës së tatimeve nga bashkëshorti, si dhe i ndjeri A. Dh. nuk jeton më, që të mund të konfirmonte pagesën dhe pagimin e tatimit nga shtëpia botuese.

**ii.** Kolegji, lidhur me pretendimin e subjekti për të përfshirë shumën 200.000 lekë si të ardhur të ligjshme në analizën e viteve 2003, 2004 dhe 2005, çmon se për sa kohë për këto të ardhura subjekti, në kuptim të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka dështuar të provojë pagesën e përfituar dhe pagimin e detyrimeve tatimore lidhur me to, kjo shumë nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme, në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të të njëjtit ligj dhe të bëhet pjesë e analizën financiare të këtyre viteve si e tillë.

**19.6.** Në përfundim të kësaj analize, Kolegji konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të ardhurat e krijuara prej bashkëshortit para martesë e që kanë shërbyer për shlyerjen e kësteve të apartamentit deri në datën 04.07.2005, në vlerën prej 4.892.290 lekësh<sup>26</sup>, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**19.7.** Komisioni, lidhur me pasurinë apartament dhe garazh të ndodhur në Tiranë, pasi ka kontrolluar edhe burimin e financimit të deklaruar si të përdorur për blerjen e kësaj pasurie që përfaqësohet nga huaja e marrë nga bashkëshorti i subjektit prej babait të tij, ka konkluduar se *[...] rezulton se ka bërë deklaram të rremë në deklaratën vetting, për sa i përket natyrës së marrëdhënies juridike, nëpërmjet së cilës bashkëshorti i saj ka përfituar si burim për krijimin e pasurisë, shumën prej 30.000 (tridhjetë mijë) eurosh, të cituar si një prej burimeve financiare për krijimin e kësaj pasurie, duke u gjendur para kushteve të parashikuara nga gerrat “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

**19.8.** Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këto konkluzione të Komisionit duke adresuar mosdakordësinë e saj për çdo disponim të vendimit që lidhet me këtë pasuri, referuar burimit të krijuar nga huaja e deklaruar, si edhe të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit. Ajo ka pretenduar se *konkluzioni i Komisionit se subjekti ka kryer deklaram të rremë në deklaratën vetting, për sa i përket natyrës së marrëdhënies juridike, nëpërmjet së cilës bashkëshorti ka përfituar si burim për krijimin e pasurisë shumën 30.000 euro, është tërësisht i padrejtë dhe i gabuar, pasi: (a) huaja e marrë nga personit i lidhur (bashkëshorti) prej babait të tij provohet të jetë krijuar me burim dhe të ardhura të ligjshme të familjes së origjinës së bashkëshortit, të cilat janë deklaruar në deklaratën vetting; (b) kjo hua duhet konsideruar si detyrim para martesë dhe vetjak i personit të lidhur (bashkëshortit) dhe jo si një detyrim i bashkësisë familjare.*

**19.9.** Lidhur me huan, si burim krijimi të pasurisë apartament dhe garazh, në vendimin e Komisionit është konkluduar se: *Për më tepër, kontrata e huas e deklaruar se është lidhur mes z. E. P. dhe babait të tij, e cila përcakton kthimin e shumës në pesë vjet, fakti i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit se të ardhurat kanë qenë edhe të z. V. P. dhe se ai ka punuar në emigracion dhe pa dokumente e në kushte modeste, si dhe moskthimi i kësaj huaje deri në vitin 2019 (rreth 14 vjet më vonë) duket aspak realiste për natyrën e një marrëdhënie huaje, analizuar edhe me pamundësinë financiare të familjarëve të tij për ta pasur në dispozicion këtë shumë, për sa rezulton nga një analizë e thjeshtë logjike e matematike e të ardhurave të tyre të deklaruara prej subjektit, të çojnë në konkluzionin se subjekti nuk ka arritur të provojë as marrëdhënien e huas së deklaruar prej tij dhe as burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur (babai i subjektit) për të krijuar këtë pasuri apo z. V. P..*

<sup>26</sup> Ekuivalent me shumën 39.910 euro.

*Mbetet, gjithashtu, i paprovuar pretendimi i subjektit se shuma e dhënë hua vjen nga të ardhurat e vëllait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. V. P., të krijuara nga puna e tij në emigracion, duke paraqitur si provë vetëm faktin se ai ka qenë emigrant. Të dhënat e prezantuara, nuk provojnë të ardhurat e pretenduara dhe as dhënien e huas, në funksion të detyrimit që ka subjekti i rivlerësimit në këtë proces, për të provuar me dokumentacion burimet e krijimit të pasurisë që ai ka në pronësi, posedim apo përdorim të tij.*

*Mbështetur edhe në praktikën e Kolegjit, me qëllim që remitancat të vlerësohen gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit si të ardhura të ligjshme, nevojitet që ato të provohen se janë dërgesa vlerash monetare të emigrantëve shqiptarë në vendin e origjinës, të cilat janë realizuar nga burime të ligjshme dhe për të cilat janë përmbushur detyrimet përkatëse tatimore në vendin e krijimit.*

**19.10.** Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të subjektit që i adresohen konkluzioneve të Komisionit për marrëdhënien e huas së personit të lidhur me babin e tij, Kolegji analizoi së pari deklaratimet e subjektit, lidhur me këtë marrëdhënie në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike, në funksion të kontrollit të konkluzionit të Komisionit për deklaratimet e rreme lidhur me këtë fakt.

**19.11.** Nga aktet e analizuara në funksion të këtyre pretendimeve, kanë rezultuar faktet e mëposhtme. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit, për pasurinë apartament, në Tiranë, me vlerën 83.500 euro, ka deklaruar se kjo pasuri është në posedim të saj me bashkëshortin, por e regjistruar në ZRVPP-në Tiranë më datë 01.10.2013 vetëm në pronësi të tij, pasi është krijuar para martesë mbi bazën e kontratës së sipërmarrjes të datës 15.03.2004, me të ardhurat e tij personale. Sipas pretendimit të subjektit, kjo pasuri gjendet e deklaruar në rubrikën e pasurive të saj, pasi ajo e posedon atë dhe se kalimi i pronësisë është kryer gjatë martesës në bazë të kontratës së shitjes datë 28.07.2013. Një prej burimeve të krijimit të kësaj pasurie është edhe huaja në vlerën prej 30.000 eurosh e marrë prej bashkëshortit të babai i tij, burim i cili i është nënshtruar kontrollit të Komisionit, në përputhje me parashikimin e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

**19.12.** Lidhur me këtë burim financimi, në deklaratën *vetting* në rubrikën e deklaratimit të detyrimeve financiare ndaj personave fizik dhe juridik, subjekti ka deklaruar detyrimin e personit të lidhur E. P., për shumën 30.000 euro, në zbatim të kontratës së huas, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.02.2006, si hua pa interes në vitin 2005 marrë nga babai i personit të lidhur, z. S. P., me qëllim pagimin e kësteve të kontratës së sipërmarrjes për apartamentin dhe garazhin, në Tiranë. Huaja është marrë për një afat 5-vjeçar, megjithëse ky afat ka kaluar detyrimi nuk është përmbushur, pasi ai nuk është kërkuar të përmbushet nga huadhënësi për shkak të marrëdhënies së posaçme prind-fëmijë me huamarrësin, por edhe as nuk është falur nga huadhënësi. Po në deklaratën *vetting*, në rubrikën e deklaratimeve konfidenciale, subjekti ka deklaruar se huadhënësi S. P., babai i bashkëshortit, huan e ka dhënë nga *kursimet familjare* të krijuara nga të ardhurat nga paga dhe puna private e huadhënësit si mjek, të ardhurat nga migracioni i djalit V. P.<sup>27</sup>, emigrant në Itali që prej vitit 1999, si dhe paga e bashkëshortes si arsimitare.

**19.13.** Në deklaratën vjetore periodike të vitit 2006, në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar detyrimin e bashkëshortit ndaj z. S. P., në shumën 30.000 euro, sipas kontratës së huas së datës 14.02.2006.

---

<sup>27</sup> Në dosjen e fashikullit të hetimit administrativ, vëllai i bashkëshortit të subjektit herë referohen me emrin V. P. e herë me emrin V. P.. Nga aktet e sjella nga subjekti, për të provuar të ardhurat e tij të lidhmë të lëshuara nga shteti italian, ai figuron me emrin V. P..

**19.14.** Subjekti kundërshton qëndrimin e Komisionit se ka deklaruar vetëm përgjatë hetimit administrativ se vëllai i bashkëshortit V. P., emigrant prej vitit 1999 në Itali, ka kontribuar për krijimin e shumës 30.000 euro, duke pretenduar se këtë të dhënë ajo e ka deklaruar në deklaratën *vetting*<sup>28</sup>.

**19.15.** Referuar deklaratimeve të subjektit, Kolegji çmon se pavarësisht faktit që ajo në deklaratën *vetting*, për pasurinë apartament në Tiranë, nuk ka identifikuar në rubrikën e deklaramit të pasurive si burim financimi huan e marrë nga bashkëshorti prej babait të tij, në kushtet kur kjo hua është e detajuar në pjesën e deklaratimeve konfidenciale të po së njëjtës deklaratë, nuk duhet të klasifikohet si deklarim i pasaktë i burimit të financimit të kësaj pasurie. Në kuptimin formal, subjekti duket se ka deklaruar në deklaratën *vetting*, ndonëse jo në rubrikën e dedikuar, burimet e krijimit të kësaj shume të marrë hua, duke përmendur në të edhe vëllain e personit të lidhur si kontribuues financiar i shumës, për pasojë në kuptimin formal duket se subjekti e ka deklaruar këtë fakt, jo vetëm gjatë hetimit administrativ, por edhe në deklaratën *vetting*.

**19.16.** Lidhur me të dhënat e deklaruara për këtë fakt, rezulton se në kontratën e huas, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.06.2006, huadhënësi S. P. dhe huamarrësi E. P. kanë përcaktuar se *huaja në shumën 30.000 euro është dhënë në janar të vitit 2005, me kushtin që ajo të likuidohet plotësisht brenda një afati 5-vjeçar në janar të vitit 2010*. Kolegji, ashtu si edhe Komisioni, konstaton se në deklaratimet periodike vjetore nga vitit 2006 e deri në plotësimin e deklaratës *vetting* kjo hua është deklaruar si detyrim në shumën e plotë të saj prej 30.000 eurosh, gjë e cila dëshmon për mosshlyerjen e saj brenda afatit 5-vjeçar të përcaktuar në kontratë. Sipas fashikullit të hetimit administrativ, rezulton që Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit për arsyet e mosshlyerjes së kësaj huaje. Në përgjigje, subjekti më datë 31.01.2020 ka shpjeguar se për shkak të klimës së ngrohtë familjare midis bashkëshortit dhe prindërve të tij ka ndodhur që kërkimi i shlyerjes së kësaj huaje në afat të mos jetë paraqitur deri në korrik të vitit 2019 nga babai i bashkëshortit. Subjekti, gjithashtu, shpjegon se në korrik të vitit 2019 vëllai i bashkëshortit V. P. është zhvendosur në ShBA dhe, me këtë rast, për shkak të nevojave të pritshme për likuiditete, me kërkesën e babait, bashkëshorti i saj ka kryer kthimin e huas në llogarinë bankare të babait të tij, S. P.. Pas këtij shpjegimi të subjektit, Komisioni i ka kërkuar asaj të paraqesë dokumentacion verifikues se si është transferuar shuma 20.000 euro nga shtetasi S. P. drejt V. P., në vitin 2019. Për këtë kërkesë, subjekti ka shpjeguar se nuk ka dijeni se çfarë ka bërë vjehri i saj me paratë e transferuara në llogarinë e tij bankare më datë 15.07.2019 dhe se nuk ka deklaruar ndonjëherë se kjo shumë është transferuar te V. P., pasi nuk disponon informacion.

Në ankim, ashtu si edhe përgjatë hetimit administrativ, subjekti kërkon që moskthimi i huas brenda afatit 5-vjeçar të vlerësohet nga Kolegji, duke konsideruar ekzistencën e një marrëdhënie të posaçme prind-fëmijë, të faktit që huaja e dhënë nga prindërit ka shkuar për blerjen e apartamentit, jo vetëm të familjes së subjektit, por edhe të banesës tek e cila vetë

---

<sup>28</sup> Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting* në rubrikën e deklaramit të detyrimeve financiare ndaj personave juridik dhe fizikë, ka deklaruar se: *Detyrimi i personit të lidhur E. P. për llogari të kontratës së huas me nr. {\*\*\*} prot., datë 14.02.2006, redaktuara pranë notere T. M.. Detyrim prej 30.000 eurosh është marrë si hua pa interes në vitin 2005 nga babai personit të lidhur E. P., z. S. P., me qëllim për të paguar këstet e kontratës së sipërmarrjes për apartamentin dhe garazhin e porositur, sipas kontratës së sipërmarrjes të vitit 2004 të deklaruar rregullisht. Huaja është marrë për një afat 5-vjeçar. Megjithatë ky afat ka kaluar detyrimi nuk është përmbushur, pasi ai nuk është kërkuar të përmbushet nga huadhënësi, për shkak të marrëdhënies së posaçme prind fëmijë me huamarrësin, por dhe as nuk është falur nga huamarrësi.*

*Po në deklaratën *vetting*, subjekti, në rubrikën e deklaratimeve konfidenciale, ka deklaruar se: Huadhënësi është babai i personit të lidhur dhe huaja është dhënë nga kursimet familjare të krijuara nga të ardhurat nga paga dhe puna private e huadhënësit si mjek, të ardhurat nga emigracioni të djalit V. P. emigrant në Itali nga viti 1999, si dhe nga paga e bashkëshortes si arsimtare.*

prindërit e bashkëshortit kanë jetuar për një kohë të konsiderueshme, si dhe të faktit se ajo dhe bashkëshorti i saj i kanë në përkujdesjen e tyre të vazhdueshme prindërit e bashkëshortit dhe kjo për shkak të marrëdhënieve të mira dhe të ngrohta familjare. Në këtë kuptim, subjekti kërkon që Kolegji moskthimin në kohë të shumës së marrë hua të mos e konsiderojë si një mospërbushje detyrimi të një kontratë huaje, por ta vlerësojë duke e konsideruar këtë marrëdhënie në kontekstin e ndihmës dhe të mbështetjes së ndërsjellët familjare.

**19.17.** Pavarësisht arsytimit të mësipërm, sipas të cilit në kuptimin formal subjekti kishte deklaruar në deklaratën *vetting* vëllain e personit të lidhur si një prej financuesve të shumës së dhënë hua, Kolegji konstatoi se subjekti nuk ka bërë të njëjtin deklaram për burimet e krijimit të kësaj shume të dhënë hua në DPV-në e vitit 2006, në të cilën e ka deklaruar për herë të parë këtë marrëdhënie, duke qenë se në të ka deklaruar se marrëdhënia e huas është lidhur mes personit të lidhur dhe babait të tij dhe jo të gjithë familjes së origjinës. Të njëjtën përmbajtje të drejtash dhe detyrimesh e gjejmë të përshkruar edhe në kontratën e huas nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.02.2006, të lidhur mes personit të lidhur dhe babait të tij, në të cilën palët deklarojnë se kjo marrëdhënie ekziston mes këtyre dy personave. Në këto rrethana, duke analizuar përmbajtjen e këtyre deklarimeve dhe përgjigjet e shpjegimet e dhëna në përgjigje të pyetësorëve nga subjekti rivlerësimit përgjatë hetimit administrativ se babai i personit të lidhur ka administruar edhe të ardhurat e djalit të tij, V. P., të realizuara nga ai në emigracion, për shkak se kanë qenë në gjendje familjare të përbashkët, të cilat kanë shërbyer për të krijuar 20.000 euro nga shuma e dhënë hua, Kolegji vlerëson se ato janë përpjekje të subjektit për të zgjeruar bazën e burimeve financiare, të cilat mund të justifikonin deri në fund të vitit 2004 krijimin e shumës prej 30.000 eurosh, me qëllim provimin e ligjshmërisë së saj në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

**19.18.** Pretendimi i subjektit se të ardhurat e vëllait të saj administroheshin nga babai, për shkak të të qenurit në një gjendje familjare, sipas regjistrimit në regjistrat e gjendjes civile, duken të pabesueshme, duke qenë se distanca fizike e djalit V. P. me familjen e tij, ndonëse në një gjendje familjare, sipas një logjike të thjeshtë, e pamundësonte funksionimin e ekonomisë së tij si një ekonomi e përbashkët me familjen e origjinës dhe aq më shumë administrimin e çdo të ardhure të krijuar prej tij në Itali, nga babai i tij që ndodhej në Shqipëri, për sa kohë që dërgesat e pretenduara të parave nuk provohen që të jenë dedikuar krijimit të shumës së dhënë hua, por shfaqen si një normalitet *quasi* i përditshëm i zotërimit të tyre.

**19.19.** Në vijim të këtij arsytimi, bëhet i pabesueshëm edhe deklarimi i subjektit vetëm përgjatë hetimit administrativ se në të vërtetë huaja e marrë prej babait të personit të lidhur, të deklaruar në shumën 30.000 euro, i takon në shumën 20.000 euro vëllait të personit të lidhur dhe vetëm 10.000 euro babait të tij. E vendosur në këto terma, për sa i përket raportit të detyrimit, do të ishte e natyrshëm të deklarohet se kjo hua i përkiste vëllait në plan të parë e më pas babait të personit të lidhur, ndërsa konstatohen deklarime të ndryshme të subjektit dhe personit të lidhur në këtë drejtim, qoftë në deklaratat periodike dhe në deklaratën *vetting*, në të cilën titullar i marrëdhënies deklarohet babai, qoftë edhe në vetë kontratën e huas të vitit 2006.

**19.20.** Gjithashtu, nga hetimi administrativ ka rezultuar se huaja e marrë prej babait të personit të lidhur, ndonëse në kontratën e huas së vitit 2006 parashikohej se duhej të kthehej brenda 5 viteve, është deklaruar si një deklaram i mbartur në deklaratën *vetting*, detyrim i cili ka vazhduar deri në nisjen e hetimit administrativ nga Komisioni, për kryerjen e procesit të rivlerësimit të subjektit. Pavarësisht faktit se siç pretendon subjekti i rivlerësimit, shlyerja e këtij detyrimi nuk është kryer pas dërgimit të rezultateve të hetimit prej Komisionit, por më parë, në korrik të vitit 2019, sërish ky moment përkon me nisjen efektive të kryerjes së hetimit dhe e vendos këtë ngjarje plotësisht në kontekstin e rrethanave që lidhen me procesin e rivlerësimit, duke konfirmuar faktin se përmbushja e detyrimit duket se është bërë në funksion të këtij procesi dhe jo në përmbushje të detyrimit që vinte nga kontrata e huas, për të cilin personi i lidhur dhe

subjekti gjendeshin në vonesë, tashmë prej 10 vitesh. Pavarësisht marrëdhënies së posaçme që ka ekzistuar mes personit të lidhur dhe babait të tij, të cilat mbahen në konsideratë në të gjithë analizën që i bëhet këtij fakti juridik, Kolegji sjell në vëmendje se analiza bëhet mbi deklaratimet e subjektit, për të verifikuar besueshmërinë e tyre në kuadër të detyrimeve që organet rivlerësimi kanë në funksion të këtij procesi. Për këtë arsye, për të përcaktuar besueshmërinë e deklaratimeve të subjektit për këtë marrëdhënie që ka kontribuar për financimin e apartamentit në të cilin ajo jeton së bashku me familjen, analiza krahasimore e logjike e deklaratimeve të saj dhe rrethanave që provohen nga hetimi edhe në kontekstin e një marrëdhënie të posaçme konsiderohet si një detyrë e organeve të rivlerësimit e ushtruar brenda diskrecionit të tyre, që vjen për shkak të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, prandaj natyra e marrëdhënies familjare, sigurisht që ka peshën e saj në këtë analizë, por nuk mund të konsiderohet si faktori i vetëm përcaktues në të.

**19.21.** Gjithashtu, konstatohet se pretendimi i subjektit se huaja është shlyer në vitin 2019, për shkak se ajo është e kërkueshme vetëm tani, pasi vëllai i subjektit gjendej në nevojë financiare për të pasur mbrapsht kontributin e tij, sepse kishte fituar të drejtën të emigronte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet aplikimit në programin e lotarisë amerikane, gjendet jo bindës dhe i pambështetur në rrethanat faktike të konstatuara nga hetimi. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar dhe është evidentuar fakti se shuma prej 30.000 eurosh të shlyera babait të personit të lidhur, nëpërmjet transaksionit bankar në datën 15.07.2019, gjendeshin serish në llogarinë bankare të babait të personit të lidhur, ndonëse subjekti kthimin e tyre e kishte kushtëzuar me nevojën e vëllait për likuiditet për shkak të emigracionit në ShBA (në korrik të vitit 2019). Nevoja e deklaruar si shkak për kërkimin e kthimit të shumës do të kishte provokuar edhe kthimin e kësaj shume të vëllai i subjektit, përderisa ky deklarohet prej subjektit se ka qenë motivi i kërkimit të huas pas kalimit të 14 viteve nga marrja e saj dhe vetë marrëdhënieve të posaçme familjare mes palëve. Fakti që kjo shumë nuk ka pësuar lëvizje në llogari të tjera, mbështet konkluzionin logjik se ky transaksion është kryer vetëm për llogari të procesit të rivlerësimit dhe afekton besueshmërinë në deklaratimet e subjektit rreth ekzistencës së kësaj marrëdhënie dhe termave të saj. Këtij elementi i shtohet edhe fakti që personi i lidhur dhe subjekti kishin pasur në vite një situatë financiare me gjendje likuiditet në sistemin bankar të kënaqshme dhe që mundësonte kthimin e huas drejt personit tjetër të lidhur shumë kohë më parë, ngjarje që në mënyrë të pashpjegueshme nuk ka ndodhur duke zhvlerësuar sërish besueshmërinë në deklaratimet e subjektit.

**19.22.** Në vlerësimin e këtyre rrethanave, mbahet në konsideratë edhe fakti se kontrata e huas e lidhur mes personit të lidhur dhe babait të tij më datë 16.02.2006, është nënshkruar vetëm disa ditë pas lidhjes së martesës ligjore të subjektit me personin e lidhur, ndërsa duket se marrëdhënia e tyre ka ekzistuar kohë më parë, ndërsa vetë subjekti ushtronte funksionet e gjyqtarës<sup>29</sup>. Kjo e dhënë, duke u analizuar në raport me deklaratimet e subjektit se kontrata e huas ka pasur për qëllim të formalizonte marrëdhënien e posaçme mes bashkëshortit e babait të tij, pas lidhjes së martesës, duket se sërish e vendos lindjen e këtij veprimi juridik në mënyrë të pazgjydhshme me deklaratimet e pasurisë që personi i lidhur do të bënte për shkak të qenies së tij si subjekt deklarues që në atë kohë. Për këtë arsye, afërsia familjare e ngritur dhe pretenduar me forcë nga subjekti se ka shoqëruar këtë veprim juridik, duket se vendoset nën dritën e mosbesimit me nënshkrimin e një akti noterial mes babait dhe fëmijës, aq më tepër kur termat e këtij akti rezultojnë të jenë të pasakta, referuar deklaratimeve të subjektit, qoftë në drejtim të zotëruesit të shumës, qoftë në drejtim të respektimit të kohës së kthimit. Hartimi i një akti të tillë, pas martesës së subjektit me personin e lidhur, që duhet se as ka pasqyruar të vërtetën në përmbajtje, por që as është respektuar në afate, zbeh sërish besueshmërinë e deklaratimit për ekzistencën e një marrëdhënie të tillë.

---

<sup>29</sup> Subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë më datë 08.02.2006 dhe fëmija i parë ka lindur më datë 16.02.2006.

**19.23.** Në vlerësimin e Kolegjit, analiza e deklarimeve të subjektit lidhur me vetë marrëdhënien e huas është ndërthurur me analizën e burimeve të krijimit të kësaj shume prej subjekteve të identifikuar se kanë kontribuar në krijimin e saj, si elementë, të cilët së bashku do t'i japin përgjigje çështjes së ngritur prej subjektit në raport me qëndrimin e Komisionit se ajo ka bërë deklarime të rreme, lidhur me natyrën e kësaj marrëdhënie dhe burimet e krijimit të saj. Në këtë kuptim në vijim, kjo marrëdhënie do të analizohet edhe në drejtim të kontrollit të burimeve të deklaruara se janë përdorur për krijimin e saj.

**19.24.** Lidhur me burimin e krijimit të shumës 30.000 euro të marrë hua nga bashkëshorti i subjektit prej babait të tij, subjekti në ankim pretendon të kundërtën e qëndrimit të vendimit të Komisionit, pasi ajo pretendon se me përgjigjet për rezultatet e hetimit administrativ i ka dorëzuar Komisionit dhe dokumentacion justifikues për të ardhurat e prindërve dhe të vëllait të bashkëshortit. Subjekti në ankim, gjithashtu, shpjegon se mbështetur në certifikatën familjare<sup>30</sup> rezulton se z. S. P. ka qenë kryefamiljari i familjes së përbërë nga bashkëshortja P. P. dhe djali V. P., deri në shkaputjen e këtij të fundit më datë 31.12.2018. Në këto kushte, duke qenë në të njëjtën përbërje familjare, e gjithë familja ka pasur një ekonomi të përbashkët<sup>31</sup>, e cila administrohej nga babai i bashkëshortit. Sipas subjektit, familja Prifti ka dokumentuar të ardhura në shumën totale prej 59.500 eurosh (1.928.079 lekë ekuivalente me 15.302 euro të ardhura nga babi i bashkëshortit nga puna si mjek dhe 1.263.711 lekë ekuivalente me 10.029 euro të ardhura nga puna e nënës si arsimtare, si dhe shumën 34.347 euro nga puna e V. P., në Itali), të cilat justifikojnë plotësisht dhënien e shumës prej 30.00 eurosh bashkëshortit të saj, si dhe shumat e depozituara në banka (537.125 lekë pranë BKT-së, si dhe shumën 1.030 euro pranë BKT-së, në emër të P. P.). Në ankim, subjekti deklaron për dhënien e kësaj shumë në cash bashkëshortit të saj nga i ati në janar të vitit 2005 dhe një pjesë e saj, me sa kujton ai, është tërhequr nga nëna e tij në bankë.

**19.25.** Subjekti së bashku me shpjegimet për rezultatet paraprake të hetimit ka paraqitur në Komision dokumentacionin<sup>32</sup> justifikues, i cili është trajtuar në vijim dhe mbi bazën e të cilit është kryer një analizë financiare, sipas parimit të përfshirjes vetëm të të ardhurave të familjes dhe shpenzimeve bazike mbi kostot e jetesës për personat e tjerë të lidhur, me qëllim evidentimin e mundësinë financiare të personave të tjerë të lidhur, për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua bashkëshortit të subjektit.

**19.26.** Komisioni ka verifikuar burimet e deklaruara se kanë kontribuar për financimin e shumës prej 30.000 eurosh, sipas rregullit të parashikuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke analizuar këto burime edhe në versionin e ngritur prej subjektit se ato përbëhen në vlerën prej 10.000 euro në zotërim të babait të personit të lidhur dhe diferenca prej 20.000 eurosh në zotërim të vëllait të personit të lidhur, pavarësisht qëndrimit që Komisioni ka mbajtur për

<sup>30</sup> Certifikatë familjare e datës 17.08.2020, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Korçë.

<sup>31</sup> Si term të përafërt me "ekonomi të përbashkët familjare" në kuptim të efektit që ai ka në përllogaritjen e shpenzimeve e gjejmë:

- Tek INSTAT, i cili e përkufizon atë: "Statistikat e konsumit sigurojnë përshkrime të nivelit dhe strukturës së shpenzimeve për konsum të Njësive Ekonomike Familjare (NjEF) me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri, si dhe të treguesve të tjerë me bazë shpenzimet e konsumi".
- Sipas Fjalorthit Ekonomik: Familje është bashkësi e prindërve, e fëmijëve dhe e të afërmeve të tjerë, që jetojnë e banojnë së bashku; tërësia e njerëzve që rrjedhin nga një paraardhës i përbashkët: kryetari i familjes kryefamiljari; krijoi familje (bised.) u martua. (shih <https://fjalorthi.com/familjar>).

<sup>32</sup> Dokumentacioni justifikues i paraqitur nga subjekti, për huan me shpjegimet për rezultatet paraprake të hetimit, janë: shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 19.05.2020, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Korçë, në të cilën jepen të dhëna mbi vjetërsinë në punë të S. P. (punësuar që prej vitit 1967 deri në vitin 2006, në strukturat spitalore me profesion mjek) dhe P. P. (punësuar si arsimtare që prej 1970 deri në vitin 2007), si dhe të vërtetimit për bazën e vlerësueshme për periudhën 1994-2007 me të dhëna për pagën mbi të cilën është derdhur kontributi i sigurimeve shoqërore për të dy personat e sipërcituar.

vërtetësinë e këtyre deklarimeve, të cilat në konkluzionin final i ka konsideruar si të rreme. Në mbështetje të deklarimeve të subjektit, Komisioni ka hetuar llogaritë bankare të së ëmës dhe të atit të bashkëshortit të subjektit. Nga hetimi i të dhënave që disponohen në fashikull ka rezultuar se në emër të P. P. ka pasur veprime bankare pranë “Raiffeisen Bank”<sup>33</sup> dhe “ProCredit Bank”<sup>34</sup>, por këto veprime rezultojnë pas datës së dhënies së huas (janar 2005). Gjithashtu, nga hetimi i ka rezultuar që nëna e bashkëshortit ka depozituar pranë BKT-së në datën 18.10.2002 shumën prej 537.125 lekësh dhe 1.030 eurosh<sup>35</sup>, por këto vlera nuk rezultojnë të jenë tërhequr rreth datës së dhënies së huas. E njëjta situatë i ka rezultuar Komisionit dhe për të atin e bashkëshortit, i cili rezulton të ketë hapur depozitë në vlerën 34.530 lekë më datë 18.10.2002, pranë BKT-së, por fondet janë tërhequr pjesërisht vetëm në datën 16.08.2013. Ndërsa veprimet pranë “Intesa Sanpaolo Bank” rezultojnë në hapjen e një llogarie page duke filluar nga data 19.04.2005, e cila përsëri rezulton e çelur pas dhënies së huas. Komisioni ka hetuar mbi mundësinë e krijimit të shumës 10.000 euro nga babai i bashkëshortit të subjektit (duke konsideruar se 20.000 euro janë dhënë nga vëllai i bashkëshortit (*pavarësisht se Komisioni ka konkluduar se ky është një deklaram i rremë*) dhe duke u mbështetur në shpjegimet e subjektit<sup>36</sup> se burimi i krijimit të tyre kanë qenë të ardhurat e krijuara nga paga dhe puna si mjek, si dhe të ardhurat nga paga e bashkëshortes si arsimtare. Sipas Komisionit nga korrespondenca me organet tatimore<sup>37</sup>, si dhe me Drejtorinë Rajonale të ISSh-së<sup>38</sup> nuk kanë rezultuar të dhëna lidhur me të ardhurat e prindërve, për më tepër që edhe vetë subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues për to.

**19.27.** Gjithashtu, Komisioni ka bërë edhe një vlerësim të mundësive të vëllait të personit të lidhur, V. P., për të financuar dhënien e huas në vlerën prej 20.000 eurosh, nga i cili, referuar të ardhurave të tij të ligjshme në Itali përgjatë vitit 2004<sup>39</sup>, duke qenë se subjekti ka pretenduar se huaja ka filluar të jepet në fillim të vitit 2005, ka konkluduar se ai nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar atë.

**19.28.** Në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit, nga analiza e kryer në Kolegj për mundësinë për kursim të prindërve të bashkëshortit të subjektit, duke u referuar në të dhënat që faktojnë të ardhurat e tyre të ligjshme, rezulton se nëna e bashkëshortit P. P. për periudhën 1994-2004 ka pasur mundësi për të kursyer shumën 556.934 lekë, ndërsa babai i bashkëshortit S. P., për të njëjtën periudhë, ka pasur mundësi të kursejë shumën 844.214 lekë.

**19.29.** Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjatë hetimit administrativ në Komision edhe akte me anë të të cilave synon të provojë të ardhurat e ligjshme të vëllait të bashkëshortit të saj, z. V. P., emigrant në Itali. Si të tilla, për periudhën në të cilën ai ka qëndruar në shtetin

---

<sup>33</sup> Pranë “Raiffeisen Bank”, P. P. ka pasur këto llogari:

- llogari page të çelur në datën 05.12.2006, në të cilën janë kredituar dhe debituar të ardhurat nga pagat deri në datën 27.03.2008, kur është mbyllur llogaria; dhe
- depozitë bankare çelur në datën 29.01.2007, në të cilën janë reflektuar të gjithë depozitimet e shumave me afate të përcaktuara, si dhe përfitimi i interesave të depozitave.

<sup>34</sup> Pranë “ProCredit Bank”, P. P. ka pasur llogari page të çelur në datën 30.03.2005, në të cilën janë kredituar dhe debituar të ardhura nga pagat deri në datën 04.09.2011, kur është mbyllur llogaria.

<sup>35</sup> Statement i BKT-së, për të cilën subjekti pretendon se nuk gjendet në fashikull, por nga kontrolli i dokumentacionit nga ana e Kolegjit, të dhënat e Komisionit janë korrekte dhe mbështeten në korrespondencën e BKT-së.

<sup>36</sup> S. P. ka dalë në pension më 1 mars 2006 (me pension pleqërie në vlerën 27.359 lekë/muaj) dhe P. P. ka dalë në pension më 23 janar 2007 (me pension pleqërie në vlerën 28.785 lekë/muaj.)

<sup>37</sup> Shkresa, me nr. {\*\*\*} prot., datë 21.02.2019, nga DRT-ja.

<sup>38</sup> Shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 13.02.2019 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 05.03.2019, nga ISSh-ja.

<sup>39</sup> Sipas vërtetimit të lëshuar nga shteti italian (INPS) të administruar në fashikullin e hetimit administrativ, rezulton që për vitin 2004 V. P. ka pasur të ardhura në shumën 14.629 euro, nga të cilat, pasi zbriten kostot e jetesës në nivel varfërie në shumën 6.624 euro, rezulton se mundësia e tij për kursim më këtë vit ka qenë në shumën 8.005 euro.

italian me leje qëndrimi të rregullt, subjekti ka paraqitur dokumentacion se ai ka pasur të ardhura nga punësimi në periudhën 10.06.2002 - 31.12.2004, në shumën 34.367 euro, informacion ky i marrë nga vërtetimi i lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve (INPS), i disponuar në fashikull. Ndërsa për periudhën 2000 - 10.06.2002, subjekti ka shpjeguar se V. P. ka qëndruar në Itali si emigrant i paligjshëm dhe ka siguruar të ardhura nga puna në të zezë, të dhëna të cilat subjekti ka deklaruar se nuk i disponon, pasi z. V. P. është në pamundësi për t'i paraqitur.

**19.30.** Kolegji, pasi verifikoi edhe pretendimin e subjektit për mundësinë për kursim të vëllait të personit të lidhur për krijimin e shumës prej 20.000 eurosh, për vitet 2002-2004, periudhë për të cilën subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues për të ardhurat e tij dhe kreu analizën financiare duke aplikuar nivelet me minimale të kostove të jetës në Itali (*në nivele varfërie*), sipas INPS-së<sup>40</sup>, vëren se mundësia e tij potenciale për kursim ka qenë në shumën 18.000 euro, në harkun kohor të këtyre viteve. Konkluzioni i Komisionit se ai nuk i ka pasur këto mundësi duket se vjen për shkak të analizës që i është bërë vetëm të ardhurave të vitit 2004 dhe jo të gjithë periudhës për të cilën subjekti ka paraqitur dokumentacion.

**19.31.** Në konkluzion të analizës financiare të kryer për burimet e krijimit të shumës prej 30.000 eurosh të deklaruar si të marrë hua prej bashkëshortit të subjektit nga babai i tij, ka rezultuar se babai S. P. dhe nëna P. P., të dy së bashku brenda logjikës së një ekonomie të përbashkët, mund të kursenin potencialisht vetëm shumën prej 1.401.149 lekësh<sup>41</sup>, nga të ardhurat e tyre të ligjshme në harkun kohor 1994-2004. Ndërsa vëllai i personit të lidhur, V. P., mund të kursente potencialisht vetëm shumën prej 18.000 eurosh në harkun kohor 2002-2004, duke llogaritur si shpenzime jetese ato të nivelit të varfërisë në shtetin Italian.

**19.32.** Lidhur me pretendimin e subjektit se *kjo hua është marrë nga bashkëshorti para martesë dhe përbën një detyrim vetjak të tij dhe, si e tillë, nuk duhet t'i nënshtrohet kontrollit në funksion të procesit të saj të rivlerësimit kalimtar*, Kolegji analizon sa vijon.

**19.33.** Komisioni, për shkak të kontratës së huas nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.02.2006, të lidhur midis bashkëshortit të subjektit dhe babait të tij dhe deklarimit të kësaj huaje si një nga burimet e krijimit të pasurisë që është në përdorim të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, e ka konsideruar babain e bashkëshortit si person tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe ka kryer kontrollin lidhur me ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume të dhënë hua.

**19.34.** Me ankimin subjekti i rivlerësimit kundërshton klasifikimin si person tjetër të lidhur të babait të bashkëshortit me argumentin se vetëm formalisht kontrata e huas, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., për shumën 30.000 euro, është lidhur më datë 14.02.2006, pasi siç edhe vetë kjo kontratë përcakton realisht shuma prej 30.000 eurosh është marrë nga bashkëshorti në janar 2005, kohë në të cilën subjekti nuk kishte lidhur martesë. Në ankim, ashtu si edhe në observacionet e dhëna mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ, subjekti parashtron se ashtu sikurse ka deklaruar në deklaratën *vetting* për dy pasuritë e paluajtshme të fituara nga bashkëshorti i saj në bazë të kontratës së sipërmarrjes së datës 15.03.2004 dhe çdo detyrim për llogari të kësaj kontrate janë pasuri personale të bashkëshortit të subjektit dhe jo pasuri të bashkësisë, në kuptim të nenit 74 të Kodit të Familjes dhe, njëkohësisht, detyrime vetjake të tij duke qenë se ato janë krijuar nga bashkëshorti para datës së martesës më 08.02.2006, si dhe janë detyrime që janë marrë përsipër para kësaj date dhe ashtu sikurse dokumentohet nga provat ato janë shlyer ekskluzivisht me të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i subjektit.

<sup>40</sup> *Instituti i Italian për derdhjen e kontributeve të sigurimeve për pension nga punësimit (INSP - Istituto Nazionale della Previdenza Sociale).*

<sup>41</sup> *E cila i korrespondon vlerës 11.089 euro.*



**19.35.** Në analizë të këtij qëndrimi të subjektit konstatohet se subjekti, për vlerësimin e të gjithë marrëdhënies së bashkëshortit me babain e tij për huamarrjen e shumës 30.000 euro, referon në përcaktimet e shtojcës 2<sup>42</sup> të ligjit nr. 84/2016 dhe nuk referohen në përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të nenit 3, pikat 11 e 13, nenit 30, si dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

**19.36.** Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore, *së pari* konstatohet se objekt i kontrollit në funksion të procesit kalimtar të rivlerësimit është edhe pasuria në përdorim e subjektit të rivlerësimit, siç rezulton të jetë pasuria apartament me sip. 121 m<sup>2</sup>, në Tiranë, e cila i nënshtrohet vlerësimit në drejtim të ligjshmërisë së krijimit të saj. Ky detyrim rrjedh nga parashikimi i nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pikat 11 dhe 13, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjendet i pasqyruar nëpërmjet detyrimit për deklarim në shtojcën 2 të po këtij ligji. *Së dyti* këto dispozita, por edhe në tërësi përmbajtja e ligjit nr. 84/2016, veçanërisht e nenit 30 të tij, përcaktojnë se nivelet e kontrollit të pasurisë për personin e lidhur (në këtë rast bashkëshorti) janë barazuar me ato të parashikuara për vetë subjektin e rivlerësimit. Dispozitat ligjore në fuqi nuk kanë vendosur kufij apo kufizime në drejtim të këtij kontrolli, duke lënë në diskrecion të organeve të rivlerësimit më pas vlerësimin e rezultateve të këtij kontrolli, si edhe të rezultateve të hetimit në përgjithësi, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit. Por, zbatimi i këtyre parimeve nuk prodhon pengesa apo kufizime për nivelin e kontrollit, me qëllim arritjen e një konkluzioni sa më të drejtë që i afrohet sa më shumë të vërtetës jetësore të subjekteve dhe personave të lidhur në raport me krijimin e pasurive të tyre. Në këto kushte, sa kohë që rezulton se kontrata e huas, midis bashkëshortit të subjektit si huamarrës dhe babait të tij si huadhënës, është lidhur pikërisht disa ditë pas martese dhe ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit tek i cili banon subjekti dhe e gjithë familja, konsiderohet se për shkak të parashikimit ligjor huadhënësi (vjehtëri i subjektit) duhet të konsiderohet si person tjetër i lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Fakti që kontrata e huas, siç vetë subjekti shpjegon, ka filluar të zbatohet në janar të vitit 2005 (para martese) nuk ndikon në klasifikimin e vjehtërit si person tjetër i lidhur, pasi neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 e ka kushtëzuar kualifikimin, sipas kësaj dispozite të një marrëdhënie, vetëm me natyrën e saj, dhurim apo hua, duke e lënë në vlerësimin e organeve të rivlerësimit, analizën rast pas rasti të rrethanave specifike që mund ndikojnë në vlerësimin e situatës, pasi të ezaurohen kërkesat e kësaj dispozite për verifikimin e ligjshmërisë së burimit.

**19.37.** Për më tepër, siç rezulton nga deklaratimet e vetë subjektit se detyrimi për të shlyer këtë hua ka qenë një detyrim që ka shoqëruar ekonominë familjare që nga viti 2006, kur ajo është krijuar, deri në shuarjen e tij me të ardhurat e bashkësisë ligjore, në vitin 2019, e potencon peshën dhe ndikimin e kësaj huaje në pasuritë e krijuara në vite nga familja e subjektit, për sa kohë që ka dhënë si efekt indirekt edhe shtimin e tyre nëpërmjet mosshlyerjes së saj gjatë këtyre viteve. Për të gjitha këto arsye, Kolegji e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit, i cili e ka konsideruar babain e bashkëshortit si person tjetër të lidhur dhe e ka kualifikuar situatën nën parashikimin e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

**19.38.** Në konkluzion të analizës së bërë më sipër lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament dhe garazh, të huas në vlerën prej 30.000 eurosh, Kolegji çmon se deklaratimet e subjektit për ekzistencën e këtij veprimi juridik, vlerën e deklaruar të marrë hua, kohën e kthimit të saj, personat të cilët kanë disponuar shumat në favor të bashkëshortit të subjektit,

---

<sup>42</sup> Në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016 cilësohen si objekt i deklaratimit: *Objekti i deklaratimit: Të gjitha pasuritë e akumuluar, ndër vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.*

kthimin e kësaj shume si derivat i kësaj marrëdhënie, mundësinë e këtyre individëve për të krijuar me burime të ligjshme këtë shumë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, mbetën të paprovuara dhe nuk krijuan bindjen e trupit gjykues se kanë ekzistuar në versionin e deklaruar prej subjektit.

**19.39.** Në këtë konkluzion, Kolegji mbajti në konsideratë, një sërë rrethanash të analizuara gjerësisht si më lart, të cilat përmblihen në vijim: **(i)** koha e nënshkrimit të kontratës vetëm pak ditë pas martesës së subjektit; **(ii)** fakti që në kontratën e huas dhe deklarimet në vite është përcaktuar si huadhënës babai i bashkëshortit dhe në deklaratën *vetting* shtohet si kontribuues edhe vëllai i tij madje në vlerën 20.000 euro, që përfaqëson 2/3 e gjithë shumës, element që do të duhej të ndryshonte edhe përcaktimin mbi titullarin e marrëdhënies; **(iii)** pamundësinë e babait të bashkëshortit që të krijonte me të ardhura të ligjshme, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016 të gjithë shumën e dhënë hua prej 30.000 eurosh; **(iv)** moskthimin e shumës së huas, jo vetëm sipas përcaktimit të kontratës brenda 5 viteve, por edhe në tejkalim të paarsyeshëm e të pabesueshëm të këtij afati dhe mundësimin e këtij veprimi vetëm me nisjen e hetimit administrativ në funksion të procesit të rivlerësimit; **(v)** mosprovueshmërinë e motiveve që subjekti ka deklaruar për të justifikuar kthimin me vonesë të huas, pikërisht në vitin 2019, që lidhen me nevojën për likuiditet të vëllait të bashkëshortit, kur kjo nevojë nuk rezultoi e materializuar me transferimin e parave në favor të tij; **(vi)** krijimin e kësaj marrëdhënie për financimin e pasurisë në të cilën subjekti ka banesën e saj familjare, në kufij të paqartë kohorë e që duken se ndërthuren me periudha, në të cilat subjekti natyrshëm mund të ketë filluar të ndërtojë një të ardhme familjare me bashkëshortin, përfshirë edhe atë ekonomike; **(vii)** pamundësia për të ndërtuar sipas rrethanave që kanë rezultuar nga hetimi një tablo të qartë lidhur me këtë financim (*nëse kanë ndikuar të ardhurat e subjektit apo të bashkëshortit të paprovuara për financimin e apartamentit*). Për shkak të këtij arsytimi, Kolegji arrin në një konkluzion të ndryshëm nga Komisioni lidhur me këtë burim, duke pranuar se ndonëse nuk konfirmohet standardi i një deklarimi të rremë sipas argumentit se nuk provohet e kundërta e asaj që është deklaruar, gjithsesi konfirmohet se subjekti nuk provoi deklarimet e saj për këtë marrëdhënie, duke prodhuar si pasojë mosnjohjen e kësaj shume si burim për krijimin e pasurisë apartament dhe garazh.

**19.40.** Në përfundim, Kolegji konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk provoi vërtetësinë e marrëdhënies së huas të deklaruar mes personit të lidhur dhe babait të tij për vlerën prej 30.000 eurosh, si edhe as ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 nga huadhënësi.

**19.41.** Kolegji, analizën e kryer në drejtim të verifikimit të mundësisë për të financuar me burime të ligjshme pagimin e kësteve të apartamentit dhe garazhit i ka përfshirë pjesë të analizës së vitit kur janë kryer këto pagesa.

- 20.** Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit të ngritura për pasuritë e luajtshme/likuiditet apo mjetet monetare të bashkëshortit, për të cilat ajo pretendon që meqenëse rezultati financiar i analizës për vitet 2011-2012 është pozitive, konkluzioni i Komisionit se subjekti së bashku me bashkëshortin rezultojnë në balancë negative prej (-) 2.408.424 lekësh për pasurinë monetare të krijuara në këtë vit nuk është i drejtë.

**20.1.1.** Në vendimin e Komisionit për pasuritë monetare të bashkëshortit të subjektit është konkluduar se:

*Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka bërë hera-herës derdhje cash në llogaritë e tij bankare (veçanërisht në "Raiffeisen Bank"), për të cilat nuk njihet burimi i tyre. Këto pasuri janë krijuar nga të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj, për të cilat subjekti ka*

detyrimin të provojë burimin e ligjshëm të tyre, në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nga ku rezultuan me balancë negative<sup>43</sup> në vlerën (-) 2.408.424 lekë [...].

Në vlerësim të shpjegimeve të subjektit rezultoi se ajo nuk përcjell dokumentacion apo sqarime të detajuara për secilën nga derdhjet cash në “Raiffeisen Bank”. Në përmbledhje të shpjegimeve të saj rezultoi se për derdhjet cash në “Raiffeisen Bank” nuk provohet me dokumentacion burimi i tyre, ndërsa në lidhje me derdhjet cash në “Intesa Sanpaolo Bank”, pas shpjegimeve duket se vetëm 550.000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë janë derdhje cash (jo 800.000 lekë), me burim të paprovuar nga subjekti.

**20.1.2.** Në ankim, subjekti pretendon se ky konstatim është i gabuar, pasi vjen në kundërshtim me rezultatet e hetimit të Komisionit, i cili ka pranuar se burimet e secilës depozitë apo obligacion të bashkëshortit janë të justifikuar dhe subjekti nuk ka pasur barrë prove për të justifikuar burimin e secilës depozitë apo titull borxhi.

**20.1.3.** Nga analizimi i shpjegimeve që subjekti ka dhënë përgjatë hetimit administrativ në Komision për burimin e krijimit të këtyre depozitave, rezultoi se informacioni i dhënë prej saj i takon vetëm 3 viteve (2007, 2011 dhe 2012), por nuk mbulon të gjithë periudhën e depozitimeve, e cila fillon që prej vitit 2005. Subjekti, si në përgjigje të rezultateve të hetimit, ashtu dhe në ankimin e paraqitur në Kolegj, është fokusuar me shpjegime kryesisht në transaksionet e viteve 2011 dhe 2012, duke mbështetur pretendimin e saj mbi rezultatet pozitive të analizës financiare të kryer në Komision për këto vite. Subjekti pretendon se meqenëse analiza financiare për këto dy vite ka rezultuar në shifra pozitive, është e pakuptimtë balanca negative e konsideruar nga Komisioni në referencë të këtyre depozitave/llogarive bankare.

**20.1.4.** Lidhur me këtë pretendim të subjektit, konstatohet se në vendimin e Komisionit është arsyetuar që nga analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm në vlerësim të shpjegimeve të subjektit, rezultoi se ajo nuk ka përcjellë dokumentacion apo sqarime të detajuara për secilën nga derdhjet cash në “Raiffeisen Bank”, të cilat kanë mundësuar krijimin e gjendjes së llogarisë në vitet 2011-2012, duke konkluduar se nuk provohet me dokumentacion burimi i tyre. Ndërsa në lidhje me derdhjet cash në “Intesa Sanpaolo Bank”, që kanë mundësuar gjendjen në vitet 2011-2012, pas shpjegimeve të subjektit, duket se vetëm shuma 550.000 lekë derdhje cash (jo 800.000 lekë), janë me burim të paprovuar nga subjekti.

**20.1.5.** Për sa më sipër, Kolegji konstaton se derdhjet e konstatuara në llogaritë bankare në emër të bashkëshortit të subjektit, respektivisht pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 550.000 lekë, si dhe pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën 1.835.424 lekë (me një total prej 2.408.424 lekë) janë pasuri/asete likuiditet të krijuara gjatë viteve **2005 – 2015**, për të cilat subjekti duhet të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të tyre. Mbështetur në situatën faktike të dokumentacionit të disponuar në fashikullin e hetimit administrativ, Kolegji ia nënshtroi kontrollit të gjitha kreditimet në këto llogari, duke konstatuar se disa nga këto kreditime fondesh i përkisnin pagesave të kryera nga personi fizik “{\*\*\*}”, si dhe Fondacioni “{\*\*\*}”, për të cilat (siç analizohet në vijim) Kolegji, në ndryshim nga Komisioni, ka konkluduar se

---

<sup>43</sup> Sipas vendimit të Komisionit, diferenca e konstatuar është rezultat akumulativ i gjendjes që rezultoi në llogarinë e bashkëshortit pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, në vlerën 550.000 lekë, si dhe në llogarinë e tij pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën 1.835.424 lekë, sipas të dhënave në vijim:

- Depozitë me nr. {\*\*\*}, me vlerë 2.000.000 lekë, pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, më datë 31.01.2014, e krijuar nga të ardhurat nga paga dhe përktihme, me titullar z. E. P.. Nga hetimi i llogarive rezultoi se pjesërisht kjo depozitë është krijuar nga depozitime cash (përkatësisht 800.000 lekë derdhje cash), të kryera nga bashkëshorti gjatë vitit 2011 – 2012 dhe pjesërisht nga kursimet në bankë nga të ardhurat nga Ministria e Drejtësisë.
- Obligacione me nr. {\*\*\*}, në vlerën 6.457.560 lekë, të emetuara më datë 23.04.2015 dhe me nr. {\*\*\*}, datë emetimi 16.06.2015, pranë “Raiffeisen Bank”, të krijuara nga kursimet nga të ardhurat, me titullar z. E. P..

këto të ardhura përmbushin kushtet për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme, sipas neni 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

**20.1.6.** Në këto kushte, pasi Kolegji përfshiu në analizën e kreditimeve të këtyre llogarive të ardhurat nga personi fizik “{\*\*\*}” e nga Fondacionit “{\*\*\*}” dhe për vitin 2011, situata financiare për obligacionet e investuara pranë “Raiffeisen Bank” rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën prej 751.034 lekësh dhe jo në vlerën prej 1.835.424 lekësh të përlllogaritur nga Komisioni. Ndërsa në llogarinë në “Intesa Sanpaolo Bank”, pas përfshirjes së këtyre kreditimeve të konsideruara si me burim të ligjshëm, mbeti sërish e pambuluar me burime të ligjshme vlera prej 614.796 lekësh, por, meqenëse Komisioni për këtë depozitë kishte arritur në një përlllogaritje më të favorshme për subjektin, Kolegji, në aplikim të parimit *no reformatio in peius*, konsideroi se mbeti e paprovuar me burime të ligjshme vlera e identifikuar nga Komisioni në shumën 550.000 lekë.

**20.1.7.** Përfundimisht, për pasurinë likuiditet lidhur me depozitën pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, si dhe obligacionet pranë “Raiffeisen Bank”, Kolegji konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë krijimin me burime të ligjshme të të ardhurave të depozituara në formën *cash* e që rezultojnë se kanë shërbyer për krijimin e llogarisë depozitë pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, si dhe për obligacionet pranë “Raiffeisen Bank”. Kreditimi në *cash* i këtyre llogarive nga bashkëshortit i subjektit të rivlerësimit përgjatë viteve 2005 - 2012, nuk provohet se është kryer plotësisht me të ardhura të ligjshme, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën prej (-) 1.301.034 lekësh, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, pavarësisht se në një vlerë negative më të vogël se ajo e konkluduar prej Komisionit. Për pasojë, Kolegji arriti në përfundimin se edhe kjo situatë e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

21. Në drejtim të analizës financiare, Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjekti i rivlerësimit, me të cilat ajo kundërshton analizën e Komisionit të bërë për vitet 2003, 2006, 2007, 2008 dhe 2010, duke i analizuar në mënyrë të detajuar si vijon.
22. *Kolegji, në drejtim të analizës financiare të vitit 2003, mori në shqyrtim pretendimet e subjekti të rivlerësimit, me të cilat ajo kundërshton analizën e Komisionit të bërë për të për këtë vit pasi, sipas saj nuk është marrë në konsideratë sqarimi që ka bërë në DVP-në e vitit 2004 se depozita prej 700.000 lekësh ishte krijuar para vitit 2003-2004, fakt që konfirmohet nga të dhënat e “Raiffeisen Bank”.*

**22.1.** Në analizë të këtij pretendimi, Kolegji konstaton se në fashikullin e hetimit administrativ disponohen të dhëna për depozitat e krijuara nga subjekti i rivlerësimit para vitit 2003<sup>44</sup>.

**22.2.** Sipas pretendimeve të subjektit, gjendja negative në vitin 2003 me minus (-) 205.330 lekë nuk është e saktë, pasi depozita prej 700.000 lekësh është krijuar më herët dhe jo në këtë vit, me burim të ardhura të siguruara nga dëmshpërblimi i aksidentit të nënës i ndodhur më datë 11.08.1996, të ardhura nga pensioni i nënës, bursa për vitet 1998-1999 si studente me rezultate ekselente, nga trajtimi financiar në Shkollën e Magjistraturës për periudhën 1999-2001 dhe në periudhën 2001-2003 dhe nga interesat e vetë depozitës. Kolegji, për të verifikuar këtë pretendim të subjektit, iu referua akteve të fashikullit të hetimit administrativ dhe konstatoi se nuk ka të dhëna për kreditime me burim dëmshpërblimin e aksidentit. Në këto kushte, nga

---

<sup>44</sup> Të dhëna të konfirmuara nga korrespondenca me “Raiffeisen Bank”, sipas të cilës subjekti ka disponuar tepricat si në vijim: datë 30.06.1998 – tepricën 200.000 lekë; datë 30.11.1998 – tepricën 419.704 lekë; datë 30.12.1999 – tepricën 526.824 lekë; datë 30.12.2000 – tepricën 810.460 lekë; datë 30.12.2001 – tepricën 913.413 lekë; datë 30.12.2002 – tepricën 932.132 lekë; dhe datë 30.12.2003 – tepricën 912.647 lekë.

Kolegji është bërë një analizë financiare<sup>45</sup> duke filluar nga momenti kur në fashikull ka akte të administruara që dëshmojnë për sigurimin e të ardhurave nga subjekti dhe krijimin e depozitave bankare. Analiza është kryer për periudhën 1998 – 2003, nga e cila ka rezultuar që subjekti nuk ka pasur mundësi për të krijuar këtë depozitë për një vlerë prej (-) 656.021 lekësh. Metodologjia e kryerjes së analizës së Komisionit, duke e vendosur këtë depozitë në analizë si të krijuar në vitin 2003, e ka favorizuar subjektin, pasi sipas kësaj mënyre analize ajo rezulton me situatë financiare negative prej (-) 205.330 lekësh, vetëm në këtë vit dhe jo për periudhën 1998-2003.

**22.3.** Nisur nga ky konstatim, me qëllim mospërkeqësimin e situatës financiare të subjektit edhe nga Kolegji, u konsiderua krijimi i depozitës në shumën 700.000 lekë në vitin 2003, duke e lënë në këtë mënyrë të pandryshuar konkluzionin e analizës së Komisionit për këtë vit.

- 23.** *Lidhur me analizën financiare, Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjektit me të cilat ajo kundërshton analizën e Komisionit për vitin 2006, duke pretenduar se në të nuk janë përfshirë të ardhurat për të cilat bashkëshorti i saj nuk mund të provojë ligjshmërinë e të ardhurave, pasi gjendet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*

**23.1.** Kolegji për analizën ekonomike të vitit 2006 mori fillimisht në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit, lidhur me konkluzionin e Komisionit për mungesën e burimeve të ligjshme për të justifikuar edhe pagimin e kësteve të apartamentit (pas martesë), me të cilin ajo pretendon se të gjitha pagesat e bëra për këtë pasuri në këtë vit janë financuar nga të ardhurat e personit të lidhur me burime të ligjshme nga puna e tij e faktuar si përkthyes, duke pretenduar se këto të ardhura duhet të përfshihen në analizën financiare si të ardhura në vitin korrespondues, kur provohet kjo marrëdhënie angazhimi/shërbimi, duke kërkuar, për këtë arsye, rishikimin e analizës financiare për këto vite:

**23.2.** Në vendimin e Komisionit, për analizën ekonomike të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2016, është konkluduar se:

*Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), për të cilat nuk është paraqitur dokument provues, kontratë apo pagesë në bankë që provon përfitimin e shumës dhe/apo ekzistencën e marrëdhënies së punës, të cilat në vlerë totale janë 2.845.752 (dy milionë e tetëqind e dyzet e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë, trupi gjykues vlerëson se mbetet e paprovuar ligjshmëria e këtyre të ardhurave, dhe se Komisioni në vlerësimin e tij nuk mund të mjaftohet vetëm me deklarin e të ardhurave nga subjekti i rivlerësimit dhe faktin se ato janë deklaruar gjithashtu ndër vite, pasi gjatë hetimit*

---

<sup>45</sup> Në analizën e kryer në Kolegj, janë konsideruar të ardhurat e subjektit për periudhën 1998-2003, ato të përfituara nga puna në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 2001-2002, në një totale prej 502.524 lekësh, nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën 1999-2002, në një total prej 565.730 lekësh, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë për periudhën 1999-2003, në një totale prej 742.580 lekësh. Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur, sipas metodologjisë së Kolegjit në masën 66% për vitin 1999 në një totale prej 37.561 lekësh dhe sipas të dhënave të INSTAT për periudhën 2000-2003, në një totale prej 403.728 lekësh. Në analizë është përfshirë gjendja në vitin 1998 e depozitës pranë "Raiffeisen Bank", në shumën 419.704 lekë, krijimi i së cilës është i pambuluar me burime të ligjshme, pasi subjekti për këtë vit nuk ka depozituar ndonjë informacion për të ardhura të krijuara me burim të ligjshëm. Subjekti pretendon që kjo depozitë, ashtu si dhe depozita në emër të vëllait E. Q. janë krijuar me të ardhurat e përfituara nga dëmshpërblimi nga aksidenti i nënës së ndjerë, por në fashikull mungojnë dokumentacioni justifikues, në lidhje me shumën e paguar dhe kohën se kur ka ndodhur ky transaksion nga agjencia e sigurimit.

*Në analizë janë marrë gjendjet e depozitës në fund të çdo viti, sipas të dhënave në poshtëshënimin nr. 47. Nga kjo analizë, subjekti ka rezultuar me një diferencë negative prej (-) 419.704 lekësh në vitin 1998, (-) 87.771 lekë në vitin 1999 dhe (-) 148.546 lekë në vitin 2000. Në këto kushte, përfshirja e shumës prej 700.000 lekësh, sipas deklaratimit të subjektit në deklaratën fillestare të pasurisë është një veprim në favor të saj, pasi, nëse do ishte konsideruar analiza e mësipërme, subjekti do të rezultonte me diferencë negative më të madhe (-) 656.021 lekë (419.704 lekë + 87.771 lekë +148.546 lekë) se ajo e konstatuar në analizën e vitit 2003 prej (-)205.330 lekësh.*

*nuk u administrua asnjë dokumentacion provues lidhur me përfitimin e pagesës apo pagimin e detyrimeve tatimore dhe as subjekti nuk ka arritur ta provojë këtë fakt.*

*Lidhur me disa shpenzime të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit në vijim të shpjegimeve lidhur me rezultatet e hetimit, Komisioni i ka marrë ato në konsideratë në analizën financiare për vitet 2003 – 2016 duke e rishikuar atë. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit rezultoi me një situatë negative financiare prej (-) 3.591.317 (tre milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekësh.*

*Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në vlerën prej 3.591.317 lekësh (duke marrë në konsideratë vetëm rezultatin negativ të analizës financiare), të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive në formë monetare ose në tituj qeveritarë, në total në vlerën 21.711.962 (njëzet e një milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, si dhe për përballimin e kostove të jetesës dhe shpenzimeve të tjera të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, nuk u provuan nga ajo se përmbushin kriteret e përcaktuara nga pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës për t'u konsideruar të ardhura të ligjshme. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se pasuritë e fituara janë rrjedhojë e fshehjes së detyrimeve fiskale dhe, për rrjedhojë, në kuptim të dispozitave kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli lidhur me pasuritë e sipërcituara, subjekti i rivlerësimit rezultoi të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për t'i justifikuar ato.*

*Për rrjedhojë, shuma prej 3.591.317 (tre milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekësh nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 (këtu nuk përfshihet vlera e huas dhe situata negative financiare e rezultuar para martese).*

**23.3.** Në deklaratimet periodike pas martese dhe konkretisht në DVP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar shlyerje të detyrimit në vlerën 12.000 euro për pasurinë apartament në Tiranë, sipas kontratës së sipërmarrjes. Lidhur me burimet e krijimit të shumave që kanë shkuar pas martese për shlyerje të kësteve të apartamentit në Tiranë, subjekti ka deklaruar se: kësti i 5-të, prej 12.000 eurosh paguar më datë 30.05.2007 (me mandatpagesë) dhe kësti i 6-të, prej 5.190 eurosh (me depozitim në llogarinë e shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, në bankën “CBG Emporiki”) është paguar më datë 05.07.2013, janë kursime nga të ardhurat e deklaruara nga bashkëshorti në vitet 2006, 2007 e në vijim, sipas deklaratave respektive të dorëzuara në ILDKPIK, si dhe të përshkruara në deklaratën *vetting*. Referuar kështit të fundit prej 5.190 eurosh, nga ana e Komisionit është konkluduar se bashkëshorti i subjektit ka pasur burime të ligjshme në vitin 2013 për të shlyer këtë detyrim, fakt i cili konfirmohet dhe nga analiza financiare e këtij viti, e cila rezultoi në një diferencë pozitive prej (+) 191.818 lekësh, ndërsa për sa i përket pagesës së bërë në vitin 2007, prej 12.000 eurosh, Komisioni ka konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve për një vlerë prej (-) 1.398.786 lekësh, e cila përfaqëson praktikisht vlerën e kështit, por shfaqet edhe si balancë negative e vitit 2007.

**23.4.** Në të tilla kushte, Kolegji çmon se për trajtimin sa më të plotë të këtij shkakui ankimi, që ka lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për shlyerjen e detyrimeve për blerjen e apartamenti dhe garazhit në Tiranë, objekt i një analize më të detajuar do të jetë analiza financiare për vitet 2006-2007 (pas martese), duke qenë se analiza e vitit 2006 afektoi atë të vitit pasardhës, *së pari* në drejtim të pretendimeve që subjekti ka në lidhje me zërat e përfshira në analizën financiare dhe *së dyti*, në drejtim të të ardhurave të bashkëshortit të konsideruara dhe të papranuara nga Komisioni.

Kolegji vëren se nga analiza e kryer në Komision rezultoi se në vitin 2006 subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj paraqitet me një diferencë negative të mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat në masë (-) 574.271 lekë dhe për vitin 2007 rezultoi në diferencë negative në shumën (-) 1.398.786 lekë, diferencë e cila, siç u përmend edhe më sipër, lidhet drejtpërdrejtë

me pagesën e këstit të 5-të në vlerën 12.000 euro, për apartamentin dhe garazhin e ndodhur në Tiranë.

**23.5.** Subjekti në drejtim të analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2006 (*përveç pretendimeve që kanë lidhje me mospërfshirjen e të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti nga shërbimi i përkthimit për institucione dhe agjenci të ndryshme, të cilat do të trajtohen në vijim*), pretendon se kjo analizë përmban pasaktësi, të cilat kanë të bëjnë edhe me përlogaritjen e likuiditeteve të deklaruara dhe të disponuara prej të dy bashkëshortëve, që sipas pretendimit të subjekti nuk janë përfshirë në analizë. Konkretisht, subjekti në ankim parashtroi se nga ana e Komisionit në analizën e vitit 2006 nuk është marrë në konsideratë gjendja prej 398.321 lekësh e disponuar në llogarinë bankare të bashkëshortit, e cila ka si burim krijimi kursimet e vitit 2005 e që më pas kanë shërbyer për të mbuluar shpenzimet për mobilimin e apartamentit në këtë vit.

**23.6.** Kolegji mori në shqyrtim këtë pretendim të subjektit që ka të bëjë me saktësinë e analizës financiare të vitit 2006 të kryer nga Komisioni dhe konstatoi se në DVP-në e vitit 2006, në seksionin “*Ndryshimet e interesave private, pasuri e paluajtshme dhe të luajtshme*”, subjekti ka deklaruar: (i) depozitë në vlerën 300.000 lekë, me një afat 6-mujor pranë “Raiffeisen Bank”, me nr. {\*\*\*}, datë 06.02.2007, që rrjedh nga llogaria rrjedhëse; (ii) llogari rrjedhëse pranë “Raiffeisen Bank”, me nr. {\*\*\*}, në shumën 128.000 lekë; (iii) llogari rrjedhëse (page) pranë “Alpha Bank” e bashkëshortit, në shumën 180.000 lekë.

**23.7.** Pretendimi në ankim për analizën e vitit 2006 është bërë, pasi, sipas subjektit, duke iu referuar shifrave të analizës financiare të kryer nga Komisioni, nëse do konsiderojmë të ardhura të njohura prej tij në shumën 1.311.097 lekë, shpenzime jetese në shumën (-) 981.863 lekë, shtim likuiditeti në bankë në shumën (-) 656.099 lekë, si dhe po të përfshijmë në analizë edhe shumën prej 398.321 lekësh, si shumë e disponuar në llogarinë bankare të bashkëshortit e pretenduar prej saj se nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni, rezultati financiar i vitit 2006 do të ishte në vlerën pozitive prej (+) 71.456 lekësh.

**23.8.** Për të analizuar pretendimin e subjektit për analizën e vitit 2006, Kolegji i është referuar dokumentacionit të disponuar në fashikullin e hetimit administrativ në lidhje me të dhënat e llogarisë bankare të bashkëshortit, si dhe të dhënave në lidhje me blerjen e automjetit tip “Ford”.

**23.9.** Nga verifikimi i deklarimeve që subjekti ka dhënë në DVP-në e vitit 2007, me të dhënat që rezultojnë nga praktikat e sjella përgjatë hetimit administrativ nga bankat e nivelit të dytë, rezultoi se depozita prej 300.000 lekësh, në “Raiffeisen Bank”, është krijuar në datën 06.02.2007 dhe jo në fund të vitit 2006, siç pretendon subjekti e, si e tillë, kjo depozitë nuk mund të përfshihet në analizën e vitit 2006. Gjithashtu, Kolegji konstaton se gjendja në llogarinë rrjedhëse pranë “Raiffeisen Bank”, me nr. {\*\*\*}, nuk konfirmohet të jetë në shumën 128.000 lekë nga praktika e sjellë nga kjo bankë dhe e administruar në fashikullin e hetimit administrativ.

Nga verifikimi i statementeve të lëshuara nga bankat e nivelit të dytë, konstatohet se bashkëshorti i subjektit ka disponuar në sistemin bankar në fund të vitit 2006, vetëm shumën 181.829 lekë, e cila kryesisht vjen nga gjendja në llogarinë e disponuar prej tij në “Alpha Bank” në shumën 180.000 lekë, shumën prej 1.760 lekësh e disponuar në llogarinë bankare pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, si dhe shumën prej 69 lekësh në llogarinë bankare pranë “Raiffeisen Bank”. Shuma prej 398.321 lekësh e pretenduar si e kursyer nga bashkëshorti gjatë vitit 2005, për të cilën subjekti pretendon se ka gjurmë në llogaritë bankare të tij, gjendet në statementet bankare që subjekti ka dorëzuar në Komision bashkëlidhur me përgjigjet e pyetësorit nr. 6. Bashkëshorti i subjektit në datën 23.12.2005 ka pasur të depozituara pranë kësaj banke shumën prej 398.321 lekësh, shifër e cila gjatë vitit 2006 është shtuar maksimalisht në vlerën 646.051

lekë e më pas është pakësuar për shkak të tërheqjeve që janë bërë në llogarinë bankare. Në shtator të vitit 2006 kjo depozitë ka rezultuar me gjendje në shumën 41.465 lekë dhe në fund të vitit në vlerën (0) zero lekë. Kolegji vëren se nga ana e Komisionit kjo shumë nuk është reflektuar si gjendje në fillim të vitit 2006 (*fakt i cili do të korrektonte analizën financiare në fund të vitit 2006 në favor të subjekti*), për shkak se ky organ analizën e tij e ka fokusuar vetëm në verifikimin e mundësisë së bashkëshortit për të pasur burimet të ligjshme për të paguar këstet e apartamentit gjatë vitit 2005, nga e cila ai ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme. Në të tilla kushte, Kolegji çmon se me të drejtë Komisioni nuk i ka përfshirë si të ardhura në analizën e viti 2006 gjendjet e llogarive bankare të fillim vitit, pasi për këto shuma nuk ka burime të ligjshme duke qenë se çdo vlerë e konsideruar si e krijuar me burime të ligjshme është përfshirë në analizën e bërë për financimin e apartamentit, e cila ka rezultuar, gjithashtu, me bilanc negativ.

**23.10.** Për sa më sipër, Kolegji çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për përfshirje të shumës 398.321 lekë në analizën financiare të vitit 2006 nuk qëndron, pasi edhe nga ana e Kolegjit analiza e të ardhurave para martese të konsideruara si pjesë e analizës financiare është e njëjtë me atë të konkluduar nga Komisioni dhe, në të tilla kushte, burimi i ligjshëm për krijimin e kësaj gjendje në bankë është përsëri i munguar.

**23.11.** Kolegji, për sa i përket pretendimeve të subjektit në drejtim të analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitit 2006, konstaton se në analizën që vetë subjekti ka kryer mungon përfshirja si shpenzim e vlerës 247.406 lekë, e cila përfaqëson blerjen e autoveturës tip “Ford” të deklaruar në DVP-në e vitit 2006, në pronësi të bashkëshortit të saj. Gjithashtu, Kolegji konstaton se në fashikullin e hetimit administrativ nuk disponohet kontrata e blerjes së këtij automjeti prej bashkëshortit, e cila do të provonte saktësisht datën e blerjes së tij. Për këtë automjet vërehet se nga ana e Komisionit nuk është bërë ndonjë analizë financiare, në lidhje me burimin e ligjshëm të përdorur në kohën e blerjes, por në analizën financiare të vitit 2006 (viti i parë i deklarimit nga bashkëshorti i subjektit) është përfshirë vlera e tij, duke ngarkuar këtë vit me shpenzim në masën 247.406 lekë. Gjatë procesit hetimor në Komision, subjektit i është kërkuar informacion në lidhje me këtë autoveturë, meqenëse për vijueshmërinë/posedimin e këtij mjeti nuk ka pasur deklaram, as në deklaratat periodike vjetore, as në deklaratën *vetting*. Nëpërmjet pyetësorit të datës 23.04.2020, subjekti ka shpjeguar që ky mjet i është shitur<sup>46</sup> babait të saj në vitin 2008, në vlerën 200.000 lekë dhe më pas mjeti ka dalë jashtë përdorimit për shkak të një aksidenti. Rezulton që vlera e shitjes prej 200.000 lekësh është bërë pjesë e analizës financiare të vitit 2008. Në këto kushte, meqenëse nga ana e Komisionit vlera nga shitja e këtij automjeti është përdorur si burim të ardhurash në vitin 2008 ai logjikisht duhet të përfshihej si shpenzim në vitin 2006, në të cilin është analizuar edhe mundësia e bashkëshortit për të krijuar të ardhura të ligjshme para martese. Për pasojë, Kolegji e gjen të drejtë përfshirjen si shpenzim për blerjen e automjetit tip “Ford” nga bashkëshorti i saj në vitin 2006, duke konstatuar se efekti i mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie është i njëjtë, nëse ai do të konsiderohej pjesë e investimeve para martese apo pjesë e investimeve të bashkëshortit pas martese.

**23.12.** Në përfundim, mbështetur në analizën dhe arsyetimin e mësipërm, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mospërfshirje në analizën financiare të vitit 2006 të likuiditeteve në vlerën 398.321 lekë, si shumë e disponuar në llogari bankare të bashkëshortit, shifër e cila pretendohet se do të ndryshonte rezultatin financiar të analizës së vitit 2006 në një rezultat pozitiv prej (+) 71.456 lekësh, nuk qëndron. Kolegji çmon se shuma prej 398.321 lekësh e disponuar nga bashkëshorti i subjektit në datën 23.12.2005 nuk është krijuar me burime të ligjshme, pasi të gjithë burimet, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë ligjshmërinë e të ardhurës,

<sup>46</sup> Kontratë shitblerje automjeti nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 04.06.2008, ndërmjet E. P. në cilësinë e shitësit dhe A. Q. në cilësinë e blerësit (shuma 200.000 lekë).



sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, për periudhën para martese, janë përdorur për justifikimin e pagesës së kësteve të apartamentit dhe jo për krijimin e pasurive të tjera të bashkëshortit të subjektit. Në këto kushte, Kolegji e gjen të drejtë analizën e kryer nga Komisioni për vitin 2006, lidhur me këtë shumë.

**23.13.** *Për vitin 2006, subjekti kundërshton si jo të saktë dhe të plotë analizën e kryer nga Komisioni në drejtim të të ardhurave, duke identifikuar të ardhura e siguruarra prej bashkëshortit në vitin 2006, të cilat sipas saj nuk janë përfshirë në analizën ekonomike të kryer nga Komisioni për këtë vit, duke sjelle një rezultat negativ të kësaj analize. Kolegji mori në analizë pretendimet e subjektit për çdo të ardhur, sipas saj të munguar në analizën e kryer nga Komisioni për vitin 2006, për të cilat konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

**23.13.1.** *Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga përkthimi për GTZ (“German Agency for Technical Cooperation”)<sup>47</sup> në vlerën 600 euro, Kolegji konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.*

**i.** Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo vlerë duhet të përfshihet si e ardhur në analizë, pasi është deklaruar si e tillë nga bashkëshorti në DVP-në e vitit 2006, e cila ka qenë edhe deklarimi i tij i parë si person i lidhur i subjektit deklarues, duke pretenduar se paraqitja e dokumentacionit justifikues në ILDKPKI nuk ka qenë e detyrueshme. Për këtë të ardhur, Kolegji konstaton se subjekti nuk disponon dokumentacion që të vërtetojë përfitimin e kësaj të ardhure, si dhe as pagesën e tatimit në burim, por mbështet pretendimin e saj në përgjigjet e shkresave nga administrata tatimore, të cilat konfirmojnë që janë në pamundësi të vërtetojnë pagesën e tatimit, për shkak të mospasjes së të dhënave të plota, si dhe në faktin që GTZ nuk i është përgjigjur kërkesave të subjektit për dërgim informacioni në lidhje me këtë shërbim të ofruar.

**ii.** Kolegji konstatoi se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion, që provon kryerjen e shërbimit si përkthyes dhe përfitimin e të ardhurës në vlerën prej 600 eurosh, në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ka konfirmim të shlyerjes së detyrimeve tatimore, në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të të njëjtit ligj, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme dhe, për këtë arsye, nuk mund të bëhen pjesë e analizës financiare si të tilla

**23.13.2.** *Lidhur me të ardhura rreth 2.250 euro nga përkthimi që bashkëshorti i subjekti ka kryer për Ministrinë e Brendshme Austriake<sup>48</sup>, në vitet 2009-2010<sup>49</sup>, Kolegji konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.*

---

<sup>47</sup> Subjekti, në apendaksin nr. 2 në lidhje me këto të ardhura, shpjegon: Viti 2006: vlera e deklaruar 600 euro. Nuk kam ruajtur dokumentacion, por duhet të verifikohet në qoftë se është paraqitur në ILDKPKI. Shënim i Komisionit: Pas verifikimit nuk është paraqitur dokumentacion as në ILDKPKI në vitin 2006.

<sup>48</sup> Byroja Federale për Hetimet Kriminale në Austri, Sektori i Menaxhimit të Projekteve (Programi trevjeçar – Emigracioni Ilegal 2006-2009 dhe Projekti ILECU.

<sup>49</sup> Subjekti, në Aneksin nr. 2, bashkëlidhur shpjegimeve të saj për rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me këto të ardhura, shpjegon se:

*I kemi kërkuar informacion Ambasadës Austriake, e cila ka dhënë numër kontakti të Atasheut që merret me çështjet e policisë. I është dërguar e-mail edhe përfaqësuesit të Ambasadës që merret me Ministrinë e Brendshme Austriake, e cila ende nuk ka thyer përgjigje. Dokumentacioni është përkthyer dhe në të nuk përcaktohet çështja e tatimeve. Paguesi i shumës ka pasur rezidencë në Shqipëri dhe ka detyrimin e mbajtjes së tatimit në burim, sipas neneve 13 e 33 të ligjit nr. 8438/1998. Dokumentacioni nuk është ruajtur nga bashkëshorti për shkak se ka kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008. Nga dokumentacioni i përkthyer konfirmohen pagesat: në vitin 2006 në vlerën 2.250 euro, në vitin 2007 në vlerën 2.400 euro dhe në honorare përkthimi në vlerën 800 euro, me faturën e datës 19.12.2008 konfirmohet shërbimi me vlerën 800 euro, me faturën e datës 25.01.2008 konfirmohet shërbimi në vlerën 600 euro, me faturën e datës 08.05.2009 konfirmohet shërbimi në vlerën 520 euro, me faturën e datës 12.09.2008 konfirmohet shërbimi në vlerën 600 euro, me faturën e datës 24.11.2008 konfirmohet shërbimi në vlerën 600 euro, me faturën e datës 15.06.2007 konfirmohet shërbimi për përkthime në vlerën 800 euro. Kërkoj që për këto të ardhura në qoftë se nuk më kthehet përgjigje brenda afatit ligjor nga Ministria e Brendshme Austriake të zbatohet nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi jam në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive. Në këtë vlerësim të kihet në konsideratë neni 32 i ligjit nr. 8438/1998.*

**i.** Për të provuar këtë të ardhur, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision dokumente që vërtetojnë pagesën e këtyre të ardhurave, por për to mungon konfirmimi i shlyerjes së detyrimeve tatimore. Ministria e Brendshme Austriake, në datën 03.07.2020, i është përgjigjur subjektit (nëpërmjet atasheut policor), duke sqaruar se *dokumentacioni i projektit ILECI I është asgjësuar në bazë të afatit të përcaktuar për ruajtjen e dokumenteve (10 vjet) dhe, për këtë arsye, nuk është më i disponueshëm*. Në ankim, subjekti pretendon se paguesi i shumës, sipas neneve 13, 33 e 35 të ligjit nr. 8483/1998, ka pasur detyrimin e mbajtjes së tatimit në burim. Për këto të ardhura, në referim edhe të përgjigjes së marrë me e-mail nga Ministria e Brendshme Austriake, subjekti pretendon se nga Kolegji duhet të aplikohet neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi gjendet në pamundësi objektive për të provuar pagesës e tatimit në burim së bashku me aplikimin e nenin 37 të ligjit nr. 8438/1998, pasi mund të ketë ndodhur që tatimi të jetë mbajtur në burimet e tij në Austri, vend nga i cili është përfituar pagesa.

**ii.** Kolegji, pasi është njohur me këtë pretendim të subjektit për të përfshirë si të ardhur në analizën e vitit 2006 shumën 2.250 euro, konstaton se nga dokumentacioni i disponuar në fashikullin e hetimit administrativ për të ardhurat e pretenduara nga bashkëshorti për vitin 2006, si të përfituara nga përkthimi për “Projektit 3-vjeçar të Emigrimit Ilegal” (ILECI), rezulton që agjencia zbatuese e projektit e financuar nga Ministria e Brendshme Austriake ka qenë “Agjencia Austriake për Zhvillim”. Vetë subjekti në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ ka pranuar se *paguesi i shumës ka pasur rezidencë në Shqipëri*, që do të thotë që paguesi i shumave nuk është direkt Ministria e Brendshme Austriake, por projekte të ndryshme të autorizuara prej saj. Nga verifikimi i dokumentacionit që është paraqitur për të provuar pagesën<sup>50</sup> nuk specifikohet se cila palë ka pasur detyrimin për pagesën e tatimit në burim. Nga aktet nuk rezulton se subjekti pagues, në këtë rast, ka pasur rezidencë në Shqipëri, për pasojë pretendimi i subjektit se ai mund të ketë paguar detyrimin tatimor del edhe jashtë sferës së zbatimit të legjislacionit vendas.

**iii.** Në këto kushte, në konsideratë të mangësive në akteve provuese për përfitimin e pagesës, si edhe në mungesë të konfirmimit të pagesës së detyrimeve tatimore për shumën 2.250 euro të pretenduar si të siguruar nga bashkëshorti prej Ministrisë së Brendshme Austriake, sipas detyrimit që vjen nga neni 52 i ligjit nr. 84/2016, Kolegji çmon se kjo e ardhur nuk mund të konsiderohet si e ligjshme, në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të të njëjtit ligj, dhe nuk mund të bëhet pjesë e analizës si e tillë.

**23.13.3.** Lidhur me të ardhura të bashkëshortit, për përkthime nga Fondacioni “K-Education<sup>51</sup>”, afërsisht në vlerën 1.200 euro (148.000 lekë dhe 22.267 lekë), Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

---

<sup>50</sup> Për të provuar këtë të ardhur, subjekti ka paraqitur në Komision një dokument në gjuhën gjermane dhe të përkthyer në përmbytjen e cilit sipas përkthimit të këtij dokumenti, shprehet se z. E. P. ka siguruar për vitin 2006, shumën 2.250 euro dhe për vitin 2007 shumën 2.400 euro. Ky dokument, si në versionin në gjuhën gjermane edhe në atë të përkthyer, nuk është i nënshkruar nga asnjë palë.

<sup>51</sup> Subjekti i rivlerësimit, në Aneksin nr. 2, të bashkëlidhur me shpjegimeve mbi rezultatet paraprakë të hetimit në lidhje me këto të ardhura, shpjegon se:

Paguesi i shumës K-Edukation, me e-mail-in e datës 24.06.2020, përgjigjet: “Në vijim të procedurave tona e kam dërguar kërkesën tuaj në Zyrat Qendrore në Vienë dhe do të vë në dijeni sapo të kem një përgjigje. Të lutem të marrësh në konsideratë se procedurat e brendshme mund të duan pak kohë dhe me shumë mundësi përgjigja do të vijë pas datës 28.06.2020. Në dijeninë time, OeAD/ish-KKA, në bazë të procedurës respektive, i arshivon faturat vetëm për 10 vjet, pra, mund të ndodhi që kërkesa jote e lidhur me pagesat nga 2006 deri 2007 mund të mosplotësohet. Megjithatë, ne do të bëjmë më të mirën për të siguruar informacionin brenda mundësive tona. Sipas subjektit, paguesi i shumës ka rezidencë në Shqipëri dhe ka detyrimin e mbajtjes së tatimit në burim, sipas neneve 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998. Dokumentacioni nuk është ruajtur nga bashkëshorti për shkak se ka kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008. DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.06.2020, ka pamundësi të vërtetojë pagesat e tatimit në burim, pasi fondacioni nuk është i regjistruar në DRT. Dokumentacioni për vërtetimin e pagesës në burim nuk është ruajtur nga bashkëshorti për shkak se ka kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008. Kërkoj që për këto të ardhura në qoftë se nuk më kthehet përgjigje brenda afatit ligjor nga Kulture Kontakt të zbatohet neni 32, pika 2 i ligjit nr. 84/2016, pasi jam

i. Në drejtim të provueshmërisë së kësaj të ardhure, subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacionin justifikues, pasi sipas saj zyrat qendrore në Vjenë, si dhe Agjencia OEAD, sipas legjislacionit të tyre i arshivojnë faturat vetëm për 10 vjet dhe të dhënat për vitet 2006 dhe 2007 nuk janë më disponibël. Për këtë të ardhur, subjekti nuk ka paraqitur as dokumentacion që provon marrjen e tyre dhe as pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me to. Në ankim për këtë të ardhur, subjekti kërkon të merret në konsideratë përgjigja e DRT-së Tiranë, në të cilën konfirmohet që organet tatimore janë në pamundësi të vërtetojnë pagesën e tatimit, për shkak të mospasjes së të dhënave të plota dhe mungesës së një sistemi unik informatik për këtë periudhë. Gjithashtu, subjekti kërkon që, në këtë rast, të konsiderohet parashikimi i nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008, në të cilin specifikohet afati 5-vjeçar i ruajtjes së dokumentacionit financiar, si dhe aplikimin e nenin 7 të ligjit nr. 7758/1993, i shfuqizuar, me ligjin nr. 9920/2008, në të cilin përcaktohet afati 6-vjeçar i ruajtjes së dokumentacionit financiar.

ii. Kolegji, në analizë të kësaj situatë, që lidhet me shumën 1.200 euro të pretenduar nga subjekti si të përfituar nga angazhimi si përkthyes i bashkëshortit në Fondacioni “K-Education”, për sa kohë për këtë vlerë subjekti, në kuptim të neneve 52 dhe 30 të ligjit nr. 84/2016, nuk ka mundur të provojë përfitimin e saj dhe as pagesën e detyrimeve tatimore, çmon se kjo e ardhur nuk mund të konsiderohet si e ligjshme, në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të të njëjtit ligj, dhe nuk mund të bëhet pjesë e analizës si e tillë.

**23.13.4.** *Lidhur me të ardhura prej 270.000 lekësh të përfituara nga bashkëshorti prej Liceut “{\*\*\*}”*<sup>52</sup>, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

i. Në drejtim të provueshmërisë së kësaj të ardhure, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetim nga shkolla e mesme e përgjithshme jopublike “{\*\*\*}”, në të cilin deklarohet se z. E. P. ka qenë mësues me kohë të pjesshme pranë këtij institucioni, me rrogë mujore 30.000 lekë. Në ankim, subjekti pretendon që shkolla jopublike “{\*\*\*}” ka konfirmuar shërbimin nëpërmjet këtij vërtetimi se meqenëse punëdhënësi është një entitet i regjistruar me NIPT {\*\*\*}, tatimi në burim është një detyrim që duhet të mbahej prej tij (si punëdhënësi). Për këtë arsye, subjekti kërkon nga Kolegji që këto të ardhura të konsiderohen si të ligjshme, duke aplikuar nenet 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998.

ii. Kolegji, në analizë të këtij pretendimi dhe të situatës faktike, konstatoi se në fashikullin e hetimit administrativ është administruar vetëm vërtetimi i sipërcituar i lëshuar nga *Instituti “{\*\*\*}”*, që konfirmon kryerjen e shërbimit, për të cilin nuk ka asnjë konfirmim për shlyerjen e detyrimeve tatimore. Kolegji vëren se mungesa e tatimit në burim shoqërohet dhe me mungesë informacioni për pagesë të sigurimeve shoqërore për punësimin me kohë të pjesshme, fakt i cili konfirmon mungesë të shlyerjes së detyrimeve tatimore, për shkak të sistemeve të lidhura, të cilat rakordojnë/sigurojnë shlyerjen e të dy detyrimeve, shoqërore dhe tatimore Në

---

*në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive. Në këtë vlerësim të kihet në konsideratë neni 688 i Kodit Civil dhe neni 37 i ligjit nr. 8438/1998.*

<sup>52</sup> *Subjekti, në Aneksin nr. 2, bashkëlidhur shpjegimeve të saj për rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me këto të ardhura, shpjegon se:*

*Paguesi i shumës është “{\*\*\*}”, me NIPT {\*\*\*}, i cili ka paguar honorarët në periudhën 1998-2006. Për vitin 2006, “{\*\*\*}” konfirmon marrjen e shërbimit nga bashkëshorti me vërtetimin që është në dosje. Sipas neneve 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998, tatimi në burim mbahet në burim nga paguesi i shumave. Subjekti ka pezulluar aktivitetin nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës time, ndërkohë që DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 29.06.2020, ka pamundësi të vërtetojë pagesat e tatimit në burim, pasi deri në dhjetor të vitit 2014 të dhënat kanë qenë pagesa të kryera jashtë sistemit informatik (manualisht). Kërkoj që për këto të ardhura të zbatohet nenin 32, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, pasi jam në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, pasi ai nuk mund të merret në rrugë tjetër për aq kohë sa DRT-ja Tiranë është në pamundësi të vërtetimit të pagesës, ndërkohë që nuk është ruajtur dokument për kryerjen e pagesës nga bashkëshorti im dhe as subjekti nuk i është përgjigjur kërkesës sime. Ka kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008 dhe nenit 13/5 të ligjit nr. 8438/1998.*

të tilla kushte, Kolegji çmon se subjekti nuk provoi, në zbatim të nenit 52 ligjit nr. 84/2016, përfitimin e kësaj shume, si edhe pagimin e detyrimeve tatimore, sipas kriterëve të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të të njëjtit ligj, për pasojë kjo e ardhur nuk plotëson kriteret për t'u njohur si e ardhur e ligjshme dhe nuk mund të përfshihet në analizë si e tillë.

**23.13.5.** *Lidhur me të ardhura prej 60.000 lekësh të përfituara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK<sup>53</sup>, me NIPT {\*\*\*}, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

**i.** Subjekti pretendon njohjen e saj si të ardhur nga angazhimi i bashkëshortit si përkthyes, duke pretenduar se punëdhënësi është një entitet i regjistruar me NIPT {\*\*\*} dhe tatimi në burim është një detyrim që duhet të mbahet prej tij. Në të tilla kushte, duke iu referuar parashikimeve të neneve 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998, subjekti pretendon se vlera 60.000 lekë duhet të konsiderohen si të ardhura të ligjshme.

**ii.** Kolegji, në kushtet kur prej subjektit, në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, nuk është paraqitur asnjë dokument që provon kryerjen e shërbimit të përkthimit nga bashkëshorti, të përfitimit të pagesës për të dhe, gjithashtu, mungon konfirmimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore, vlerëson se kjo e ardhur nuk plotëson kriteret e nenit 3, pika 19 dhe nenit dhe 30 të ligjit për t'u njohur si e ardhur e ligjshme, për pasojë e çmon të drejtë qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen e saj në analizën financiare si të tillë.

**23.13.6.** *Lidhur me të ardhurat prej 760 eurosh (ekuivalente me 94.014 lekë) të përfituara nga përkthimet për shoqërinë “{\*\*\*}”, degë e shoqërisë së huaj me NIPT {\*\*\*}<sup>54</sup>, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

**i.** Subjekti i rivlerësimit pohon se për këtë të ardhur nuk ka ruajtur dokumentacion, pasi ka kaluar afati 5-vjeçar, si edhe për të ardhurat e tjera pretendon që, meqenëse sipas parashikimit të nenin 48<sup>55</sup> të ligjit nr. 9920/2008 ka kaluar afati për ruajtjen e dokumentacionit provues, kjo shumë duhet përfshirë si e ardhur në analizën financiare mbështetur në deklarinimin e saj.

**ii.** Kolegji, pasi u njoh me situatën faktike në drejtim të këtij pretendimi, për të cilin konstatohet se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument për vërtetimin e kryerjes së shërbimit të shumës së përfituar dhe të pagesës së detyrimeve tatimore lidhur me to, në zbatim të parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, konsideron të drejtë qëndrimin e Komisionit për

---

<sup>53</sup> Subjekti i rivlerësimit, në Aneksin nr. 2, bashkëlidhur shpjegimeve te saj për rezultatet e hetimit administrativ për këto të ardhura, shpjegon se:

Paguesi i shumës është “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}. Sipas neneve 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998, tatimi në burim mbahet në burim nga pagesi i shumave. DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.06.2020, ka pamundësi të vërtetojë pagesat e tatimit në burim, pasi deri në dhjetor të vitit 2014 të dhënat kanë qenë pagesa të kryera jashtë sistemit informatik (manualisht). Kërkoj që për këto të ardhura të zbatohet nenin 32, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, pasi jam në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, pasi ai nuk mund të merret në rrugë tjetër për aq kohë sa DRT-ja Tiranë është në pamundësi të vërtetimit të pagesës, ndërkohë që nuk është ruajtur dokument për kryerjen e pagesës nga bashkëshorti im, pasi kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008 dhe nenit 13/5 të ligjit nr. 8438/1998.

<sup>54</sup> Shënime të subjektit në Apendiksin nr. 2, ku shpjegon në lidhje me këto të ardhura.

Nuk kam ruajtur dokumentacion, pasi ka kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes së dokumentacionit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008. Shoqëria që ka kryer pagesën është shoqëria gjermane “{\*\*\*}”, me degë të shoqërisë së huaj në Shqipëri “{\*\*\*}”, me NIPT {\*\*\*}, regjistruar pas vitit 2006. Nuk kam kontakte për shoqërinë. I kam kërkuar informacion DRT-së Tiranë për të konfirmuar pagimin e tatimit në burim. DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 29.06.2020, më informon se shoqëria është e regjistruar në DRT-në Pogradec. Nuk kam ruajtur dokumentacion. Nuk jam e sigurt nëse është dorëzuar në ILDKPKI. Ka kaluar afati 5- vjeçar i ruajtjes së dokumentacionit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008. Në qoftë se do të ishte kërkuar brenda afatit të ruajtjes, do të kisha premisa më të mëdha për ta gjetur dokumentin dhe mbajtjen e tatimit në burim.

<sup>55</sup> Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Mbi Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 48 “Mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve të të dhënave tatimore”[...] 2. Të dhënat dhe informacioni financiar e kontabël ruhen nga tatimpaguesi, për të paktën 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit tatimor, të cilit i përkasin dokumentet.

mosnjohjen e kësaj të ardhure si të ligjshme, në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit dhe për mospërfshirjen e tyre në analizën financiare si të tillë.

**23.13.7.** Lidhur me të ardhurat të përfituara nga bashkëshorti i subjektit prej dhënies së mësimëve private të gjuhës gjermane<sup>56</sup> dhe përkthime noteriale për vitin 2006 (shumë e përafërt) 480.000 lekë dhe për vitin 2007 (shumë e përafërt) 300.000 lekë, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

**i.** Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që për këto të ardhura të zbatohet nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi ajo është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, pasi ai nuk mund të merret në rrugë tjetër, për aq kohë sa DRT-ja Tiranë shprehet se është në pamundësi të vërtetimit të pagesës. Gjithashtu, subjekti shpjegon se nga bashkëshorti nuk është ruajtur dokument për kryerjen e pagesës, pasi ka kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008 dhe nenit 13/5 të ligjit nr. 8438/1998.

**ii.** Kolegji, pasi u njoh me situatën faktike në drejtim të këtij pretendimi, konstatoi se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument për vërtetimin e kryerjes së kurseve private apo të përkthimeve pranë noterëve, si dhe as të shumës së përfiturar dhe të pagesës së detyrimeve tatimore lidhur me to, në zbatim të parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për pasojë e konsideron të drejtë qëndrimin e Komisionit për mosnjohjen e kësaj të ardhure si të ligjshme, në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit dhe mospërfshirjen e saj në analizën financiare si të tillë.

**23.13.8.** Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shërbimet e guidës kryer për llogari të Agjencia Turistike “{\*\*\*}” ShPK<sup>57</sup>, prej 1.200 eurosh, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

**i.** Subjekti në ankim pretendon se agjencia “{\*\*\*}” ShPK është subjekt tatimor i regjistruar me NIPT {\*\*\*} dhe ajo nuk i është përgjigjur e-mail-eve të subjektit për konfirmimin e pagesës dhe mbajtjen e tatimit në burim, që sipas ligjit ka qenë detyrim për t’u realizuar nga ky subjekt tatimor, me rastin e shërbimit të përkthimit ofruar prej bashkëshortit të saj. Subjekti edhe për këtë të ardhur shpjegon se bashkëshorti nuk ka ruajtur dokumentacion provues të ofrimit të shërbimit, pasi kanë kaluar afatet e përcaktuara ligjore. Shërbimet e ofruara nga bashkëshorti, sipas subjektit, mund të verifikohen nga shoqërimi i turistëve në kufi në datat 14.04.2006 dhe 28.09.2006. Edhe në këtë rast, subjekti sjell në vëmendje se DRT-ja Tiranë ka konfirmuar që është në pamundësi për të konfirmuar mbajtjen e tatimit në burim. Në referim të kësaj situatë

<sup>56</sup> Subjekti i rivlerësimit në Apendiksin nr. 2, të bashkëlidhur shpjegimeve të saj për rezultatet paraprake të hetimit mbi të ardhurat e përfituara nga mësimet private të gjuhës gjermane dhe përkthime noteriale, shpreh se: DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.02.2020, konfirmon se janë në pamundësi të vërtetojnë pagesën e tatimit për shkak të mospasjes së të dhënave të plota dhe mungesës së një sistemi unik informativ për këtë periudhë. Dokumentacioni nuk është ruajtur nga bashkëshorti për shkak se ka kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008. Deklaratat noteriale të shtetasve A. Xh. dhe J. N. e konfirmojnë kryerjen e shërbimit për mësim në gjuhën gjermane dhe vlerën e shërbimit. Kërkoj që për këto të ardhura të zbatohet nenin 32, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, pasi jam në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, pasi ai nuk mund të merret në rrugë tjetër për aq kohë sa DRT-ja Tiranë është në pamundësi të vërtetimit të pagesës, ndërkohë që nuk është ruajtur dokument për kryerjen e pagesës nga bashkëshorti im, pasi kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008 dhe nenit 13/5 të ligjit nr. 8438/1998

<sup>57</sup> Subjekti i rivlerësimit në Aneksin nr. 2, bashkëlidhur shpjegimeve të saj për rezultatet e hetimit administrativ për këto të ardhura, shpjegon se:

Shërbimet janë kryer për subjektin “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, me administratore znj. S. D.. Ky subjekt nuk i është përgjigjur kërkesës time me e-mail për të konfirmuar pagesën dhe mbajtjen e tatimit në burim. Bashkëshorti nuk ka ruajtur dokument që vërteton marrjen e pagesës apo pagimin e tatimit për të ardhurat nga ky shërbim për shkak se ka kaluar afati 5-vjeçar i përcaktuar në nenin 48 të ligjit nr. 9920/2008. Shërbimet mund të verifikohen edhe nga shoqërimi i turistëve në kufi me autobus nga TIMS. Paguesi i shumës është i regjistruar si tatimpagues në Shqipëri dhe ka detyrimin e mbajtjes së tatimit në burim sipas neneve 13 e 33 të ligjit nr. 8438/1998

faktike edhe për këtë të ardhur subjekti kërkon nga Kolegji aplikimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi gjendet në pamundësi objektive për të disponuar dokumentacion që justifikon ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave.

ii. Kolegji, për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit si përkthyes në guida turistike, nisur nga vetë situata faktike e prezantuar nga subjekti, e cila për këto të ardhura nuk ka mundur të paraqesë asnjë dokument për vërtetimin e kryerjes së shërbimit, të pagesës së përfituar dhe të shlyerjes së detyrimeve tatimore, në zbatim të parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, konsideron të drejtë qëndrimin e Komisionit për mosnjohjen e kësaj të ardhure si të ligjshme, në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit dhe mospërfshirjen e saj në analizën financiare si të tillë.

23.14. Në konkluzion të analizimit të pretendimeve të subjektit për të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti gjatë vitit 2006, të cilat, sipas saj, me të padrejtë nuk janë konsideruar si të ardhura në analizën e kryer nga Komisioni, mbështetur në qëndrimet e mësipërme të mbajtura për secilën nga këto të ardhura të pretenduara, Kolegji, ashtu si edhe Komisioni, çmon të drejtë qëndrimin se në analizën financiare të vitit 2006 nuk mund të shtohen të ardhura të tjera, pasi subjekti për to ka dështuar (sipas rastit) të paraqesë dokumentacion që vërteton shërbimin e kryer apo përfitimin e pagesës, si dhe dokumentacion nga organet tatimore, që të konfirmojnë shlyerjen e detyrimeve tatimore. Në këto kushte, rezultati i analizës financiare i kryer nga Komisioni, me situatë financiare negative në masën (-) 574.271 lekë, për vitin 2006, mbetet i njëjtë edhe nga vlerësimi që u bë në Kolegji, për secilën të ardhur të pretenduar se nuk është përfshirë padrejtësisht në analizën financiare.

24. *Kolegji, gjithashtu, mori në analizë edhe pretendimet e subjektit lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2007. Në këtë vit, sipas Komisionit, subjekti rezultoi me situatë financiare negative në shumën (-) 1.398.786 lekë, e cila pamundëson kryerjen me burime të ligjshme të pagesës së kësaj të pestë prej 12.000 eurosh për apartamentin dhe garazhin.*

24.1. Në ankim, për analizën e vitit 2007, subjekti, përveç pretendimeve që kanë lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti prej shërbimit të përkthimit për institucione dhe agjenci të ndryshme (të cilat do të trajtohen në mënyrë analitike në vijim), pretendon se analiza financiare e Komisionit ka pasaktësi në drejtim të llogaritjes së shpenzimeve, të cilat kanë të bëjnë me udhëtimin jashtë vendit, konkretisht me: (i) shpenzime të përlogaritura për udhëtimin e punës së bashkëshortit, për projektin/misionin “PAMECA”, në vlerë 450 euro; si dhe (ii) shpenzime udhëtimi të subjektit dhe të bashkëshortit, për shkak të vizitës të vëllait të subjektit, E. Q., me rastin e krishtlindjeve në vlerën 745 euro. Për këto udhëtime, subjekti pretendon që në shpenzimet e udhëtimit të vitit 2007 duhet të përfshihen vetëm shpenzimet e udhëtimit për vizitën të vëllait në shumën e korriguar prej 450 eurosh (duke konsideruar si shpenzim ditor vetëm vlerën prej 5 euro në ditë dhe biletat e avionit). Për këtë qëllim, subjekti ka paraqitur si provë në Komision deklaratën notoriale të datës 24.08.2020, të lëshuar nga vëllai i saj, në të cilën pohohet vizita e bashkëshortëve me rastin e krishtlindjeve. Ndërsa lidhur me shpenzimet që i referohen udhëtimit të punës nga bashkëshorti për projektin/misionin “PAMECA”, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision kontratën e datës 18.05.2007, nëpërmjet të cilës pretendon të provojë se shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga organizatorët e aktivitetit. Subjekti ngre pretendimin se, meqenëse kontrata e bashkëshortit e datës 18.05.2007 nuk konfirmon mbulimin e këtyre shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimin, Komisioni duhet të shpjegonte në vendim pse nuk ka konsideruar nenet 850, 783 dhe 708 të Kodit Civil, pasi mungesa e pohimit në kontratën e firmosur me projektin/misionin “PAMECA” nuk do të thotë që këto shpenzime nuk janë mbuluar prej tyre.

24.2. Kolegji, në lidhje me pretendimin e subjektit për shpenzimet e udhëtimit në vitin 2007, të përfshira në analizën e Komisionit, pas verifikimit dhe përlogaritjes së kryer lidhur me to,

sipas metodologjisë së aplikuar nga Kolegji<sup>58</sup>, konfirmoi se shpenzimet për udhëtimin e organizuar nga projekti/misioni “PAMECA” janë të njëjta me vlerën e përlllogaritur nga Komisioni prej 450 eurosh, pasi kontrata e paraqitur nga subjekti si provë nuk specifikon se ato do të mbuloheshin nga organizatorët. Kolegji, pasi u njoh me pretendimet e subjektit, lidhur me kostot e udhëtimit të bashkëshortit për të ofruar shërbime përkthimi për projektin/misionin “PAMECA”, në Gjermani, nisur nga përcaktimet e kontratës, të cilën subjekti e ka paraqitur si provë për të provuar përfitimin e kësaj të ardhure, konstatohet se në nenin 3 të saj përcaktohet se *nuk përfshihet asnjë kompensim*. Ky përcaktim kontraktual, që është një marrëveshje e dakordësuar midis palëve për të rregulluar këtë marrëdhënie të angazhimit për përkthim, Kolegji çmon se nxjerr jashtë thirrjes për aplikim të parashikimeve të neneve 850, 783 dhe 708 të Kodit Civil.

Në këto kushte, Kolegji pranoi si të drejtë pjesërisht pretendimin e subjektit për kostot e udhëtimit në vitin 2007, duke pranuar se këto shpenzime kanë qenë në vlerën 880 euro, ekuivalent me 106.401 lekë, shifër e cila do të korrektojë analizën financiare të vitit 2007 me shumën (+) 38.087 lekë.

**24.3.** Kolegji, në drejtim të shkaqeve të ankimit të subjektit që lidhen me të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit (pas martese), mori në shqyrtim edhe pretendimet ,sipas të cilave në analizën financiare të bërë nga Komisioni për vitin 2007 (analizë që afekton edhe kontrollin e pasurisë apartament dhe garazh), në mënyrë të padrejtë nuk janë përfshirë disa të ardhura (pjesa korresponduese e këtij viti) edhe në këtë rast, të siguruar nga veprimtaria si përkthyes e bashkëshortit, të cilat kanë të bëjnë me angazhime në projekte apo organizata/ente të njëjta me ato të listuara më sipër, në funksion të analizës së vitit 2006. Kolegji ia nënshtroi analizës këto pretendime në mënyrë të dedikuar çdo të ardhure të pretenduar se nuk është përfshirë padrejtësisht si vijon.

**24.3.1.** *Lidhur me të ardhurat të realizuara nga përkthimi për “Ministrinë e Brendshme Austriake”<sup>59</sup>, që sipas subjektit në vitin 2007 bashkëshorti ka siguruar vlerën 3.200 euro, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

**i.** Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e hetimit administrativ nga Komisioni, për këto të ardhura të pretenduara nga bashkëshorti për vitin 2007, si të përfituara nga përkthimi për “Projektin 3-vjeçar të Emigrimit Ilegal”, konstatohet që agjencia zbatuese e projektit e financuar nga Ministria e Brendshme Austriake ka qenë “Agjencia Austriake për Zhvillim”. Vetë subjekti, në përgjigjet e dhëna në Aneksin nr. 2<sup>60</sup>, ka shpjeguar se *paguesi i shumës ka pasur rezidencë në Shqipëri*, që do të thotë që paguesi i shumave nuk është direkt Ministria e Brendshme Austriake, por projekte të ndryshme të autorizuara prej saj. Nga verifikimi i dokumentacionit që vërteton pagesën nuk specifikohet se cila palë ka pasur detyrimin për pagesën e tatimit në burim.

**ii.** Kolegji, pasi është njohur me këtë pretendim të subjektit, për të përfshirë si të ardhur në analizën e vitit 2007 shumën 3.200 euro, edhe për vitin 2007, ashtu siç ka argumentuar në analizën e vitit 2006, konstaton se nga dokumentacioni i disponuar në fashikullin e hetimit administrativ, për të ardhurat e pretenduara nga bashkëshorti për vitin 2007, si të përfituara nga përkthimi për “Projektin 3-vjeçar të Emigrimit Ilegal” (*ILECI*), rezulton që agjencia zbatuese

<sup>58</sup> Të dhënë në vendimin e Kolegjit nr. (JR) 19/2019.

<sup>59</sup> *Byroja Federale për Hetimet Kriminale në Austri, Sektori i Menaxhimit të Projekteve (Programi trevjeçar – Emigracioni Ilegal 2006-2009 dhe Projekti ILECU në vitet 2009-2010).*

<sup>60</sup> *Aneksi nr.2, është dokumenti i krijuar gjatë hetimit administrativ të çështjes objekt shqyrtimi, në të cilin Komisioni ka vendosur të gjitha të ardhurat që subjekti ka identifikuar në deklaratat periodike dhe atë vetting, si të përfituara nga veprimtaria si përkthyes e bashkëshortit, për të cilat në këtë akt subjekti përgjatë hetimit administrativ ka përfshirë informacion sipas specifikave, lidhur me marrëdhëniet që kanë gjeneruar këto të ardhura, mënyrën e pagesës dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore.*

e projektit e financiar nga Ministria e Brendshme Austriake ka qenë “Agjencia Austriake për Zhvillim”. Vetë subjekti, në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, ka pranuar se *paguesi i shumës ka pasur rezidencë në Shqipëri*, që do të thotë që paguesi i shumave nuk është direkt Ministria e Brendshme Austriake, por projekte të ndryshme të autorizuara prej saj. Nga verifikimi i dokumentacionit që është paraqitur për të provuar pagesën<sup>61</sup> nuk specifikohet se cila palë ka pasur detyrimin për pagesën e tatimit në burim. Nga aktet nuk rezulton se subjekti pagues në këtë rast ka pasur rezidencë në Shqipëri, për pasojë pretendimi i subjektit se ai mund të ketë paguar detyrimin tatimor del edhe jashtë sferës së zbatimit të legjislacionit vendas.

**iii.** Në këto kushte, në konsideratë të mangësive në akteve provuese për përfitimin e pagesës, si edhe në mungesë të konfirmimit të pagesës së detyrimeve tatimore për shumën 3.200 euro të pretenduar si të siguruar nga bashkëshorti prej Ministrisë së Brendshme Austriake, sipas detyrimit që vjen nga neni 52 i ligjit nr. 84/2016, Kolegji çmos se kjo e ardhur nuk mund të konsiderohet si e ligjshme në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të të njëjtit ligj dhe nuk mund të bëhet pjesë e analizës si e tillë.

**24.3.2.** *Lidhur me të ardhurat afërsisht në vlerën 414 euro (50.057 lekë) të përfituara nga përkthimi për Fondacionin “Kulture Kontakt K-Education”, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

**i.** Sipas subjektit pretendohet që është paraqitur dokumentacion që vërteton se janë bërë dy pagesa në shumën 270 euro dhe 144 euro në datën 12.12.2007. Nga analizimi i korrespondencës së sjellë nga subjekti, për të provuar angazhimin si përkthyes në këtë projekt të bashkëshortit, si dhe shumën e siguruar për dhënien e këtij shërbimi, Kolegji konstaton se “{\*\*\*}” ka qenë një projekt rajonal me zyrë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Në këto akte, për projektin në Shqipëri referohet edhe adresa e këtij projekti (*rruga “{\*\*\*}”, Tiranë dhe rruga “{\*\*\*}”, Tiranë*).

**ii.** Në vërtetimin për pagesë honorari që bashkëshorti i subjektit i ka faturuar projektit “Kulture Kontakt Austria”, për aktivitetin nga data 06 deri më 08.12.2007, në Korçë, në vlerën 270 euro, deklarohet se *taksimi brenda vendit për këtë shumë është përgjegjësi personale*. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.07.2020, të lëshuar nga DRT-ja Tiranë, deklarohet se shoqëria “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}” nuk rezultojnë të jenë të regjistruara pranë kësaj drejtorie rajonale.

**iii.** Në këto kushte, për shkak të mungesës së dokumentacionit justifikues mbi shlyerjen e detyrimeve tatimore përgjegjësi e vetë bashkëshortit të subjektit, për shkak të barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji e konsideron të drejtë moskonsiderimin e këtyre shumave si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit dhe mospërfshirjen e tyre në analizën financiare si të tilla.

**24.3.3.** *Lidhur me të ardhurat në vlerën prej 300.000 lekësh (shumë e përafërt) të pretenduar si të përfituara nga bashkëshorti i subjektit nga mësimet private të gjuhës gjermane dhe përkthime noteriale, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

**i.** Për këtë shumë provueshmëria e angazhimit të bashkëshortit të subjektit dhe e përfitimit të shumës, si dhe ajo e pagimit të detyrimeve tatimore mbetet e paprovuar e njëjtë me situatën faktike të pretenduar/shpjeguar nga subjekti edhe për vitin 2006 e të analizuar më sipër.

**ii.** Në këto kushte, Kolegji mban të njëjtin qëndrim për konsiderimin e tyre si ai i mbajtur në paragrafin nr. 23.13.7, për të ardhurat e këtij lloji për analizën e vitit 2006.

---

<sup>61</sup> Për të provuar këtë të ardhur, subjekti ka paraqitur në Komision një dokument në gjuhën gjermane dhe të përkthyer në përmbajtjen e cilit sipas përkthimit të këtij dokumenti, shprehet se z. E. P. ka siguruar për vitin 2006, shumën 2.250 euro dhe për vitin 2007 shumën 2.400 euro. Ky dokument si në versionin në gjuhën gjermanë edhe në atë të përkthyer nuk është i nënshkruar nga asnjë palë.



**24.3.4.** Lidhur me të ardhurat në shumën 1.150 euro të përfituara nga bashkëshorti i subjektit për shërbime guide të ofruara për Agjencinë Turistike “{\*\*\*}”<sup>62</sup>, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

**i.** Në lidhje me këto shërbime, subjekti ka paraqitur dy kopje mandatpagesash të lëshuara nga Agjencia “{\*\*\*}” të datës 06.06.2007 (në vlerën 300 euro) dhe datës 13.12.2007 (në vlerën 550 euro), në një vlerë totale prej 850 eurosh dhe nuk ka paraqitur asnjë dokument provues për pagesën e detyrimeve tatimore.

**ii.** Për sa më sipër, meqenëse subjekti i rivlerësimit, në kushtet e pasjes së barrës së provës sipas nenit 52, nuk ka paraqitur asnjë dokument për shlyerjen e detyrimeve tatimore, të ardhurat e pretenduara nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit, për pasojë ato nuk do të përfshihen në analizën financiare si të tilla.

**24.3.5.** Lidhur me të ardhurat prej 80 eurosh (9.683 lekë) të përfituara prej bashkëshortit nga përkthimet për “DAAD”<sup>63</sup>, Kolegji konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

**i.** Subjekti i rivlerësimit për këtë shumë ka dorëzuar së bashku me deklaratën *vetting* faturën e datës 17.12.2007 lëshuar nga përfaqësuesi i DAAD-së, z. J. R., nëpërmjet së cilës pretendon të justifikojë kryerjen e shërbimit, pa provuar nëse për këtë vlerë janë paguar detyrimet tatimore.

**ii.** Në kushtet sipas kërkesave të nentit 52, subjekti i ngarkuar me barrën e provës nuk ka paraqitur asnjë dokument për shlyerjen e detyrimeve tatimore, siç kërkon neni 30 i ligjit nr. 84/2016, Kolegji e konsideron të drejtë mospërfshirjen e kësaj shume si të ardhur për vitin 2007.

**24.3.6.** Lidhur me të ardhurat në shumën 220 euro (26.600 lekë), të përfituara prej bashkëshortit nga përkthimi për shoqërinë “{\*\*\*}”<sup>64</sup>, Kolegji konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

**i.** Subjekti pretendon se kjo vlerë është shumatore e dy pagesave, për të cilat si provë gjatë hetimit administrativ ka paraqitur “kontratën honorare” të datës 22.10.2007, të lidhur nga bashkëshorti i saj dhe “{\*\*\*}”, në të cilën është përcaktuar shpërblimi me honorar në vlerën 150 euro *bruto*, si dhe mandatpagesën e datës 26.09.2007, në shumën 70 euro, pa e specifikuar atë në *bruto* apo *neto*.

**ii.** Pasi është njohur me aktet provuese të aktit që dëshmon për ekzistencën e angazhimit si përkthyes të bashkëshortit të subjekti dhe të vlerës së përcaktuar për këtë shërbim, Kolegji konstatoi se subjekti për këtë të ardhur nuk ka paraqitur asnjë dokument që provon pagimin e

<sup>62</sup> Shpjegime të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit administrativ në Komision dhe në ankim.

Shërbimet janë kryer për subjektin {\*\*\*}, me NIPT {\*\*\*}, në vitet 2007 e 2008. Paguesi i shumës është i regjistruar në tatime në Shqipëri dhe ka detyrimin e mbajtjes së tatimit në burim, sipas neneve 13 e 33 të ligjit nr. 8438/1998. Ky subjekt nuk i është përgjigjur kërkesës time me e-mail për të konfirmuar pagesën dhe mbajtjen e tatimit në burim. DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.06.2020, nuk ka pamundësi të vërtetojë pagesat e tatimit në burim, pasi deri në dhjetor të vitit 2014 të dhënat kanë qenë pagesa të kryera jashtë sistemit informatik (manualisht). Kërkoj që për këto të ardhura të zbatohet neni 32, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, pasi jam në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, pasi ai nuk mund të merret në rrugë tjetër, për aq kohë sa DRT-ja Tiranë është në pamundësi të vërtetimit të pagesës, ndërkohë që nuk është ruajtur dokument për kryerjen e pagesës nga bashkëshorti im, pasi kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008 dhe nenit 13/5 të ligjit nr. 8438/1998.

<sup>63</sup> Shërbimi Gjerman për Shkëmbim Akademik shih : <https://www.daad.de/en/>.

<sup>64</sup> Detyrimi ligjor për mbajtjen e tatimit në burim e ka subjekti që bën pagesën, sipas neneve 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998. Adresë kontakti me subjektin {\*\*\*} nuk kam ruajtur dhe jam në pamundësi për të paraqitur dokumentacion shtesë. Në qoftë se subjekti vërtetohet se e ka mbajtur në një faturë, nuk ka arsye të dyshohet se nuk ka kryer të njëjtin veprim edhe për faturën tjetër.

detyrimeve tatimore. Nga ana tjetër, mospërmbushja e detyrimeve tatimore nga kërkuesi i shërbimit shoqëria “{\*\*\*}” përforcohet nga shkresa e DRT-së Tiranë nr. {\*\*\*} prot., datë 30.07.2020, tek e cila, ndër të tjera, konfirmohet se “{\*\*\*}” nuk ka qenë e regjistruar pranë DRT-së Tiranë si subjekt tatimor në vitin 2007.

**iii.** Nisur nga kjo situatë faktike, në mungesë të provueshmërisë së pagimit të detyrimeve tatimore dhe faktit që vetë paguesi i shumave nuk ka qenë i regjistruar si subjekt në organet tatimore, Kolegji çmon se subjekti nuk provoi në zbatim të barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 se të ardhurat e krijuara plotësonin kriteret e nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit, për pasojë gjeti të drejtë qëndrimin e Komisionit për moskonsiderimin e tyre në analizën financiare të kryer.

**24.3.7.** Lidhur me të ardhurat prej 36.000 lekësh të përfituar nga përkthimi për personin fizik me emrin tregtar “{\*\*\*}”, me NIPT {\*\*\*}<sup>65</sup>, Kolegji konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

**i.** Për këtë vlerë subjekti pretendon se ajo duhet të përfshihet si e ardhur në analizën financiare të vitit 2007, meqenëse subjekti përfitues i shërbimit ka qenë subjekt tatimor dhe, në këto kushte, përgjegjësia për të mbajtur në burim detyrimet tatimore i takonte kësaj shoqërie.

**ii.** Lidhur me këtë pretendim të subjekti, Kolegji konstaton se në dokumentin e datës 06.12.2007 të dorëzuar (në dosjen e ILDKPIK-së), nga subjekti për të justifikuar të ardhurën, ka një shënim, në të cilin specifikohet se shpërblimi i mësipërm përfshin dhe shumën e tatimit mbi të ardhurat, për të cilin personi në fjalë është vetë përgjegjës.

**iii.** Nisur nga kjo situatë faktike, Kolegji vëren se palët, përkatësisht ofruesi i shërbimit bashkëshorti i subjekti dhe personi fizik “{\*\*\*}” si përfitues e këtij shërbimi, janë dakordësuar që detyrimet tatimore për këtë marrëdhënie të shlyhen nga ofruesi i shërbimit. Në këto kushte, sërish në zbatim të detyrimeve që vijnë nga barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, meqenëse subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me to, këto të ardhura nuk plotësojnë kriterin e të ardhurës së ligjshme, sipas parashikimeve të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit, për pasojë Kolegji e konsideron të drejtë qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen e kësaj shume si të ardhur në analizën financiare.

**24.3.8.** Lidhur me të ardhurat në vlerën 400 euro (48.364 lekë) për shërbime guide të kryera për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, Kolegji konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

**i.** Për këtë vlerë, subjekti ka paraqitur si provë në Komision mandatpagesat, përkatësisht: nr. {\*\*\*}, datë 15.10.2007, në vlerën 300 euro, nr. {\*\*\*}, datë 15.10.2007, në vlerën 100 euro dhe pretendon njohjen e këtyre të ardhurave me të njëjtin arsyetim të përdorur në analizën e mësipërme për të ardhurat e vitit 2006 me të njëjtin burim krijimi.

**ii.** Kolegji, në kushtet e së njëjtës situatë faktike, mban të njëjtin qëndrim, lidhur me moskonsiderimin e këtyre të ardhurave të krijuara nga i njëjti burim dhe në të njëjtat kushte, siç është analizuar edhe për të ardhurat e përfituara në vitin 2006 në paragrafin 23.13.8.

---

<sup>65</sup> Subjekti person fizik “{\*\*\*}” (më parë me emër tregtar A. Y.), me NIPT {\*\*\*}, ka pasur të njëjtin detyrim ligjor për të mbajtur tatimin në burim si në vitin 2007 e 2008, në të cilat nuk konfirmohet nga Komisioni mbajtja e tatimit në burim, ashtu edhe për vitet 2009, 2010, 2011 e 2012, periudhë në të cilën konfirmohet se ka mbajtur tatimin në burim. Subjekti ka shënuar në disa fatura se E. P. është përgjegjës për pagimin e tatimit mbi të ardhurat, por kjo nuk përjashton subjektin tatimor nga detyrimi për mbajtjen e tatimit në burim. Për këtë arsye, subjekti pretendon që shënimin të interpretohet, sipas nenit 688 të Kodit Civil, pasi subjektet e tatimit mbi të ardhurat dhe tatimit në burim nuk mund të kryejnë veprime juridike, në kundërshtim me nenet 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998. DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 29.06.2020, ka pamundësi të vërtetojë pagesat e tatimit në burim, pasi deri në dhjetor të vitit 2014 të dhënat kanë qenë pagesa të kryera jashtë sistemit informatik (manualisht).

**24.3.9.** Lidhur me të ardhurat në vlerën 140.000 lekë të përfituara nga përkthimi për z. E. S.<sup>66</sup> (përkthim i dokumenteve personale), Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

- i. Për këtë shumë, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë lloj dokumenti që provon realizimin e shërbimit (pra, përkthimin e materialeve), shumën e siguruar dhe, për pasojë, nuk ka provuar as pagesën e detyrimeve tatimorë lidhur me to.
- ii. Në këto kushte, Kolegji konsideron se përfitimi i kësaj të shume mbetet vetën në nivel deklarativ dhe, për pasojë, e konsideron të drejtë mospërfshirjen e saj si të ardhure në analizën financiare.

**24.3.10.** Lidhur me të ardhurat në vlerën 1.900 euro (229.729 lekë) të përfituara nga përkthimet për projektin/misionin “PAMECA”<sup>67</sup>, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

- i. Subjekti pretendon se kjo shumë duhet të përfshihet si e ardhur në analizën e vitit 2007, me argumentin e njëjtë të dhënë edhe për analizën e vitit 2006, se projekti/misioni “PAMECA” është subjekt i regjistruar në organet tatimore me NIPT {\*\*\*} dhe si gjithë subjektet e tjera ka pasur detyrim ligjor për të mbajtur tatimin në burim për pagesat e kryera në vitin 2007. Subjekti vijon shpjegimi e saj se projekti/misioni “PAMECA” edhe pse ka shënuar/përcaktuar në kontratë se individ i (ofruesi i shërbimit bashkëshorti i subjektit) është përgjegjës për pagimin e tatimit mbi të ardhurat, sërish duke qenë se nenet 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998 përcaktojnë

---

<sup>66</sup> Subjekti për këtë individ ka shpjeguar se E. S. është i biri i një studiuesi shqiptar të quajtur V. S.. Në adresën [\*\*\*], ju do të gjeni të dhëna mbi botimin e librit që flet për jetën dhe veprën e z. S. ku pasqyrohet, ndër të tjera, fakti se përkthyes i korrespondencës voluminoze në gjuhën gjermane është z. E. P.. Bashkëshorti disponon edhe materialet e përkthyesa, por nuk ka ruajtur dokument që vërteton pagimin e tatimit për të ardhurat nga ky përkthim, për shkak se ka kaluar afati 5-vjeçar i përcaktuar në nenin 48 të ligjit nr. 9920/2008. DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.06.2020, ka pamundësi të vërtetojë pagesat e tatimit në burim, pasi deri në dhjetor të vitit 2014 të dhënat kanë qenë pagesa të kryera jashtë sistemit informatik (manualisht).

<sup>67</sup> Subjekti parashtron se projekti/misioni “PAMECA” është subjekt i regjistruar në organet tatimore me NIPT {\*\*\*} dhe si gjithë subjektet e tjera ka pasur detyrim ligjor për të mbajtur tatimin në burim për pagesat e kryera në vitin 2007. Me përgjigjen e datës 19.06.2020 drejtuesi i PAMECA V më informon se nuk administrohen nga misioni dokumentet e viteve 2007, 2010 e 2014, pasi Misioni PAMECA V ka qenë i ndryshëm nga Misioni PAMECA II, PAMECA III, PAMECA IV. Në këto kushte jam në pamundësi për të vërtetuar nëse Misioni PAMECA ka përmbushur detyrimin ligjor për pagimin e tatimit në burim për shërbimet e përkthimit të ofruara nga bashkëshorti im E. P. në vitet 2007, 2010 e 2014. PAMECA ka shënuar në kontratë se individ është përgjegjës për pagimin e tatimit mbi të ardhurat, por sipas neneve 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998 tatimi në burim duhej të mbahej detyrimisht prej tij. Komisioni duhet të ketë në vëmendje se Kontrata ka qenë kontratë tip e përpiluar në mënyrë të njëanshme nga “PAMECA”, ashtu sikurse evidentohet në formën e saj (ka stemën dhe të dhënat e Misionit PAMECA). Kërkoj që kushti kontraktor i pasqyruar në nenin 2 të kontratave të datës 30.03.2007 dhe datës 18.05.2007 të vlerësohet dhe interpretohet në dobi të bashkëshortit tim (se PAMECA nuk i është shmangur detyrimit ligjor për mbajtjen e tatimit në burim), pasi, sipas nenit 688 të Kodit Civil përcaktohet se: Në çdo rast, kushtet e përfshira në kushtet e përgjithshme të kontratës apo në modularë e formularë, që kanë qenë dhënë prej njëres nga palët kontraktuese, kur ka dyshim, interpretohet në dobi të palës tjetër. Kërkoj, gjithashtu, që Komisioni të vlerësojë se unë jam në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, pasi nga përgjigja e misionit PAMECA e datës 19.06.2020, si organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese për të vërtetuar pagimin e tatimit në burim për shkaqe të arsyeshme nuk ka mundur të mi vërë në dispozicion, ndërkohë që nga e-mail-i i datës 11 maj 2020 PAMECA njofton se: Me lejoni t’ju informoj se fatkeqësisht PAMECA V është në pamundësi t’ju sigurojë dokumentet e kërkuara nga ju, pasi ne nuk i zotërojmë ato. Dokumentet e kërkuara nga ju janë administruar nga PAMECA II (2005-2007) menaxhuar nga Ministria e Brendshme e Gjermanisë Federale, PAMECA III (2008-2012) menaxhuar nga UK (NI-CO si agjencia implementuese) dhe PAMECA IV (2013-2017) menaxhuar nga Ministria e Brendshme Italiane. Megjithatë me lejo të informoj se standardet e EU-së për procedurat e projekteve, siç janë për dokumentet mbahen dhe arsimohen nga institucioni/agjencia implementuese vetëm për një periudhë 5-vjeçare pas përfundimit të projektit (bashkë me përgjigjet gjeni dhe korrespondencën me e-mail me të cilën unë kam kërkuar vërtetimin e pagesës për shërbimin, vërtetimin e pagesës së tatimit në burim dhe në qoftë se nuk është bërë kjo pagesë shpjegimin e bazës ligjore). Kërkoj që për këto të ardhura të zbatohet nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi jam në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, pasi ai nuk mund të merret në rrugë tjetër, ndërkohë që nuk është ruajtur dokument për kryerjen e pagesës nga bashkëshorti im, pasi ka kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008 dhe nenit 13/5 të ligjit nr. 8438/1998.

se tatimi në burim duhej të mbahej detyrimisht prej entit, ai i takon në këtë rast projektit/misioni “PAMECA”.

ii. Në analizë të akteve të paraqitura nga vetë subjekti, për të provuar sigurimin e kësaj shume, Kolegji konstaton se sërish subjekti, e cila, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 ka pasur barrën e provës, ka dështuar të provojë pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me to. Qëndrimin e subjektit që edhe në rastet kur vetë palët kontraktuese projekti/misioni “PAMECA” dhe bashkëshortori i saj me vullnetin e lirë kanë mirëpërcaktuar se cila palë ngarkohet me pagesën e detyrimeve tatimore të mospërfillet, por të konsiderohet se është një përcaktim jo në përputhje me parashikimet e neneve 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998, Kolegji e gjen jo të mbështetur në ligj, për shkak se siç është arsyetuar edhe më lart, ky detyrim konfirmon faktin e pasjes dijeni të bashkëshortit të subjektit për mospagimin e detyrimeve tatimore, duke qenë se kontrata ka përcaktuar vetë atë si mbajtës i këtij detyrimi. Kjo situatë zhvesh subjektin nga mungesa e përgjegjësisë për mospagimin e këtyre detyrimeve dhe prodhon pasojën e moskonsiderimit të këtyre të ardhurave si të ligjshme, në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit. Në këto kushte, Kolegji gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen e kësaj të ardhure në analizën financiare.

24.4. Për sa më sipër, nga analizimi i çdo pretendimi të subjektit për të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti gjatë vitit 2007, Kolegji arrin në përfundimin se në analizën financiare të vitit 2007 nuk mund të konsiderohen të ardhura të tjera shtesë përtej atyre të përfshira nga Komisioni, në kushtet kur subjekti nuk provon përfitimin apo pagimin e detyrimeve tatimore për secilën prej tyre.

24.5. Ndërsa Kolegji e konsideroi pjesërisht të drejtë pretendimin e subjektit për reduktimin e kostove/shpenzimeve të udhëtimit të vitit 2007 dhe, për pasojë, korrektoi analizën financiare të vitit 2007 në shumën (+) 38.087 lekë.

24.6. Kolegji, gjithashtu, mori në analizë për vitin 2007 të ardhurat e kredituara në llogari si pagë e bashkëshortit të subjektit, të cilat në analizën e Komisionit janë përfshirë si e ardhur në vlerën 611.084 lekë<sup>68</sup>. Lidhur me këtë shifër, Kolegji konstatoi se kreditimet si pagë në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, sipas të dhënave të statementeve të “Alpha Bank” rezultojnë të jenë të njëjta me shumën e pretenduar nga subjekti në vlerën 688.225 lekë, prej të cilave pas zbritjes së kreditimit prej 54.000 lekësh nga Prokuroria e Rrethit Durrës, si dhe interesat e llogarisë rrjedhëse, rezultojnë të jenë në shumën 634.225 lekë, pra, 23.141 lekë më shumë nga sa pasqyrohet në analizën financiare të vitit 2007. Për pasojë, Kolegji shtoi si të ardhur në analizën e vitit 2007 shumën (+)23.141 lekë.

24.7. Në përfundim, lidhur me analizën e vitit 2007, rezultati financiar pas korrektimeve të bëra analizës, sipas qëndrimeve të mësipërme, rezulton të jetë sërish negativ dhe subjekti dhe familja e saj nuk mund të justifikojnë me burime të ligjshëm për këtë vit, pasuritë e krijuara dhe të përballojnë shpenzimet e kryera në vlerën prej (-) 1.338.249 lekësh, në të cilën përfshihet edhe mungesa e burimeve për likuidimin e këstit prej 12.000 eurosh, për apartamentin e ndodhur në Tiranë.

25. *Subjekti i rivlerësimit, gjithashtu, ka paraqitur pretendime që kundërshtojnë analizën e Komisionit për vitin 2008, i cili ka konkluduar se në këtë vit subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj janë me situatë negative (-)1.093.561 lekë, për të përballuar kostot e jetesës dhe pasuritë e krijuara. Në ankim, subjekti edhe për këtë vit pretendon se Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare, të ardhura të siguruara nga bashkëshorti, të cilat, sipas saj, përmbushin kushtet për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme. Pretendimet e subjektit për secilën të ardhur, sipas saj, të papërfshirë në analizë do të trajtohen në vijim të këtij arsyetimi.*

<sup>68</sup> Sipas vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë 04.12.2017, të lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

**25.1.1.** Lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti në shumën 3.800 euro (467.780 lekë), nga përkthimi për “Ministrinë e Brendshme Austriake”, Byroja Federale për Hetimet Kriminale, në Austri, Sektori i Menaxhimit të Projekteve (Programi trevjeçar – Emigracioni Ilegal 2006-2009 dhe Projekti ILECU në vitet 2009-2010, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

**i.** Për këto angazhime të bashkëshortit prej subjektit janë dorëzuar në Komision dokumente që vërtetojnë pagesën e këtyre të ardhurave, por për to mungon konfirmimi i shlyerjes së detyrimeve tatimore. Ministria e Brendshme Austriake në datën 03.07.2020 i është përgjigjur subjektit (nëpërmjet atashut policor), duke sqaruar se *dokumentacioni i projektit ILECI 1, është asgjësuar në bazë të afatit të përcaktuar për ruajtjen e dokumenteve (10 vjet) dhe për këtë arsye nuk është më i disponueshëm*. Pas marrjes së kësaj përgjigjeje, subjekti pretendon se paguesi i shumës ka detyrimin e mbajtjes së tatimit në burim, sipas neneve 13,33 e 35 të ligjit nr. 8483/1998 dhe, për pasojë, për këtë të ardhur subjekti kërkon që Kolegji të aplikojë nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke e konsideruar se gjendet në pamundësi objektive për të provuar pagesës e tatimit në burim së bashku me aplikimin e nenin 37 të ligjit nr. 8438/1998, pasi, sipas subjektit, mund të ketë ndodhur që tatimi të jetë mbajtur në burimet e tij në Austri, vend nga i cili është përfitur pagesa.

**ii.** Kolegji, pasi mori në analize të gjithë dokumentacionin e administruar në fashikullin e hetimit administrativ për këtë angazhim si përkthyes të bashkëshorti të subjektit në vitin 2008, si të përfituara nga përkthimi për Projektin 3-vjeçar të Emigrimit Ilegal, konstatoi se situata e akteve të paraqitura për të provuar këtë të ardhur është e njëjtë me atë të përshkruar dhe analizuar në paragrafin 24.3.1 për vitin 2007.

**iii.** Në këto kushte, edhe për vitin 2008, në konsideratë të mangësive në aktet provuese për përfitimin e pagesës, si edhe në mungesë të konfirmimit të pagesës së detyrimeve tatimore, për shumën 3.200 euro të pretenduar si të siguruar nga bashkëshorti prej Ministrisë së Brendshme Austriake, sipas detyrimit që vjen nga neni 52 i ligjit nr. 84/2016, Kolegji çmos se kjo e ardhur nuk mund të konsiderohet si e ligjshme në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të të njëjtit ligj dhe nuk mund të bëhen pjesë e analizës si e tillë.

**25.1.2.** Lidhur me të ardhurat prej 1.480 eurosh dhe 22.800 lekësh (total 205.106 lekë) të përfituara nga bashkëshorti prej përkthimeve për personin fizik “{\*\*\*}”<sup>69</sup>, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

**i.** Komisioni, për të ardhurat me burim nga personi fizik që ofron shërbime përkthimi “{\*\*\*}”, ka pasur një qëndrim vetëm për shumën 121.000 lekë, e cila është evidentuar si derdhje në llogarinë bankare të bashkëshortit, por që nuk është bërë pjesë e analizës financiare të Komisionit, për arsye se mungon konfirmimi për pagesën e detyrimeve tatimore.

**ii.** Lidhur me këtë pretendim të subjektit, ashtu siç ka arsyetuar edhe për vitin 2007, Kolegji konstaton se në aktin “konfirmim pagese” të kryer nga personi fizik “{\*\*\*}”, të firmosura nga bashkëshorti edhe në vitin 2008, është e specifikuar se *shpërblimi i mësipërm përfshin edhe shumën e tatimit mbi të ardhurat për të cilën personi në fjalë është vetë përgjegjës*. Në këto kushte, edhe për këtë vit, subjekti, për të ardhurën e pretenduar si të përfitur nga shërbimet e

<sup>69</sup> Shpjegime të dhëna nga subjekti gjatë procesit hetimor administrativ në Komision (Aneksi nr. 2).

Subjekti person fizik “A. Y.” (me emrin tregtar “{\*\*\*}”), me NIPT {\*\*\*}, ka pasur të njëjtin detyrim ligjor për të mbajtur tatimin në burim si në vitin 2007 e 2008, në të cilat nuk konfirmohet nga Komisioni mbajtja e tatimit në burim, ashtu edhe për vitet 2009, 2010, 2011 e 2012, periudhë në të cilën konfirmohet se ka mbajtur tatimin në burim. Subjekti ka shënuar në disa fatura se E. P. është përgjegjës për pagimin e tatimit mbi të ardhurat, por kjo nuk përjashton subjektin tatimor nga detyrimi për mbajtjen e tatimit në burim. Për këtë arsye, shënimi të interpretohet, sipas nenit 688 të Kodit Civil, pasi subjektet e tatimit mbi të ardhurat dhe tatimit në burim nuk mund të kryejnë veprime juridike në kundërshtim me nenet 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998. DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.06.2020, ka pamundësi të vërtetojë pagesat e tatimit në burim, pasi deri në dhjetor të vitit 2014 të dhënat kanë qenë pagesa të kryera jashtë sistemit informatik (manualisht).

ofruara për personin fizik “{\*\*\*}”, nuk ka mundur të provojë pagesën e detyrimeve tatimore që i takonte atij sipas parashikimit në kontratë.

**iii.** Kolegji, si edhe në situatën që i përket vitit 2007, konkludon se në kundërshtim me detyrimin për barrën e provës, sipas parashikimit të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti nuk provoi pagimin e detyrimeve tatimore për këtë shumë, për pasojë ajo nuk plotëson kriteret e nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit dhe, si e tillë, nuk do të përfshihet në analizën financiare.

**25.1.3.** *Lidhur me të ardhurat nga bursa studimore<sup>70</sup> në Universitetin e Jenës, në Gjermani, në shumë totale prej 975 eurosh të përfituar prej bashkëshortit, prej të cilave, subjekti pretendon si kursim vetëm shumën 391 euro, që vjen si rezultat i pakësimit nga shuma totale e kostove të qëndrimit të personit të lidhur, në Gjermani<sup>71</sup>, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

**i.** Subjekti pretendon se të ardhurat në shumën 391 euro duhet të përfshihen në analizën financiare, pasi, sipas nenit<sup>72</sup> 8/1 të ligjit nr. 8438/1998, të ardhurat nga bursat janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat.

**ii.** Në përgjigje të këtij pretendimi të subjektit, Kolegji sjell në vëmendje qëndrimet e mbajtura në jurisprudencën<sup>73</sup> e tij, lidhur me moskonsiderimin e shumave të përfituara si bursë si burime nga të cilat mund të kursehen të ardhura. Sipas këtij arsytimi, të ardhurat e përfituara prej bursës shërbejnë si një ndihmë për mbulimin e shpenzimeve në vendin ku ato përfitohen, për pasojë nuk mund të pretendohet se ato janë të afta të krijojnë kursime për personat përfitues. Për këtë arsye, Kolegji çmon që shuma 391 euro, e pretenduar si kursim në vitin 2008, nuk duhet të përfshihet si e ardhur në analizën financiare të këtij viti.

**25.1.4.** *Lidhur me të ardhurat nga bursa Studimore nga DAAD<sup>74</sup>, në Gjermani, në periudhën korrik-gusht 2008, në vlerën 3.680 euro, prej të cilave subjekti pretendon se shuma 2.958 euro*

---

<sup>70</sup> Shpjegime të dhëna nga subjekti me përgjigjet e datës 29.06.2020 gjatë hetimit administrativ në Komision në lidhje me bursën e studimit marrë nga Universiteti Jenës në Gjermani.

Subjekti ka paraqitur me pyetësin e datës 29.06.2008 ftesën e përkthyer në shqip. Gjithashtu, ajo shpjegon në këtë pyetësor se në ftesë pasqyrohet se shpenzimet e udhëtimit në vlerën maksimale 500 euro dhe shpenzimet e qëndrimit në vlerën 975 euro, të cilat financohen nga Instituti i Gjermanistikës. Të dhënat e TIMS konfirmojnë udhëtimin e bashkëshortit në këtë periudhë në Gjermani. Nga të dhënat e studimit “Përlllogaritja e kostos së jetesës së studentëve”, marrë nga studimi i kryer nga FIBS - Instituti Kërkimor për Ekonominë Arsimore dhe Sociale Studim, konstatohet se kostot e jetesës së studentëve në Gjermani në vitin 2008 janë 584 euro/muaj. Këto të dhëna janë publikuar në faqen 16 të raportit të publikuar në adresën: [https://www.studentenwerke.de/sites/default/files/dsw\\_fibs\\_online.pdf](https://www.studentenwerke.de/sites/default/files/dsw_fibs_online.pdf).

Në këto kushte diferenca prej 391 euro (975 euro bursa minus 584 euro shpenzimet jetike mujore në Gjermani) nuk janë përfshirë në analizë. Sipas Komisionit në referencë të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, këto të ardhura janë konsideruar jo të ligjshme, sepse subjekti nuk ka paraqitur dokument provues për kryerjen e pagesës së tatimit.

<sup>71</sup> Sipas të dhënave studimore mbi kostot e jetesës së periudhës marrë nga burime të hapura informacioni, prej 975 euro – 584 euro = 391 euro.

<sup>72</sup> Neni 8/1 i ligjit nr. 848/1998, i ndryshuar, përcakton: “Përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale: 2. Bursat e nxënësve dhe të studentëve”.

<sup>73</sup> Në vendimin (JR) 9/2018, Kolegji ka arsyetuar se:

Bursa akordohet si kuotë financiare për ushqim dhe shpenzime të tjera të vogla të studentit, të cilat hyjnë si shpenzime bazë jetese pa përfshirë luksin. Një ndër arsyet, për të cilat edhe studentët punojnë gjatë qenies në universitet, është për shkak të përballimit të shpenzimeve, për të cilat nuk është e mundur të përballohen vetëm me bursën e akorduar nga universiteti. Çmimet e të mirave dhe shërbimeve në shtetin italian kanë qenë të njëjta për të gjithë studentët, pavarësisht kombësisë. Përlllogaritja e bursës bëhet duke u nisur nga disa tregues ekonomikë të vendit tek i cili do të bëhen shpenzimet, papërcaktuar përkatësinë e kombësisë së studentit në raport me këto shpenzime.

<sup>74</sup> DAAD është Shërbimi Gjerman për Shkëmbimin Akademik. Për këtë të ardhur, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimin me përgjigjet e datës 29.06.2020 gjatë hetimit administrativ në Komision në lidhje me bursën e studimit marrë nga DAAD janë si vijon:

Rezulton se DAAD, më datë 20.05.2008 i ka ofruar z. E. P. një bursë për qëndrim studimor dhe kërkimor për një periudhë 2 mujore, në Gjermani, duke i ofruar mbështetje financiare prej 3.680 eurosh (në muaj 1.840 euro), për

*duhet të llogaritet nga Kolegji si e ardhur neto e ligjshme, pasi të ardhurat nga bursa janë të ardhura të përjashtuara nga tatimi, si nga legjislacioni shqiptar, ashtu dhe nga legjislacioni gjerman, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

**i.** Në aktet e fashikullit nuk rezulton të gjendet asnjë dokument i kohës që dëshmon/provon përfitimin e një burse në vitin 2008, pasi nuk ka ndonjë të dhënë bankare apo mandatpagesë në emër të përfituesit të bursës E. P., që dëshmon për marrjen e kësaj shume. Kolegji vlerëson se pretendimi i subjektit për përfitimin e shumës 2.958 euro, sipas shpjegimit të saj provohet nga lëvizjet bankare të subjektit, sipas të cilave rezulton se në kohën e pretenduar se është përfituar bursa ka bërë një derdhje në shumën 320.000 lekë për të paguar para kohe kredinë, nuk provon përfitimin e shumës me burim nga bursa, përveç se shlyerjen e një detyrimi. Në vijim të analizës së këtij shkak, Kolegji, gjithashtu, shpjegimin e subjektit se bashkëshorti është kthyer para kohe në Shqipëri për ta asistuar atë, meqenëse kishte probleme shëndetësore, e konsideron si një të dhënë që vë në dyshim përfitimin e bursës. Për më tepër, sipas dokumentacionit të administruar, rezulton se bursa do të lëvrohej me këste nga momenti i mbërritjes së bashkëshortit në Gjermani dhe fakti që bashkëshorti nuk ka qëndruar atje, për arsyet që vetë subjekti prezanton, është një rrethanë më shumë, krahas mungesës së dokumentacionit, për të besuar se ajo është përfituar realisht. Përveç sa më sipër, edhe në këtë analizë sjellim në vëmendje qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit të arsyetuar edhe më sipër.

**ii.** Për këtë arsye, Kolegji çmon se pretendimi për përfitimin e shumës 2.958 euro në vitin 2008 me burim nga bursa, nuk është i drejtë dhe, për këtë arsye, kjo shumë nuk është përfshirë në analizën financiare të këtij viti.

**25.1.5.** *Lidhur me të ardhurat e përfituara nga përkthime të realizuara nga bashkëshorti i subjektit, për Unionin e Dhomave të Tregtisë, përkthime të kryera në shtator të vitit 2008 në shumën 300 euro, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

**i.** Për këtë angazhim të bashkëshortit, subjekti pretendon se “Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë” është subjekt i regjistruar me ligjin nr. 9640, datë 09.11.2009 dhe si person juridik që nuk ushtron veprimtari fitimprurëse ka detyrimin ligjor të mbajë tatimin në burim, sipas neneve 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998. Subjekti shpjegon se, meqenëse nuk ka arritur të kontaktojë me këtë subjekt, i është drejtuar DRT-së Tiranë, e cila i është përgjigjur që për këtë subjekt duhet të verifikohet numri i Nipt-it. Në këto kushte, subjekti kërkon nga Kolegji, që

---

*banesën ushqimin dhe shpenzimet dytësore. Në dokumentin e bursës se përkthyer ne shqip, sqarohet se kostot e sigurimit shëndetësor të detyrueshëm në shumën mujore prej 111 eurosh do të mbahen nga bursa. Të dhënat e TIMS të përcjella nga Komisioni tregojnë se E. P. ka udhëtuar për në Gjermani më datë 26.07.2008 dhe ai duhet të ketë qëndruar atje për rreth një javë dhe për këtë shkak duhet të jetë pajisur edhe me vizë, pasi në atë kohë ende nuk kishte ndodhur liberalizimi i vizave me vendet e BE-së. Për arsyet e mia shëndetësore që kanë lidhje me problemet gjatë shtatzënisë me vajzën time N. P., ai është detyruar të kthehet në Shqipëri para afatit dhe të vijojë punën kërkimore nga Shqipëria. Të dhënat e studimit “Përlllogaritja e kostos së jetesës së studentëve”, Studim për llogari të Organizatës “Unioni Studentor Gjerman”, i kryer nga FIBS – Instituti Kërkimor për Ekonominë Arsimore dhe Sociale, të përcjella me përgjigjet e pyetësorit nr. 3 të datës 31.01.2020, tregojnë se kostot e jetesës së studentëve në Gjermani në vitin 2008 janë 584 euro në muaj. Këto të dhëna janë publikuar në faqen 16 të raportit të publikuar në WWB në adresën [https://www.studentenwerke.de/sites/default/files/dsw\\_fibs\\_online.pdf](https://www.studentenwerke.de/sites/default/files/dsw_fibs_online.pdf). Në këto kushte, diferenca prej 2.958 eurosh (3.680 euro bursa - 222 euro shpenzimet e sigurimit - 300 euro kosto të përafërta maksimale udhëtimi - 200 euro kosto maksimale qëndrimi për një javë në Gjermani) duhet të llogaritet si e ardhur e ligjshme duke qenë se sipas nenit 8/1 të ligjit nr. 8438/1998 të ardhurat nga bursat janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat. Në llogaritjen e kostove të qëndrimit prej 200 euro kam parasysh edhe faktin se sipas përmbajtjes së bursës së Jenës, që përkon pak a shumë me të njëjtën periudhë, kosto ditore e qëndrimit në Gjermani, në qoftë se ajo nuk është mujore, llogaritet maksimalisht 40 euro në ditë. Sa më sipër, vlera prej 2.958 eurosh duhet të llogaritet nga Komisioni si e ardhur neto e ligjshme. Se këto para janë kursyer e tregojnë edhe të dhënat e llogarisë bankare të znj. Fjoralba Prifti, në BKT, sipas të cilave më datë 25.09.2008 unë kam derdhur në llogari 320.000 lekë me qëllim likuidimin para kohe të një kredie për blerjen e automjetit dhe këto para kanë qenë, pikërisht, paratë që bashkëshorti im ka kursyer nga kjo bursa.*

për këto të ardhura, të zbatohet nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke konsideruar se ajo është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tatimit në burim nga bashkëshorti, dhe se ka kaluar afati mbi pesë vjet i ruajtjes së dokumentacionit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008 dhe nenit 13/5 të ligjit nr. 8438/1998.

**ii.** Për këtë të shumë, ashtu siç edhe është arsyetuar edhe më sipër, Kolegji çmon se subjekti, e cila, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, ka barrën e provës të provojë se këto të ardhura përmbushin kërkesat e nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit, ka dështuar të provojë që për to janë paguar detyrimet tatimore. Në këto kushte, Kolegji e gjen të drejtë mospërfshirjen e kësaj shume si të ardhur në analizën e këtij viti.

**25.1.6.** *Lidhur me të ardhura të përfituara nga pagesa për përktime nga bashkëshorti i subjektit nga institucione të ndryshme, të derdhura në llogarinë e personit të lidhur pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën 18.304 lekë, të përbëra nga tre pagesa, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

**i.** Pagesë, në shumën 1.601 lekë në datën 29.05.2008, nga Ministria e Shëndetësisë me përshkrimin në transfertën bankare “{\*\*\*} pagesë për përktime”. Në kushtet kur kjo pagesë jep informacion të plotë për paguesin dhe shërbimet e ofruara dhe është kryer nga një institucion publik shtetëror, Kolegji çmon se kjo e ardhur duhet të bëhet pjesë e analizës financiare të subjektit për vitin 2008.

**ii.** Pagesë, në shumën 7.304 lekë në datën 11.04.2008, për të cilën dërguesi i fondeve nuk identifikohet dhe transaksioni identifikohet me përshkrimin “HONO E. P. ”, Kolegji çmon se kjo shumë nuk mund të bëhet pjesë si e ardhur në analizën e vitit 2008, për shkak se mungon e dhëna mbi dërguesin apo përfituesin e shërbimit. Gjithashtu, rezulton se për këtë shumë subjekti e personi i lidhur nuk kanë dhënë ndonjë specifikim/shpjegim në DVP-në e vitit 2008, lidhur me natyrën e shërbimit dhe me dërguesin e shumës.

**iii.** Pagesë, në shumën 10.800 lekë në datën 10.06.2008, për të cilën dërguesi i fondeve, edhe në këtë rast, nuk identifikohet dhe transaksioni ka përshkrimin “Hon E. P. ”, ashtu siç u arsyetua edhe më lart, kjo shumë nuk mund të bëhet pjesë e analizës për shkak se mungojnë të dhëna mbi dërguesin/përfituesin e shërbimit dhe natyrën e marrëdhënies që ka krijuar këto të ardhura, për të cilat mungon ky informacioni edhe në DVP-në e vitit 2008.

Në lidhje me këtë pretendim, Kolegji gjen të drejtë si të justifikuar me dokumentacion ligjor përfshirjen vetëm të shumës 1.601 lekë si të ardhur e bashkëshortit të subjektit në vitin 2008, nga përktimet për institucione të ndryshme.

**25.1.7.** *Lidhur me të ardhura nga angazhime të bashkëshortit të subjektit për përktime të kryera për Këshillin e Evropës, për vitin 2008, në shumën 691 euro. Nga të dhënat bankare rezulton një transfertë pranë “Alpha Bank”, në vlerën 291 euro, më datë 21.04.2008, e cila është përfshirë në analizën financiare nga Komisioni si e ardhur. Diferenca prej 400 eurosh (691euro – 291 euro), sipas subjektit, nuk është përfshirë si pagesë në analizën financiare si e përfituar për shërbimin e përktimit në seminarin e Këshillit të Evropës me temë “Kualifikimi dhe menaxhimi i buxhetit financiar për gjykatat organizuar nga Shkolla e Magjistraturës”. Subjekti shpjegon se dhe pagesa e shumës 400 euro është bërë *cash* me faturën e datës 07.03.2008, lëshuar nga organizatorët e seminarit.*

**i.** Kolegji konstaton se për të ardhurën (në shumën 400 euro), të pretenduar nga subjekti, e cila, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, ka barrën e provës të provojë se këto të ardhura përmbushin kërkesat e nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit, ajo ka dështuar të provojë që për to janë paguar detyrimet tatimore. Në këto kushte, Kolegji e gjen të drejtë mospërfshirjen e kësaj shume si të ardhur në analizën e këtij viti.

**25.2.** Në përfundim, bazuar në sa analizuar më sipër, Kolegji konkludoi që analiza financiare e subjektit të rivlerësimit dhe e familjes së saj, për vitin 2008, do të ndryshojë vetëm duke shtuar si të ardhur të ligjshme shumën (+) 1.601 lekë të përfituar me transaksion bankar nga



një ent publik me përshkrimin “Pagesë për përkthime”. Për këtë shumë, Kolegji vlerësoi se subjekti ka mundur të provojë marrëdhënien që ka siguruar të ardhurën, vlerën e paguar për shërbimin e ofruar dhe nuk ka dyshime për pagimin e detyrimeve tatimore, meqenëse, në këtë rast, pages është një institucion publik shtetëror. Në përfundim edhe pas këtij korrektimi të rezultatit të analizës financiare të vitit 2008, sërish subjekti gjendet në situatë negative në vlerën (-) 1.049.463 lekë, për të mbuluar kostot e jetesës dhe pasuritë e krijuara në këtë vit.

26. Kolegji, gjithashtu, mori në shqyrtim pretendimet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, në të cilat ajo konsideron si jo të saktë analizën e kryer nga Komisioni për vitin 2010, sipas së cilës subjekti në këtë vit rezulton me situatë financiare negative në shumën (-) 361.867 lekë, duke pretenduar se edhe në këtë vit Komisioni në mënyrë të padrejtë ka rritur shpenzimet për udhëtime dhe nuk ka përfshirë në analizë të ardhura të siguruar nga veprimtaria si përkthyes e bashkëshortit, të cilat subjekti pretendon se përmbushin kriteret për t’u konsideruar të ardhura të ligjshme.

26.1.1. Në drejtim të shpenzimeve të përfshira në analizën e Komisionit për vitin 2010, subjekti pretendon reduktim të vlerës së përlllogaritur nga Komisioni, në shumën 3.854 euro, pasi për disa udhëtime<sup>75</sup> pretendohet që kanë qenë në funksion të punëve të ofruara bashkëshortit të subjektit nga organizatorët e veprimtarive, ku ai ka merre pjesë. Referuar tabelës së analizës financiare të paraqitur në vendimin e Komisionit, Kolegji konstaton se shpenzimet e udhëtimit për vitin 2010 janë përlllogaritur në vlerën 88.537 lekë (ekuivalent 638 euro), që do të thotë që Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit. Kolegji vëren se vlera 88.537 lekë i korrespondon vetëm kostove të udhëtimit të subjektit të vëllai i saj me shpenzime ditore të përlllogaritura në masën 5 euro/ditë, si dhe të qëndrimit të subjektit dhe të vajzës në Gjermani, gjatë periudhës kur bashkëshorti ishte me bursë studimi. Në këto kushte, Kolegji konstaton se pretendimi i subjektit për pakësim të shpenzimeve të udhëtimit nuk përputhet me situatën faktike, pasi nisur nga vlera që është përfshirë në analizë si shpenzim për udhëtime, rezulton se Komisioni ka marrë në konsideratë të gjitha pretendimet e subjektit që janë reflektuar në analizën financiare dhe janë pasqyruar në vendim.

26.2. Kolegji mori në analizë edhe të ardhurat, të cilat subjekti indikon në ankim se nuk janë bërë pjesë e analizës së vitit 2010, përkatësisht për sa vijon.

26.2.1. Lidhur me të ardhurat të bashkëshortit të siguruar nga redaktimi i librit “Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë”, për llogari të fondacionit “{\*\*\*}”, në vlerën 450 euro (62.447 lekë), sipas kontratës së datës 25.11.2010, shumë e cila nuk është deklaruar në DVP-në e vitit 2010, por i është përcjellë ILDKPIK-së me dokumentacion, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

i. Shuma prej 450 eurosh e siguruar nga puna e bashkëshortit për redaktimin e librit “Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë”, për llogari të fondacionit “{\*\*\*}”, nuk është deklaruar nga subjekti dhe bashkëshorti as në deklaratën periodike vjetore dhe as në deklaratën vetting. Në kushtet kur për këto të ardhura konfirmohet kryerja e shërbimit nga

<sup>75</sup> Pretendime të subjektit në ankim në lidhje me shpenzimet e përlllogaritura nga Komisioni për udhëtimet:

- udhëtimi i datës 21.02.2010 është shërbim pune për GTZ;
- udhëtimi i datës 06.04.2010 dhe datës 20.09.2010 është shërbim pune për misionin PAMECA;
- udhëtimi i datës 30.09.2010 është shërbim pune për guidën për llogari të {\*\*\*};
- udhëtimi i datës 20.12.2010 është udhëtim për vizite të vëllai i personit tjetër të lidhur, në Itali.
- Sipas subjektit pavarësisht se kontrata me GTZ, marrëveshja me PAMECA dhe {\*\*\*} nuk përcaktojnë mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit e kostos të qëndrimit në zbatim të neneve 850, 783 dhe 708 të Kodit Civil, shpenzimet që kanë të bëjnë me kostot e ofrimit të shërbimit të përkthimit i ngarkohen blerësit të shërbimit dhe jo ofertuesit të shërbimit.

marrëveshja e firmosur ndërmjet përfaqësuesit të “{\*\*\*}” dhe subjektit të rivlerësimit, si dhe përcaktohet qartësisht se cili nga palët është përgjegjës për pagesën e tatimit (Agjencia), Kolegji çmon se subjekti ka përmbushur detyrimet në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, këto të ardhura do të konsiderohen si të ligjshme në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit dhe do të bëhen pjesë e analizës financiare të vitit 2010.

**26.2.2.** Lidhur me të ardhurat e përfituara nga përkthimet që bashkëshorti i subjektit ka ofruar për projektin/misionin “PAMECA”, në vlerën 4.472 euro (620.713 lekë), Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

**i.** Në lidhje me këtë shumë të pretenduar si të siguruar nga veprimtaria e bashkëshortit si përkthyes, subjekti ka ngritur të njëjtat pretendime si në lidhje me ato të ngritura prej saj për të ardhurat e siguruar nga ky ent edhe në vitin 2007. Sipas subjektit, projekti/misioni “PAMECA” është subjekt i regjistruar në organet tatimore me NIPT {\*\*\*} dhe, si i tillë, ka pasur detyrim ligjor për të mbajtur tatimin në burim për pagesat e kryera në vitin 2010. Edhe në këtë rast, Kolegji konstaton se kërkuesi i shërbimit të përkthimit projektin/misionin “PAMECA” ka shënuar në kontratë se *individit (ofruesi i shërbimit) është përgjegjës për pagimin e tatimit mbi të ardhurat*, por, sipas subjektit, në zbatim të neneve 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998 tatimi në burim duhej të mbahej detyrimisht nga projekti/misioni “PAMECA”. Gjithashtu, për vitin 2010, subjekti pretendon se ka paraqitur faturat<sup>76</sup> nr. 1, 2, 3 për të provuar përfitimin e shumës së deklaruar, duke shpjeguar se për shlyerjen e detyrimeve tatimore misioni i ka shpjeguar se nuk kanë ruajtur dokumentacionin që vërteton kryerjen e pagesës së tatimit në burim.

**ii.** Kolegji, në kushtet kur subjekti sërish ka dështuar si mbajtës i barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar ligjshmërinë e kësaj të ardhure, sipas kërkesave të nenit 3, pika 19 dhe të nenit 30 të ligjit, çmon ashtu si edhe në analizat e mësipërme për të ardhurat nga ky projekt se ato nuk plotësojnë kushtet për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme dhe nuk do të përfshihen në analizën e këtij viti si të tilla.

**26.2.3.** Lidhur me të ardhurat prej 457.014 lekësh të përfituara nga shërbimet e përkthimit që bashkëshorti i subjektit ka ofruar për personin fizik “{\*\*\*}”, në vitin 2010, për të cilat subjekti pretendon se ka paraqitur dokumentacion provues<sup>77</sup>, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

**i.** Nga analizimi i dokumentacionit provues të sjellë nga subjekti për këto të ardhura, Kolegji vlerëson se në analizën financiare që Komisioni ka kryer për vitin 2010 duhet të përfshihen si të ardhura edhe shumat e fituara respektivisht sipas vlerave: 19.590 lekë, 60.356 lekë; 111.050

<sup>76</sup> Lidhur me këto fatura nga pikëpamja formale, Kolegji konstatoi se ato nuk rezultojnë të jenë të nënshkruara nga pala paguese projekti/mision “PAMECA” dhe nuk kanë asnjë shenjë/logo identifikuese që i lidh ato me këtë misionin.

<sup>77</sup> Dokumentacioni provues që subjekti ka paraqitur për këto të ardhura:

a) mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 01.09.2010, për pagesë në vlerën 5.700 lekë;

b) mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 01.09.2010, për pagesë në vlerën 125.800 lekë;

c) vërtetim për marrje pagese, datë 08.02.2010, për pagesë në vlerën 19.590 lekë, mbajtur tatimi në burim, sipas mandatpagesës nr. {\*\*\*}, datë 02.10.2010, për pagesë në vlerën 19.950 lekë;

d) vërtetim për marrje pagese, datë 06.11.2010, për pagesë në vlerën 60.356 lekë, mbajtur tatimi në burim, sipas mandatpagesës nr. {\*\*\*}, datë 06.11.2010, për pagesë në vlerën 60.356 lekë;

e) vërtetim për marrje pagese, datë 21.12.2010, për pagesë në vlerën 111.050 lekë, mbajtur tatimi burim;

f) vërtetim për marrje pagese, datë 02.03.2010, për pagesë në vlerën 42.900 lekë, mbajtur tatimi burim;

g) vërtetim për marrje pagese datë 01.07.2010 për pagesë në vlerën 97.218 lekë, mbajtur tatimi burim;

h) vërtetim për marrje pagese, datë 01.09.2010, për pagesë në vlerën 25.800 lekë, për të cilën nuk është përlllogaritur tatim në burim (vlëra zero);

i) vërtetim për marrje pagese, datë 01.09.2010, për pagesë në vlerën 100.000 lekë për të cilën nuk është përlllogaritur tatim në burim (vlëra zero).

lekë, 42.900 lekë, dhe 97.218 lekë, të cilat në total janë në vlerën 331.114 lekë. Kolegji ka vlerësuar përfshirjen e këtyre të ardhurave në analizën financiare të vitit 2010, pasi, subjekti, me dokumentacionin provues të paraqitur gjatë hetimit administrativ me vërtetimet për marrje pagese, ka provuar vlerën e përfitimit të bashkëshortit, duke diferencuar vlerën e tatimit në burim të përlogaritur si një detyrim i shoqërisë përfituese të shërbimit. Gjithashtu, në dy raste mandatpagesat e disponuara dhe të përcjella në Komision vërtetojnë që nga vlera totale e shërbimit, bashkëshorti i subjekti ka marrë pjesën e reduktuar nga tatimi në burim. Në këto kushte, arrihet në konkluzionin se detyrimi, për shlyerjen në organet tatimore të tatimit në burim, është dakordësuar se i takon marrësit të shërbimit dhe është përcaktuar, si i tillë, në këtë rast personit fizik “{\*\*\*}”, prandaj ato do të llogariten si të ardhura në analizën financiare të vitit.

**26.2.4.** *Lidhur me të ardhurat në vlerën prej 720 eurosh (99.914 lekë) e përfituar nga bashkëshorti i subjektit nga angazhimet në përkthime për “{\*\*\*}” ShPK, Kolegji konstaton se në fashikullin e hetimit administrativ gjenden të administruara aktet e nënshkruara, midis bashkëshortit të subjektit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK të emërtuara “Aktmarrëveshje” të datave 30.04.2009 dhe 01.10.2009, në të cilat është e përcaktuar që vlera prej 10% e tatimit në burim do të mbahet nga kompania. Nga verifikimi i pagesave të bëra pranë “Raiffeisen Bank” konfirmohen pagesat në vlerat 1.035 euro dhe 14.000 lekë për vitin 2009, si dhe pagesa prej 720 eurosh gjatë vitit 2010.*

Nisur nga kjo situatë faktike arrihet në konkluzionin se detyrimi për shlyerjen në organet tatimore të tatimit në burim është dakordësuar se i takon marrësit të shërbimit dhe është përcaktuar, si i tillë, në këtë rast shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, prandaj ato do të llogariten si të ardhura në analizën financiare të vitit.

**26.2.5.** *Lidhur me të ardhura në vlerën prej 57 eurosh (7.912 lekë) e përfituar nga bashkëshorti i subjektit nga bashkëpunimi me “Kulture Kontakt”<sup>78</sup>, Kolegji konstaton se subjekti ka ngritur të njëjtat argumente si ato të trajtuara më lart, në paragrafin 23.13.3, për sa i përket analizës së vitit 2006. Në këto kushte, edhe në këtë rast, Kolegji nuk e ka përfshirë këtë shumë në analizën e këtij viti, pasi subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për kryerjen e pagesës apo ekzistencën e marrëdhënies së punës dhe pagesën e detyrimeve tatimore.*

**26.2.6.** *Lidhur me të ardhurat në vlerën prej 2.500 eurosh (347.000 lekë) e përfituar nga bashkëshorti i subjektit me burim nga “Bursa Erasmus” e akorduar nga Komisioni Evropian më datë 23.02.2010, për studim kërkimor për një muaj në Universitetin e Grazit, Austri, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.*

---

<sup>78</sup> Shënime të subjektit në Apendiksin nr. 2, ku shpjegon në lidhje me këto të ardhura.

Paguesi i shumës K-Education me e-mail-in e datës 24.06.2020, përgjigjet: Në vijim të procedurave tona e kam dërguar kërkesën tuaj në Zyrat Qendrore në Vienë dhe do të vë në dijeni sapo të kem një përgjigje. Të lutem të marrësh në konsideratë se procedurat e brendshme mund të duan pak kohe dhe me shumë mundësi përgjigja do të vijë pas datës 28.6.2020. Në dijeninë time OeAD/ish-KKA, në bazë të procedurës respektive, i arshivon faturat vetëm për 10 vjet, pra, mund të ndodhi që kërkesa jote e lidhur me pagesat nga 2006 deri 2007 mund të mos plotësohet. Megjithatë, ne do të bëjmë më të mirën për të siguruar informacionin brenda mundësive tona.

Paguesi i shumës ka rezidencë në Shqipëri dhe ka detyrimin e mbajtjes së tatimit në burim, sipas neneve 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998. Dokumentacioni nuk është ruajtur nga bashkëshorti për shkak se ka kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008. DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.06.2020, ka pamundësi të vërtetojë pagesat e tatimit në burim, pasi fondacioni nuk është i regjistruar në DRT. Dokumentacioni për vërtetimin e pagesës në burim nuk është ruajtur nga bashkëshorti për shkak se ka kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008. Kërkoj që për këto të ardhura në qoftë se nuk më kthehet përgjigje brenda afatit ligjor nga Kultur Kontakt të zbatohet nenin 32, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, pasi jam në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive. Në këtë vlerësim të kihet në konsideratë neni 688 i Kodit Civil dhe neni 37 i ligjit nr. 8438/1998.

**i.** Për këtë shumë, subjekti ka shpjeguar se Komisioni Evropian i ka akorduar bashkëshortit të saj shumën 2.500 euro si bursë studimi, si dhe ka mbuluar shpenzimet e tij të udhëtimit në masën 500 euro, për në Austri. Subjekti ka shpjeguar se gjatë kësaj periudhe ajo dhe djali i saj kanë shkuar në Austri dhe kanë shoqëruar bashkëshortin për një periudhë 10-ditore. Në drejtim të kostove të qëndrimit, subjekti shpjegon se gjatë kësaj periudhe ajo dhe djali kanë qëndruar në shtëpinë e një miku austriak, i cili ka ndëruar jetë dhe, për këtë arsye, shpenzimet e jetesës kanë qenë minimale, ndërsa bashkëshorti, për këtë periudhë ka pasur shpenzime jetese si një student (për të cilat subjekti në ankim kërkon të përlllogariten, me kostot që llogaritet Komisioni rreth 900 euro dhe shpenzimet e udhëtimit me vlerë 500 euro). Në drejtim të analizës financiare të vitit 2010, subjekti pretendon që nga shuma prej 2.500 eurosh të pakësohet vetëm shuma prej 900 euro (si kosto jetese mesatare) dhe diferenca prej 1.600 eurosh të përfshihet në analizën financiare të këtij viti si e ardhur. Për provueshmërinë e kësaj të ardhure, subjekti i referohet situatës faktike që ka evidentuar për të njëjtin burim edhe në pretendimet që ka ngritur për analizën financiare të Komisionit, për vitin 2008.

**ii.** Kolegji, pasi mori në analizë këtë pretendim të subjektit, çmon se nisur nga situata faktike e mësipërme pretendimi i subjekti për kursim të një pjese të shumës së përfituar nga bursa prej 2.500 eurosh, mund të kishte kuptim nëse ajo do të shërbente për të mbuluar vetëm shpenzimet e bashkëshortit. Në kushtet kur vetë subjekti pohon se ajo dhe djali i janë bashkuar bashkëshortit në Austri, pa mundur të faktojë qoftë edhe me deklaratë noteriale të lëshuar përgjatë procesit të rivlerësimit kalimtar mbulimin e këtyre kostove nga personat të tretë, ky pretendim mbetet në nivel deklarativ. Gjithashtu, si edhe në trajtimet më sipër të kësaj çështje, Kolegji sjell në vëmendje jurisprudencën e deritanishme<sup>79</sup> të tij.

Për sa më sipër, Kolegji nuk e gjen të drejtë dhe të argumentuar përfshirjen e shumës 1.600 euro, si të ardhur në analizën e vitit 2010.

**26.2.7.** Lidhur me të ardhurat në vlerën prej 300 euro e përfituara nga shërbimet e përkthimit që bashkëshorti i saj ka ofruar për “Ambasadën Austriake”, Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

**i.** Për këtë shumë, subjekti i rivlerësimit shpjegon se Ambasada Austriake, me e-mail-in e datës 24.06.2020, konfirmon kryerjen e pagesës për përkthimet e bashkëshortit të datës 16-18 prill 2010, në shumën 300 euro, por nuk jep informacion mbi pagimin e tatimit në burim që, sipas ligjit, subjekti pretendon se ka qenë detyrim i kërkuesit të shërbimit. Në këtë drejtim, Kolegji konstaton se DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 29.06.2020, shpjegon se Ambasada Austriake ka kryer pagesa të tatimit në burim në vitet 2009 e 2010, por nuk ka mundësi të specifikojë në përshkrim cilit individ ato i përkasin.

**ii.** Për këtë shumë, Kolegji, sërish, si edhe për rastet të ngjashme të evidentuara më sipër në këtë vendim, çmon se në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjekti ka dështuar të provojë se për këtë vlerë janë paguar detyrimet tatimore dhe, si e tillë, ajo nuk përmbush kërkesat e nenit3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit, për pasojë nuk do të jetë pjesë e të ardhurave të analizës ekonomike të vitit.

**26.2.8.** Lidhur me të ardhurat në vlerën prej 337 eurosh e përfituar nga veprimtaria e përkthimit të bashkëshortit për llogari të Fondacioni “Friedrich – Ebert Stiftung”(FES), Kolegji konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

**i.** Subjekti shpjegon se përfitimi i kësaj shume evidentohet nga transaksioni bankar, por për to mungon konfirmimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore. Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 29.06.2020, shpjegon që fondacioni “Friedrich – Ebert Stiftung”(FES) ka kryer pagesa të tatimit në burim për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012, por nuk ka mundësi të specifikojë në

---

<sup>79</sup> Me vendimin (JR) 9/2018 Kolegji ka arsyetuar se: Bursa akordohet si kuotë financiare për ushqim dhe shpenzime të tjera të vogla të studentit, të cilat hyjnë si shpenzime bazë jetese pa përfshirë luksin.

përshkrim secilin individ. E-mal-i i datës 19.06.2020 i fondacionit konfirmon marrjen e pagesave *neto* për vitet 2012, 2013 dhe 2014, por nuk specifikon të dhëna për vitin 2009 dhe 2010, me justifikimin se ka kaluar afati 10-vjeçar i ruajtjes së dokumentacionit dhe nga fondacioni është e vështirë të gjenden të dhënat e kërkuara. Në këto kushte, subjekti kërkon që Kolegji, në zbatim të parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të vlerësojë që ajo gjendet në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurisë.

ii. Lidhur me pretendimet dhe shpjegimet që subjekti ka ngritur në ankim lidhur me këtë shumë, Kolegji çmon se mungesa e të provuarit të shlyerjes së detyrimeve tatimore<sup>80</sup>, për këtë angazhim si përkthyes të bashkëshortit të subjektit edhe pse provohet ekzistenca e marrëdhënies që ka krijuar këtë të ardhur, si dhe përfitimi i shumës prej tij, nuk lejon konsiderimin e kësaj të ardhure si në përputhje me kërkesat e nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, Kolegji çmon që shuma prej 300 eurosh të mospërfshihet si e ardhur në analizën e këtij viti.

26.3. Në përfundim të sa analizuar më sipër lidhur me pretendimet e subjektit për analizën e Komisionit për vitin 2010, Kolegji çmon se kjo analizë duhet të korrektohet duke shtuar si të ardhur shumën (+) 331.114 lekë, e cila afekton analizën ekonomike të vitit 2010 për subjektin e rivlerësimit dhe familjen e saj, duke e shndërruar atë në një situatë financiare pozitive në vlerën (+) 131.608 lekë.

27. *Kolegji, gjithashtu, mori në shqyrtim edhe pretendimet e tjera të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, që lidhen me të ardhura, të cilat, sipas saj, në mënyrë të padrejtë nuk janë përfshirë në analizën e Komisionit edhe për vite për të cilat analiza financiare e Komisionit ka rezultuar pozitive për subjektin. Subjekti në ankim pretendon se është i pajustificuar moskonsiderimi si të ardhura të ligjshme i pagesave të bëra nga institucione të BE apo të vendeve të Bashkimit Evropian.*

27.1.1. Në analizë të këtyre shkaqeve të ankimit, Kolegji, *së pari*, konstaton se pretendimet për të ardhurat si pagesa nga palë të huaja si organizata ndërkombëtare, fundacione etj., subjekti i ka paraqitur në mënyrë të përsëritur duke i përfshirë edhe në këtë grupim, pavarësisht përfshirjes në analizën e secilit vit, kur këto pagesa janë kryer. Në këto kushte, duke konsideruar strukturën e mësipërme të këtij vendimi, në paragrafët në vijim do të trajtohen pretendimet e subjektit për të ardhurat që nuk i përkasin viteve 2006, 2007, 2008 dhe 2010 të marra në analizë në mënyrë të detajuar më sipër, meqenëse ishin edhe vite, në të cilat Komisioni kishte konkluduar se subjekti ishte me situata financiare negative.

27.1.2. Kolegji e sheh të arsyeshme të analizojë në mënyrë të përmbledhur pretendimet e mëposhtme, me qëllim trajtimin e çdo shkakui ankimor, por duke abstraguuar analizën e përgjithshme për të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me institucionet/entet e huaja, analizë e cila gjen pasqyrim më sipër në këtë vendim (në vitet e marra në analizë), por edhe duke pasur parasysh që analiza e mëposhtme nuk i adresohet një rezultati negativ që ka ndikuar në dhënien e masës disiplinore për subjektin. Analiza e të ardhurave si më poshtë i përket përfshirjes apo mospërfshirjes së tyre në analizat financiare të viteve, për të cilat subjekti ka rezultuar me bilanc pozitiv, pavarësisht se Komisioni nuk i ka njohur këto të ardhura. Kjo analizë, gjithsesi, përforcon qëndrimin e Kolegjit mbi çdo të ardhur të pretenduar, sipas strukturës së ankimit të paraqitur dhe krijon një pasojë në analizën e burimeve të likuiditeteve të krijuara në vitet 2011 dhe 2012 të analizuar më lart.

---

<sup>80</sup> *Siç duket se provohet nga aktet për vitet 2012, 2013 dhe 2014, në të cilat bashkëshorti ka përfutuar vetëm shumën neton të pagesës, duke nënkuptuar se diferenca që përfaqëson detyrimin për tatimet është mbajtur në burim prej fondacionit.*

**27.1.3.** Të ardhura nga përkthime të bashkëshortit për *GTZ në shumën 274.050 lekë*, në vitin 2012. Sipas subjektit kjo shumë është konsideruar në analizën financiare të kryer nga Komisioni, por referuar Aneksit nr. 2, rubrika nr. 7, përmban shënimin se nga subjekti nuk ka dokumentacion shoqërues, fakt të cilin subjekti e konsideron si të pavërtetë. Kolegji, lidhur me këtë pretendim, konstaton se këto të ardhura, pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti, janë përfshirë në analizën e Komisionit si të ardhurave të vitit 2012, në këto kushte nuk gjenden të dhëna për t'u reflektuar nga Kolegji në analizë lidhur me këtë pretendim.

**27.1.4.** *Të ardhura të deklaruara në shumën 6.402 euro<sup>81</sup>, në DVP-në e vitit 2010, me burim nga GTZ, e Malit të Zi*, për të cilat, sipas pretendimeve të subjektit në analizën financiare të Komisionit, është marrë vetëm shifra e derdhur në bankë në vlerën 4.156 euro dhe jo e gjithë shuma e deklaruar në DVP-në e vitit 2010, duke pretenduar se pjesë e saj janë dhe të ardhura të marra nga Këshilli i Evropës prej 1.866 eurosh, si dhe vlera të pagesave të Fondacionit "Fridriech Ebert", prej 259 eurosh në datën 12.11.2010 dhe 78 euro në datën 15.11.2010.

**i.** Kolegji, nga analizimi i këtij pretendimi, vëren se sipas të dhënave të analizës financiare, nga ana e Komisionit është përfshirë në analizë shuma prej 4.156 eurosh, që i takon vetëm të ardhurave nga GTZ, në vlerën ekuivalente me 576.843 lekë, si dhe vlera e të ardhurave të marra nga Këshilli i Evropës në vlerën 1.866 euro, ekuivalente me shumën 259.019 lekë. Kolegji çmon se pretendimi i subjektit nuk qëndron, pasi nga ana e Komisionit është konsideruar shuma prej 1.866 euro + 4.156 euro = 6.022 eurosh. Për të ardhurat e pretenduara si të marra nga Fondacioni "Fridriech Ebert" prej 337 eurosh (259 euro me pagesë banke, datë 12.11.2010, si dhe shuma prej 78 eurosh, me pagese banke, datë 15.11.2010), në Aneksin nr. 2, Komisioni ka cituar se *subjekti i rivlerësimit duhet të provojë me dokumentacion lidhur me të ardhura e konstatuara dhe detyrimin për pagimin e tatimit. Deri në këtë moment ato nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare.*

Ndërsa subjekti, në tabelën që jep komente për këto të ardhura, ka shpjeguar se *për këto periudha nuk disponoj dokumentacion shtesë, por duke qenë se fondacioni "Fridriech Ebert" për periudhën në të cilën disponon dokumentacion tregon se ka qenë i rregullt në zbatimin e ligjit, duke mbajtur rregullisht tatimin në burim, nuk ka arsye të vlerësohet se ka bërë ndryshe për pagesa të tjera. DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.06.2020, sqaron se ky fondacion ka kryer pagesa të tatimit në burim në vitet 2009, 2010, 2011 e 2012, por nuk ka mundësi të specifikojë në përshkrim secilin individ. Kërkoj nga Komisioni që për të ardhurat që nuk pasqyrohet pagimi i tatimit në burim të zbatojë nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi jam në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, pasi ai nuk mund të merret në rrugë tjetër për shkak se nuk është ruajtur dokument që vërteton kryerjen e pagesës së tatimit në burim nga bashkëshorti im, pasi ka kaluar afati 5-vjeçar i ruajtjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 9920/2008 dhe nenit 13/5 të ligjit nr. 8438/1998.*

**ii.** Në këto kushte, në mungesë të dokumentacionit që provon pagesën e detyrimeve tatimore, Kolegji, ashtu si edhe Komisioni, e konsideron të drejtë mospërfshirjen e tyre si e ardhur në analizë.

**27.1.5.** *Për IRZ-në, zbatues i projektit të reformës në drejtësi në kuadrin e Euralius*, prej së cilës personi tjetër i lidhur ka deklaruar se ka përfituar në vitin 2011 shumën 2.375 euro dhe në vitin 2012 shumën 130 euro (total 2.5025 euro), Kolegji analizon e konkludon si vijon.

**i.** Nga analizimi i akteve rezulton se, pavarësisht se subjekti pretendon se ka dorëzuar fatura të lëshuara nga IRZ-ja për aktivitetet e organizuara prej saj, këto të ardhura nuk janë njohur

---

<sup>81</sup> Për të ardhura nga GTZ dhe Këshilli i Evropës subjekti i rivlerësimit në DVP e vitit 2010 ka deklaruar: *Pagesë për përkthime nga Këshilli i Evropës dhe GTZ e Malit të Zi për bashkëshortin E. P. në llogarinë [...] në shumën 6402.5 euro.*

nga Komisioni, për shkak se në llogaritë bankare të personit të lidhur nuk konfirmohet kryerja e pagesave për shërbimin e ofruar, si dhe për shkak të mungesës së konfirmimit për shlyerjen e tatimit. Në këto kushte, Kolegji çmon se subjekti nuk ka mundur të provojë pagesën e detyrimeve tatimore për to dhe, për pasojë, me të drejtë Komisioni nuk i ka konsideruar ato pjesë të analizës financiare.

**27.1.6.** *Shuma të siguruara nga angazhimi për përkthim i bashkëshortit të subjektit për projektin/misionin "PAMECA", në vitin 2010, në shumën 4.472 euro, referoni në analizën dhe konkluzionin e dhënë në paragrafin 26.2.2 të këtij vendimi.*

**i.** Të ardhura, po nga projekti/misioni "PAMECA", në vitin 2014, në shumën 1.680 euro, për të cilat në dosjen e ILDKPIK-së ka kontrata shërbimi, por janë të ardhura të padeklaruara, si në deklaratën *vetting*, ashtu dhe në deklaratën periodike vjetore, për të cilat subjekti pretendon se është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentacion që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, pasi një dokument i tillë nuk i është vënë në dispozicion nga subjekti që ka kryer pagesën dhe që ka detyrimin për lëshimin e dokumenteve justifikues. Lidhur me këto të ardhura, subjekti pretendon që projekti/misioni "PAMECA" është subjekt i regjistruar në organet tatimore me NIPT {\*\*\*} dhe ka pasur detyrimin ligjor për të mbajtur tatimin në burim për pagesat e kryera prej saj. Kolegji, lidhur me këto të ardhura të pretenduara për vitin 2014, mban të njëjtin qëndrim të mbajtur më lart për të ardhurat e analizuar për vitet, në të cilat analiza financiare ka rezultuar me bilanc negativ dhe konsideron të drejtë qëndrimin e Komisionit që nuk i ka përfshirë ato në analizën financiare.

**27.1.7.** *Të ardhura nga angazhimi i bashkëshortit për TAIEX (Technical Assistance and Information Exchange), prej së cilës personi tjetër i lidhur ka deklaruar se ka përfituar në vitin 2009 shumën 800 euro. Kolegji konstaton se për justifikimin e këtyre të ardhurave subjekti ka paraqitur një e-mail të Delegacionit të Komisionit Evropian, në Tiranë, në të cilin konfirmohet organizmi i aktivitetit, por nuk konfirmohet as emri i përkthyesit as pagesa dhe as mbajtja e tatimit në burim. Në këto kushte, Kolegji, ashtu si edhe Komisioni për shkak të mungesës së dokumentacionit justifikues mbi kryerjen e shërbimit, marrjen e pagesës, si dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore, çmon se këto të ardhura nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në analizën financiare.*

**27.1.8.** *Të ardhura nga angazhime të bashkëshortit të subjektit për Fondacioni "Friedrich – Ebert Stiftung"(FES), prej të cilave rezulton se janë kryer pagesa në llogaritë bankare të bashkëshortit konkretisht, viti 2009, në shumën 242 euro, në vitin 2011, në shumën 2.230 euro, në vitin 2012, në shumën 578 euro (total 3387 euro), për të cilat mungon konfirmimi mbi shlyerjen e detyrimeve tatimore. Edhe në këtë rast, Kolegji, për shkak të mungesës së dokumentacionit justifikues mbi shlyerjen e detyrimeve tatimore, ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e Komisionit për moskonsiderimin e tyre si të ardhura në analizën financiarë.*

**27.1.9.** *Të ardhura nga angazhime të bashkëshortit të subjektit për përkthime të kryera për Këshillin e Evropës, për vitin 2009, në vlerën 905,97 euro.*

**i.** Kolegji konstaton se nga Këshilli i Evropës është paguar në llogarinë bankare të E. P. në datën 23.07.2009, shuma 905,97 euro. Për këtë pagesë, subjekti nuk ka depozituar konfirmim për shlyerjen e detyrimeve tatimore, por pretendon njohjen e këtyre të ardhurave duke qenë se në kontratat e shërbimit për vitin 2007 dhe vitin 2010 evidentohet mbajtja e tatimit në burim nga Këshilli i Evropës, duke hamendësuar se si rrjedhojë dhe kontrata e vitit 2009 do jetë zbatuar në të njëjtën linjë prej tij.

Nisur nga kjo situatë faktike, në të cilën rezulton se subjekti për këto të ardhura nuk ka mundur të provojë shlyerjen e detyrimeve tatimore, Kolegji çmon ato nuk përmbushim kërkesat e nenit 3, pika 19 dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, me të drejtë nga Komisioni nuk janë konsideruar si të ardhura në analizën financiare të vitit 2009.

**27.1.10.** *Të ardhura nga angazhimi si përkthyes i bashkëshortit për “{\*\*\*}” (Shoqatë Bullgare – Gjermane), prej së cilës personi tjetër i lidhur ka deklaruar se ka përfituar në vitin 2011 shumën 2.230 euro.*

**i.** Kolegji për këtë të ardhur konstaton se, sipas kontratës së datës 20.06.2011 me “Dhomën e Zejeve Sofia” (MBB), pagesi i shumave ka pasur detyrimin e pagimit të tatimit në burim dhe pagesa për shërbimin e përkthimit është bërë në “Alpha Bank”, në emër të E. P.. Kolegji, nga verifikimi i dokumentacionit të disponuar në fashikuj (si pjesë e dokumenteve të përcjella nga subjekti me pyetësorin nr. 6), konstaton se gjendet e administruar kontrata e datës 20.06.2011, në pikën VII “Shpërblimi” të së cilës është specifikuar që *punëmarrësi do të marrë për veprimtarinë e tij, sipas nenit 1 të kontratës, një honorar prej 150 eurosh bruto për çdo ditë përkthimi me gojë gjatë aktivitetit.* Kontrata e datës 20.06.2011 i referohet periudhës 5-ditore (27.06.2011-02.07.2011), me një pagesë totale prej 750 eurosh, pagesë e cila konfirmohet si kreditim në llogarinë bankare të E. P. pranë “Alpha Bank”. Kontrata e ka qartësisht të specifikuar që pagesa ditore është në vlerën *bruto*, që nënkupton që ajo përfshin të gjitha detyrimet. Në të tilla kushte, Kolegji çmon se pretendimi i subjektit për të përfshirë në analizë si të ardhur vlerën 2.230 euro, e cila konfirmohet me kreditim në “Alpha Bank”, nuk mund të përfshihet si e ardhur e ligjshme, pasi ajo përfaqëson vlerën *bruto* të përfituar nga kryerja e shërbimit dhe për të nuk rezulton të jetë paraqitur nga subjekti ndonjë dokument për të konfirmuar shlyerjen e detyrimeve tatimore. Në kushtet kur subjekti për këto të ardhura nuk ka mundur të provojë shlyerjen e detyrimeve tatimore, Kolegji, në referim të parashikimeve të nenit 3 pika 19 dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, çmon të drejtë qëndrimin e Komisionit se ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura në analizën financiare

**27.1.11.** *Të ardhura nga përkthimet e bashkëshorti për “Ambasada Austriake”, në vitin 2009, në shumën 13.000 lekë.*

**i.** Për këtë të ardhur, Kolegji konstaton se, sipas subjektit, kjo e ardhura e pasqyruar në aneksin nr. 2 ka shënimin e Komisionit se mund të konsiderohen pjesërisht në analizën financiare, por aty nuk përcaktohet se në çfarë mase, rrethanë e cila nuk gjen pasqyrim as në analizën financiare. Duke iu referuar aneksit nr. 2, në të cilin janë përmbledhur qëndrimet e Komisionit dhe pretendimet e subjektit në lidhje me të ardhurat, konstatohet se Komisioni është shprehur se *subjekti ka paraqitur një vërtetim në gjermanisht të lëshuar nga Ambasada Austriake për të provuar këto të ardhura. Vlera prej 13.000 lekësh e përfituar në vitin 2009 identifikohet nëpërmjet llogarive bankare të E. P. me përshkrimin përkatës. Ndërsa për shumën 300 euro konfirmohet nga e-mail-i, datë 20.06.2020, pagesa e kryer. Duhet provuar pagesa e tatimeve për të dy shumat. Në referencë të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, këto të ardhura janë konsideruar jo të ligjshme sepse subjekti nuk ka paraqitur dokument provues për kryerjen e pagesës së tatimit.*

Ndërsa, subjekti, në lidhje me këto të ardhura, ka shpjeguar se *Ambasada Austriake, me e-mail-in e datës 24.06.2020, konfirmon kryerjen e pagesës për përkthimin e datës 16-18 prill 2010 dhe se është paguar për shërbimin në shumën 300 euro, por nuk jep informacion mbi pagimin e tatimit në burim, që sipas ligjit ka detyrimin ta paguajë. DRT-ja Tiranë, me shkresën DRT Tiranë me shkresën nr. 14877/1 prot., datë 29.06.2020, sqaron se Ambasada ka kryer pagesa të tatimit në burim në vitet 2009 e 2010, por nuk ka mundësi të specifikojë në përshkrim se për cilin individ.*

**ii.** Nisur nga kjo situatë faktike, Kolegji konstaton se subjektit në mënyrë të qartë i është bërë me dije nga Komisioni që referuar këtyre të ardhurave mungojnë vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve tatimore. Për këto arsye, për këtë shumë, Kolegji sërish, si edhe për rastin e analizuar në vitin 2010 të evidentuara më sipër në këtë vendim, çmon se në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjekti ka dështuar të provojë se për këtë vlerë janë paguar detyrimet



tatimore dhe, si e tillë, ajo nuk përmbush kërkesat e nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit, për pasojë nuk do të jetë pjesë e të ardhurave të analizës ekonomike të vitit.

**27.1.12.** Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka vepruar në dy standarde, pasi për të ardhura të siguruara nga Institucione shtetërore dhe të shlyera nëpërmjet sistemit bankar i ka njohur ato si të ligjshme, ndërsa për të ardhura të siguruara nga fondacioni “Robert Schvartc” në vitin 2009, në shumën 49.900 lekë, si dhe nga Shoqëria “{\*\*\*}”, prej 60.000 lekësh të transferuara përsëri me bankë, Komisioni nuk i ka njohur si me burim të ligjshëm, ndërkohë që ligji ka qenë i njëjtë për të gjithë subjektet, pra, tatimi në këtë rast mbahej në burim nga pagesi i shumës, qoftë ky organ publik apo privat.

**27.1.13.** Subjekti pretendon se nga e Komisioni nuk janë përfshirë si të ardhura pagesat e bëra nga fondacioni “Fridrich Ebert”, pavarësisht se subjekti ka përcjellë dokumentacionin e përkthimeve për vitin 2012, për shumën 4.950 lekë, për vitin 2013, prej 18.720 lekësh dhe për vitin 2014, shumën prej 90.369 lekë, në vlerat *neto* pas zbritjes së taksave dhe vërtetimin e pagesës së tatimit në burim.

**i.** Në analizë të këtij pretendimi, Kolegji, duke iu referuar Aneksit nr. 2, të bashkëlidhur shpjegimeve të subjektit për rezultatet paraprake të hetimit, në të cilin ajo ka dhënë të gjitha shpjegimet në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit, konstaton se të ardhurat e pretenduara me burim nga ky fondacion për vitin 2012, 2013 dhe për vitin 2014 nuk janë deklaruar prej saj as në deklaratat periodike të deklarimit të pasurisë dhe as në deklaratën *vetting*. Gjatë kontrollit të dokumentacionit të disponuar në fashikull, rezultoi se për këto të ardhura konfirmohet kryerja e shërbimit, si dhe pagesa ndaj përfituesit (bashkëshortit), në vlerat *neto*, duke reduktuar vlerën e tatimit për të cilën detyrimi i shlyerjes ka qenë i Fondacionit. Në kushte të tilla, këto të ardhura nga ana e Kolegjit janë marrë në konsideratë si të ardhura me burim të ligjshëm dhe janë përfshirë në analizën financiare, përkatësisht për vitet 2012, 2013 dhe 2014, vite ku subjekti ka rezultuar me vlera pozitive dhe në analizën e kryer nga Komisioni.

**27.2.** Në përmbledhje të sa më sipër, pasi analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat kërkonte rishikimin e analizës financiare të Komisionit për këto vite, duke pretenduar se si pjesë e të ardhurave duhet të përfshihen ato që bashkëshorti i saj ka siguruar nga angazhimi i tij si përkthyes dhe që nuk janë njohur nga Komisioni, Kolegji reflektoi në analizën financiare ato pretendime të subjektit që u gjenden të drejta, në përfundim të së cilës konstatoi se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti gjendet në mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve me të ardhurat e provuara si të ligjshme për këto vite. Edhe pse Kolegji korrektoi rezultatin e analizës financiare të Komisionit për vitet 2007, 2008 dhe 2010 (ky i fundit rezultoi me një balancë pozitive), këto ndryshime rezultuan të pamjaftueshme për të përmbysur konkluzionin e Komisionit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Kolegji, gjithashtu, e gjeti të pambështetur pretendimin e subjektit se gjendej në shumicën e rasteve në kushtet e zbatimit të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2014 dhe se duhej shkarkuar nga përgjegjësia për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara prej personit të lidhur, që kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive.

Në përfundim të analizës, Kolegji arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, në vitet 2003, 2006, 2007 dhe 2008, gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, respektivisht në vlerat: (-) 205.330 lekë; (-) 574.271 lekë; (-) 1.338.249 lekë dhe (-) 1.049.463 lekë, në total për një vlerë prej (-) 3.167.313 lekësh, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Analiza financiare e kryer konfirmon, gjithashtu, mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament edhe për periudhën pas martesës, duke konfirmuar qëndrimin e Komisionit në këtë drejtim dhe e vendosur sërish subjektin në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

28. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, i cili i konsideruar si tërësisht të pabazuara dhe të pavërteta konkluzionet e Komisionit se duke mosdeklaruar veprimet financiare të kryera prej saj (si e pajisur me prokurë nga vëllai) ka synuar t'i përjashtojë ato nga hetimi i ILDKPKI-së, por dhe nga verifikimi i Komisionit gjatë procesit të rivlerësimit, dhe se ka dashur të fshehtë marrëdhënien e saj me pasurisë e vëllait, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga nenit D pika 5 dhe nenit 33 pika 5/c e ligjit nr. 84/2016, Kolegji analizon sa vijon.

28.1. Në vendimin e Komisionit, për marrëdhënien e subjektit me vëllain e saj, është konkluduar sa vijon:

*Në vlerësim të fakteve dhe dokumenteve të mbledhura gjatë hetimit dhe deklarimeve të subjektit krijohet bindja se subjekti i rivlerësimit ka dashur të fshehtë veprimet e kryera më sipër, duke i përjashtuar ato nga hetimi dhe verifikimi që kryen ILDKPKI-ja, por edhe Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, duke bërë kështu deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë në pronësi, posedim apo përdorim të saj.*

*Në vijim të kësaj analize dhe në vlerësim të të gjitha fakteve të konstatuara në rubrikën “Gjetje të tjera”, Komisioni konstaton se shpjegimet që subjekti i rivlerësimit ka dhënë në lidhje me marrëdhënien e saj me këto pasuri, janë hera herës kontradiktore e të paarsyeshme, ato nuk bindin për vërtetësinë e deklaramit të saj, por ngrenë dyshime të forta për paraqitjen e rrethanave të rreme, të cilat tentojnë të fshehin nga kontrolli apo verifikimi një marrëdhënie të një natyre tjetër, që është ajo e pronësisë me këto pasuri.*

*Subjekti i rivlerësimit konstatohet se nuk ka deklaruar Prokurën e Posaçme të vitit 2015, as Prokurën e Përgjithshme të vitit 2007 dhe as një sërë veprimesh të kryera në zbatim të saj në deklaramtën e pasurisë vetting, në përputhje me detyrimin kushtetues të parashikuar në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës edhe atë ligjor të parashikuar në shtojcën nr. 1 të ligjit nr. 84/2016, por as në DPV për të krijuar kështu bindjen se deklaramet ishin koherente dhe të qëndrueshme.*

*Në përfundim të analizës së mësipërme, Komisioni arrin në përfundimin se subjektit i rivlerësimit është përpjekur të mosdeklarojë veprimet e kryera prej saj, duke i fshehur pas veprimeve të kryera për shkak të një prokure dhe më pas të deformatojë faktet që tregojnë natyrën e marrëdhënies së saj me këtë pasuri, duke u gjendur në këtë mënyrë para parashikimeve të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “c”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84.2016, që lidhen me fshehjen e pasurisë.*

28.2. Kolegji, nisur nga këto qëndrime të Komisionit të mbajtura në funksion të analizimit të pasurive të vëllait të subjektit E. Q. dhe nga dispozitat ligjore të aplikuar në këtë rast, që janë përkatësisht neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 33 pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, të cilat parashikojnë rastet e fshehjes së pasurisë, konstaton se Komisioni ka konsideruar se subjekti ka kryer fshehje të pasurive nëpërmjet mbajtjes së tyre në emër të vëllait saj. Sipas akteve të hetimit administrativ rezulton se këtë qëndrim Komisioni e ka mbajtur që në rezultatet paraprake të hetimit të datës 05.08.2020, duke i bërë me dije subjektit se: (i) ka detyrimin të provojë me dokumentacion ligjor dhënien e shumës prej 780.000 lekësh nga vëllai juaj [...]; (ii) nga hetimi administrativ i Komisionit dhe nga verifikimi në sistemin TIMS për z. E. F. Q. rezulton se: 1. Për kontratat e shitjes së mësipërme me nr. 3367/2033, datë 07.08.2013 dhe nr. 3096/2466, datë 21.08.2015, z. E. F. Q. nuk rezulton të ketë qenë në Shqipëri në datat e caktuara për firmosjen e këtyre kontratave dhe nuk rezulton të ketë lëshuar prokurë të të tretë për firmosjen e tyre [sipas sistemit TIMS, z. E. Q. ka dalë nga Shqipëria më datë 22.07.2013 dhe ka hyrë në Shqipëri më datë 23.12.2013. Ndërsa, më datë 25.07.2015 rezulton të ketë hyrë në Shqipëri dhe më datë 14.08.2015, rezulton të ketë dalë nga Shqipëria]; (iii) duket e dyshimtë dhe e paqartë arsyeja e blerjes së apartamentit të dytë në Shëngjin nga E. Q., në vitin 2015, kur tashmë e zotëronte një apartament në këtë zonë të blerë në vitin 2013; (iv) në bazë të nenit

52 të ligjit nr. 84/2016, Ju si subjekt rivlerësimi keni barrën e provës për të provuar lidhur me problematikat e mësipërme, të cilat janë konstatuar nga hetimi i Komisionit.

**28.3.** Në ankim, subjekti ka pretenduar se ka pasur paqartësi për mënyrën se si ka zhvilluar Komisioni analizën për vëllain e saj, duke qenë e paqartë nëse e ka trajtuar ose jo atë si person tjetër të lidhur, pasi ajo pretendon se nuk provohet asnjë situatë (huaje apo dhurimi), sipas përcaktimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që ta klasifikojë vëllain e saj si të tillë. Subjekti vijon pretendimin se nuk ka të dhëna që provojnë se ajo ka marrëdhënie pronësie apo përdorimi me pasuritë e vëllait të saj. Në ankim, subjekti pretendon se nuk ekziston prokura e vitit 2007, të cilin Komisioni e konsideron si të padeklaruar prej subjektit.

**28.4.** Kolegji, në analizë të këtij shkakut ankimi, verifikoi *së pari* situatën faktike që lidhet me prokurat e dhëna dhe kontratat e nënshkruara nga vëllai i subjektit të rivlerësimit të cituara në vendimin objekt shqyrtimi dhe konstatoi se:

**i)** Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 08.02.2019, Komisioni i ka kërkuar Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht zyrës së regjistrimit noterial, çdo informacion të dokumentuar nga Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH), për shtetasit: Fjoralba Prifti, E. P. , S. P. , P. P. , E. Q. dhe F. Q..

**ii)** Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.03.2019, Ministria e Drejtësisë i ka përcjell Komisionit listën e veprimeve noteriale të kryera nga subjekti, bashkëshorti dhe vëllai i saj E. Q..

**iii)** Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.07.2020, Komisioni i ka kërkuar Ministrisë së Drejtësisë kopje të njehsuara me origjinalin të dokumenteve të nënshkruara pranë zyrës së noteres A. H. (Sh.) përkatësisht: (a) kontratë huapërdorje, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.12.2013, me palë Fjoralba Prifti; (b) prokurë e posaçme, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.12.2015, lëshuar nga E. Q.; (c) prokurë e përgjithshme, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.06.2017, lëshuar nga E. Q.; (ç) revokim prokure, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.08.2018, lëshuar nga E. Q..

**iv)** Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka administruar shkresën e Drejtorisë Përgjithshme Kundër Pastrimit të Parave (në vijim “DPPP”) të datës 19.02.2019, me anë të së cilës janë raportuar transaksione bankare, si më poshtë: (a) tërheqje e shumës prej 1.235.000 lekësh, në llogarinë pranë “ProCredit Bank”, më datë 17.04.2015, nga subjekti i rivlerësimit, me anë të Prokurës së Posaçme, për llogari dhe në emër të vëllait të saj, z. E. F. Q.; (b) depozitimi në *cash* i shumës prej 2.005.000 lekësh, nga subjekti në llogarinë bankare pranë BKT-së, të vëllait të saj, z. E. F. Q., më datë 07.07.2015. Burimi i të ardhurave të subjektit të rivlerësimit është deklaruar nga “biznesi”.

**v)** Komisioni, me rezultatet paraprake të hetimit, i ka kaluar barrë prove subjektit për transaksionet bankarë të raportuara nga shkresa e DPPP-së, duke i bërë me dije se *me anë të një Prokurë të Përgjithshme (me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 01.01.2014, përcjellë me përgjigjet e pyetësorit datë 05 maj 2020) më datë 01.01.2014, vëllai i saj, E. Q., i ka dhënë të drejta dhe kompetenca të plota të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për administrimin e pasurive të tij të luajtshme dhe të paluajtshme, kudo ku ato të jenë të regjistruara apo ato që mund të fitoj në të ardhmen. Nga sistemi TIMS duket se z. E. Q. rezulton të ketë qenë në Shqipëri për lëshimin e prokurës së përgjithshme. Duke u bazuar në deklarinimet e subjektit, në muajin shkurt 2015 vëllai i saj ka ardhur në Shqipëri, duke sjellë me vete 780.000 lekë (kursime nga të ardhurat personale nga puna e tij), të cilat ia ka dhënë subjektit, që t'i investonte në emër të tij në obligacionet e qeverisë shqiptare. Nga sistemi TIMS rezulton se z. E. Q. ka ardhur në Shqipëri më 21 shkurt 2015. Duket se nuk provohet me dokumentacion dhënia e shumës prej 780.000 lekësh nga z. E. Q. drejt subjektit të rivlerësimit.*

**28.5.** Subjekti i rivlerësimit konstatohet se nuk ka deklaruar prokurën e posaçme të vitit 2015, as prokurën e përgjithshme të vitit 2007 dhe as një sërë veprimesh të kryera në zbatim të saj në deklaratën e pasurisë *vetting*, në përputhje me detyrimin kushtetues të parashikuar në pikën 5,

të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës edhe atë ligjor të parashikuar në shtojcën nr. 1 të ligjit nr. 84/2016, por as në DPV për të krijuar, kështu, bindjen se deklaratimet ishin koherente dhe të qëndrueshme.

**28.6.** Kolegji analizoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit që kundërshton qëndrimin e Komisionit lidhur me mosdeklarimin e prokurës/prokurave të lëshuara nga vëllai i subjektit për vetë subjektin. Nga kjo analizë, Kolegji konstaton se, duket se ka një gabim në shkrim në qëndrimin e Komisionit lidhur me mosdeklarimin e prokurës së përgjithshme të vitit 2007, ndërsa rezulton se vëllai E. Q. ka lëshuar për subjektin prokurën e përgjithshme në vitin 2017. Në të njëjtën mënyrë, Kolegji konstaton gabimin në shkrim për prokurën e përgjithshme të lëshuar në vitin 2014, e cila citohet në vendim si e posaçme dhe e lëshuar në vitin 2015. Kolegji vlerëson se Komisioni i është referuar prokurës së përgjithshme të vitit 2014, kur i referohet asaj si prokurë e posaçme e vitit 2015, pasi në arsyetimin e vendimit, Komisioni i referohet veprimeve të subjektit, të cilat janë kryer në bazë të prokurës së vitit 2014, duke i konsideruar këto veprime si të kamufluara duke mos u deklaruar, as ato dhe as prokura që legjitimonte kryerjen e tyre. Kjo situatë është ngritur prej subjektit në ankim si një arsye që tregon pabazueshmërinë e vendimit të Komisionit, sipas subjektit i mbështetur në fakte të pavërteta. Kolegji, ndërsa konsideron si një lapsus gabimin në vitin e prokurave dhe në emërtesën e tyre, ka një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, për sa i përket detyrimit të subjektit për deklarimin e prokurës së datës 09.06.2017 dhe asaj të datës 01.01.2014, e cila ka shërbyer për kryerjen e veprimeve bankare që lidhen me krijimin e obligacioneve në emër të vëllait të subjektit.

**28.7.** Duke pranuar faktin se vendimi i Komisionit i referohet dy prokurave të saktësuara më lart, të cilat janë lëshuar prej vëllait të subjektit në emër të saj, arsyetohet si vijon. Për sa i përket prokurës së përgjithshme të datës 09.06.2017, e cila as nuk është arritur të administrohet në fashikull, por të dhënat e saj vijnë nga informacioni që ka përcjell Ministria e Drejtësisë, Kolegji konstaton se ajo, jo vetëm është lëshuar pas përpilimit dhe dorëzimit të deklaratës *vetting* në janar të vitit 2017, por edhe nuk është e asociuar me ndonjë veprim konkret të kryer prej subjektit për llogari të vëllait të saj, i cili të jetë marrë në analizë prej Komisionit. Në këto kushte, referimi te kjo prokurë dhe konsiderimi i mosdeklarimit të saj në deklaratën *vetting*, në një kohë që ajo është kryer pas saj, vlerësohet si një konkluzion i gabuar dhe i pambështetur në rrethanat faktike prej Komisionit, për pasojë Kolegji e gjen të panevojshme të analizojë aspektin ligjor lidhur me të.

**28.8.** Për sa i përket prokurës së përgjithshme të datës 01.01.2014, lëshuar nga vëllai i subjektit në emër të saj, e cila ka shërbyer më pas për të kryer prej subjektit veprimet e ndryshme bankare me qëllim krijimin e depozitave dhe më pas blerjen e obligacioneve prej subjektit në emër dhe për llogari të vëllait të saj, Kolegji vlerëson se ligji nr. 84/2016 nuk ka parashikuar ndonjë dispozitë urdhëruese për subjektet që të deklarojnë çdo veprim juridik, në të cilin ata janë palë apo ndërveprojnë, por vetëm ato veprime juridike që passjellin për subjektet apo personat e lidhur, të drejta e detyrime me karakter pasuror. Në rastin konkret, veprimtaria e subjektit, duket se është kryer për llogari të vëllait të saj në përmbushje të tagrave të dhëna asaj prej prokurës së përgjithshme të vitit 2014. Nga hetimi i kryer prej Komisionit, nuk ka rezultuar që subjekti të ketë përfituar ndonjë të drejtë pasurore apo të ketë marrë përsipër ndonjë detyrim financiar prej veprimtarisë së është kryer në zbatim të prokurës, në këto kushte nuk evidentohet ndonjë detyrim i saj për deklarim, as në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratimet periodike. Në rast se Komisioni do të kishte ngritur dyshimet që subjekti ka vepruar në emër të vëllait, por duke disponuar realisht për pasuritë e saj, atëherë Komisioni duhej të kishte orientuar hetimin në drejtim të verifikimit të rrethanave që krijonin këto dyshime, por, pavarësisht rezultatit nuk mund të konkludonte për fshehje të pasurisë vetëm për shkak se nuk janë deklaruar veprimet e juridike, për të cilat nuk është i parashikuar detyrimi për deklarim.

**28.9.** Kolegji, në drejtim të analizës për konkluzionet e Komisionit se subjekti ka kryer fshehje duke mosdeklaruar as veprimet që ka kryer në emër të vëllait të saj, pasi verifikoi kronologjinë e ngjarjeve dhe mundësinë e vëllait të subjektit për të financuar me burime të ligjshme shumë e depozituar prej subjektit në emër të tij, prej 780.000 lekësh, në BKT<sup>82</sup>, arriti në konkluzionin se nuk gjendeshin elementë<sup>83</sup> që të justifikonin qëndrimin e Komisionit se subjekti ka fshehur pasuri të sajën, nëpërmjet depozitimit të shumave në emër të vëllait të saj. Argumenti i Komisionit që vëllai i subjektit nuk e ka transferuar shumë prej 780.000 lekësh me rrugë bankare apo se nuk ka gjurmë dokumentare të transportimit të saj nga Gjermania ku ai jeton në Shqipëri apo vënien e saj në dispozicion të subjektit, në mungesë të ndonjë rregullimi ligjor që detyronte transferimin e kësaj shumë, vetëm nëpërmjet rrugëve të gjurmueshme, konsiderohet prej Kolegjit i pamjaftueshëm për të mbështetur konkluzionin se këto para janë pasuri e fshehur e subjektit. Për pasojë, në konsideratë edhe të faktit se veprimet janë kryer brenda një logjike ekonomike, nën autorizimin e një akti që legjitimon veprimin dhe në kushtet kur vëllai i

---

<sup>82</sup> Nga dokumentacioni i disponuar në fashikull, rezulton se E. Q. ka çelur pranë "ProCredit Bank" në datën 29.10.2003 llogarinë me numër {\*\*\*}, në të cilën është kryer një transfertë nga llogaria në llogari me shumë 925.775.79 lekë (që do të thotë se kjo shumë ka qenë e depozituar më herët pranë kësaj banke). Shuma prej 925.775 lekësh është bllokuar në depozitë me afat duke filluar që nga 30.07.2004 e në vijim deri në datën 05.01.2009, e cila së bashku me interesat e përfituara ka arritur vlerën 1.240.497 lekë. Në datën 05.01.2009, kjo shumë është transferuar në një llogari tjetër, po pranë "ProCredit Bank" (llogaria me numër {\*\*\*}) dhe ka vijuar të qëndrojë në depozitë me fat deri më datë 17.04.2015, data kur janë kryer veprimet nga përfaqësuesja me prokurë Fjoralba Prifti. Shuma fillestare e depozitës së bashku me interesat që ka përfituara gjatë periudhës deri në datën 17.04.2015 ka qenë në vlerën 1.237.125.30 lekë. Nga verifikimi i informacionit që paraqet statementi i lëshuar nga "ProCredit Bank" (e disponuar në dokumentacionin e përcjellë nga subjekti me shpjegimet e rezultateve të hetimit), konfirmohen veprimet dhe shpjegimet e dhëna prej saj për ekzistencën e shumës në bankë që prej vitit 2003, si dhe veprimet e kryera në emër të vëllait pranë "ProCredit Bank" në datën 17.04.2015, të përshkruara me detaje si në vijim.

Më datë 17.04.2015, nga llogaria me nr. {\*\*\*} pranë "ProCredit Bank", janë kryer veprimet e mëposhtme:

- mbyllje e parakohshme e depozitës me vlerë 1.237.125.30 lekë (tri veprime);
- depozitim i shumës prej 777.000 lekësh nga subjekti;
- pagesë komisioni në vlerën 2.000 lekë, për bllokim fondesh për bono thesari për fonde totale të disponueshme në vlerën 2.010.985,91 lekë;
- anulim transaksioni për depozitim në llogarinë të shumës 777.700 (kthim mbrapsht depozituesit);
- anulim i pagesës së komisionit prej 2.000 lekësh për bllokim fondesh;
- tërheqje nga llogaria e shumës prej 1.235.000 lekësh.

Vlera totale e shumave të tërhequra në datën 17.04.2015 ka qenë 2.012.000 lekë (1.235.000 lekë nga depozita dhe 777.000 lekë të disponuara nga subjekti në cash), vlerë kjo që provohet se është e njëjta me atë të depozituar prej saj në BKT, më 07.07.2020. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për të ardhurat e vëllait të subjektit, E. Q. të përshkruar me sipër rezulton se ai ka pasur burime të ligjshme për krijimin e shumës prej 777.000 lekësh të dhënë motrës së tij në shkurt 2015, e cila është depozituar më pas në bankë. Sipas analizës financiare për vitin 2014, në të cilën disponohet dokumentacion për të ardhurat e E. Q., rezultati financiar është në masën 17.238 euro mundësi kursimi.

<sup>83</sup> Kolegji, me qëllim verifikimin e plotë të pretendimit të subjektit, lidhur me blerjen e obligacioneve në emër të vëllait të saj, kreu një analizë financiare për të identifikuar mundësinë e blerjes së tyre nga vëllai i subjektit me burime të ligjshme. Kjo analizë është bazuar në dokumentacionin ligjor të disponuar në dosje në lidhje me dhënien e shumës prej 780.000 lekësh nga vëllai E. Q. në shkurt të vitit 2015, si dhe me ekzistencën e shumës së depozituar më herët (2009) pranë "ProCredit Bank" e të tërhequr nga subjekti në datën 17.04.2015. Dhënien e shumës prej 780.000 lekësh në shkurt të vitit 2015, E. Q. e shpjegon dhe e konfirmon në deklaratën noteriele të lëshuar prej tij në datën 20.06.2020. E. Q., gjithashtu, shpjegon se meqenëse motra e tij (subjekti i rivlerësimit) ka disponuar prokurë të posaçme dhe të përgjithshme për kryerjen e veprimeve në emër të tij, ajo ka vepruar pranë "ProCredit Bank", si dhe pranë BKT-së në kryerjen e transaksioneve bankare në tërheqje, prishje depozite, si dhe aplikim për obligacione shtetërore. Meqenëse shkaku i ngritur nga Komisioni gjatë kalimit të barrës së provës ka qenë provueshmëria me dokumentacion ligjor i dhënies së shumës prej 780.000 lekësh nga vëllai, subjekti ka përcjellë pranë Komisionit vërtetime mbi të ardhurat e vëllait për periudhën 2014 dhe 2015, të konfirmuara nga punëdhënësi me vule apostile. Të ardhurat nga punëdhënësi për këtë periudhë janë në shumë 39.350 euro për vitin 2014 dhe 46.300 euro për vitin 2015. Meqenëse shuma pretendohet se është dhënë në shkurt të vitit 2015, në analizën financiare të kryer në Kolegj do të merren në konsideratë vetëm të ardhurat e vitit 2014.

subjekti rezulton të ketë pasur mundësi të krijonte këtë shumë me burime të ligjshme në kohën e depozitimit, Kolegji e gjen këtë konkluzion të Komisionit të pambështetur.

**28.10.** Lidhur me gjetjen tjetër që Komisioni i ka adresuar subjektit të rivlerësimit në raport me vëllain e saj dhe që lidhet me pasuritë e paluajtshme që figurojnë në emër të tij, Kolegji konstaton se Komisioni marrëdhënien e subjektit me vëllain e saj e ka klasifikuar, sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga hetimit administrativ ka evidentuar problematika me situatën e blerjes së pasurive të paluajtshme (dy apartamenteve dhe një garazh), në Shëngjin, Lezhë, në vlerë totale 8 milion lekë. Rezulton se nisur nga fakti që në momentin e lidhjes së kontratave të shitblerjes e dy prej këtyre pasurive, në vitin 2013, sipas të dhënave të sistemit *TIMS* duket që vëllai i subjektit nuk ka qenë prezent në Shqipëri, Komisioni ka ngritur dyshimin se këto pasuri janë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit. Lidhur me këtë situatë, Kolegji vëren se subjekti është përpjekur të shpjegojë mungesën e vëllait në Shqipëri në kohën e përcaktuar si në kontratat përkatëse si data e nënshkrimit të tyre, me disa procedura të lejuara për kryerjen e veprimeve noteriale edhe në një kohë të ndryshme nga ajo e përshkruar në kontratë, për sa kohë që nuk rezulton të ketë cenime të vullnetit të palëve. Subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga situata e sipërcituar, nuk ka tentuar të japë informacion apo të sjellë prova lidhur me mundësinë financiare të vëllait të saj për të krijuar këto pasuri, për të cilat Komisioni ka ngritur dyshime se janë pasuri të fshehura të saj, siç ka vepruar kur ka synuar të justifikojë financimin e shumës prej 780.000 lekësh të vendosur në depozitë në emër të vëllait, duke sjellë prova që tregonin të ardhurat e tij nga punësimi në Gjermani, për vitet 2014 dhe 2015. Ajo nuk ka sjellë prova që provojnë mundësinë e vëllait për investimin në shumën totale prej 8.000.000 lekësh në pasuri të paluajtshme, as përgjatë hetimit administrativ kur janë ngritur dyshimet dhe as me ankimin kur Komisioni e kishte konkluduar në vendim këtë qëndrim të tij. Subjekti ka shpjeguar, gjithashtu, se vëllai ka vendosur të investojë në Shqipëri, duke e konsideruar me interes financiar këtë investim dhe jo të lidhur me nevojën për banim, siç Komisioni duket se e ka arsyetuar.

**28.11.** Krahas këtyre shpjegimeve dhe qëndrimit të subjektit, Kolegji konstaton se qëndron pretendimi i subjektit se Komisioni nuk ka qenë i qartë rreth fakteve të dyshuara, për të cilat i ka kaluar barrën e provës dhe se nuk ka evidentuar nevojën që subjekti të sillte më shumë prova rreth burimeve të krijimit të këtyre pasurive. Nga rezultatet paraprake të hetimit, konstatohet se Komisioni lidhur me këtë situatë i ka kaluar barrën e provës më datë 08.05.2020, duke u shprehur:

- *Se subjekti ka detyrimin ligjor të provojë me dokumentacion ligjor dhënien e shumës prej 780.000 lekësh nga vëllai juaj [...].*
- *Nga hetimi administrativ i Komisionit dhe nga verifikimi në sistemin TIMS për z. E. F. Q. rezulton se: 1. Për kontratat e shitjes së mësipërme me nr. {\*\*\*}, datë 07.08.2013 dhe nr. {\*\*\*}, datë 21.08.2015, z. E. F. Q. nuk rezulton të ketë qenë në Shqipëri në datat e caktuara për firmosjen e këtyre kontratave dhe nuk rezulton të ketë lëshuar prokurë te të tretë për firmosjen e tyre [sipas sistemit TIMS, z. E. Q. ka dalë nga Shqipëria më datë 22.07.2013 dhe ka hyrë në Shqipëri më datë 23.12.2013. Ndërsa, më datë 25.07.2015 rezulton të ketë hyrë në Shqipëri dhe më datë 14.08.2015 rezulton të ketë dalë nga Shqipëria].*

*Duket e dyshimtë dhe e paqartë arsyeja e blerjes së apartamentit të dytë në Shëngjin nga E. Q. në vitin 2015, kur tashmë e zotëronte një apartament në këtë zonë të blerë në vitin 2013. Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Ju si subjekt rivlerësimi keni barrën e provës*

*për të provuar lidhur me problematikat e mësipërme, të cilat janë konstatuar nga hetimi i Komisionit.*

Në të njëjtën mënyrë dhe pa një hetim dhe arsyetim të plotë rreth argumenteve/fakteve që e kanë çuar në konkluzionin se subjekti ka kryer fshehje të pasurisë, Komisioni është shprehur edhe në vendimin objekt shqyrtimi.

**28.12.** Në këto kushte, Kolegji arrin në përfundimin se konkluzioni i Komisionit se subjekti ka fshehur pasurinë e saj duke e regjistruar në emër të vëllait të saj mbështetur vetëm në argumentin se vëllai duket se nuk ka qenë në Shqipëri në kohën e hartimit të kontratave të pasurisë, i pashoqëruar me veprime të tjetra hetimore që do të evidentonin rrethana të tjera, të cilat do të vlenin të analizoheshin për të përcaktuar marrëdhënien e vërtetë të subjektit me këto pasuri, vlerësohet si një konkluzion i pambështetur në fakte.

**28.13.** Kolegji vlerëson se Komisioni duhet të kishte treguar qartësi dhe të kryente veprime të tjera hetimore, duke kërkuar edhe bashkëpunimin e subjektit lidhur me këto fakte, për sa kohë që ato janë renditur si shkaqe që kanë shërbyer për shkarkimin nga detyra. Në situatën konkrete kjo veprimtari nuk është zhvilluar, për pasojë ngarkimi i subjektit me këtë përgjegjësi, konsiderohet jo i drejtë dhe proporcional dhe jo në harmoni me frymën së nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

- 29.** *Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit me të cilin kërkon që çështja e saj në aspektin financiar duhet të analizohet edhe në kuptim të përcaktimeve të nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti pretendon se edhe në versionin e analizës në të cilën pranohet se për një pjesë të të ardhurave të siguruara nga puna e bashkëshortit nuk pranohet pagesa e detyrimeve tatimore, këto të ardhura nuk janë më shumë dyfishi i pasurisë së ligjshme, për të cilën provohet pagesa e detyrimeve tatimore që ajo dhe bashkëshorti disponojnë.*

**29.1.** Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti pretendon se nuk ekziston asnjë rrethanë që justifikon marrjen e masës disiplinore, sipas nenit 61, pika 1 e ligji nr. 84/2016, pasi nuk rezulton që të ketë deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Në funksion të këtij arsyetimi, subjekti në ankim përllëgarit se pasuria që ajo disponon nuk tejkalon dyfishin të ardhurave të ligjshme të krijuara prej saj dhe bashkëshortit. Subjekti pretendon se Komisioni në vlerësimin e rastit të saj duhet të kishte aplikuar parashikimet e nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për të verifikuar si qëndron pasuria e saj dhe e bashkëshortit e krijuar me burime të ligjshme në raport me pasurinë e krijuar për të cilën nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore.

**29.2.** Kolegji, në analizë të këtij shkak ankimi, çmon se referuar përmbajtjes së nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, kjo dispozitë mund të thirret për aplikim në ato raste kur organet e rivlerësimit nga kontrolli i kriterit të pasurisë së subjektit konstatojnë si të vetmen mangësi që e vendos subjektin në pamundësinë për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të kërkuar nga nenit 30 i këtij ligji, mospagimin e detyrimeve tatimore, ndërsa rezulton i provuar dhe pa dyshime burimi i ligjshëm i krijimit të këtyre pasurive. Në këto rrethana do të mund të vlerësohej, nëse pasuria e krijuar nga subjekti e personi i lidhur duke shmangur pagimin e detyrimeve tatimore tejkalon apo jo dyfishin e pasurisë së ligjshme, sipas parashikimit të nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

29.3. Në rastin objekt analize, Kolegji konstaton se Komisioni masën disiplinore për shkarkimin e subjektit nga detyra e ka bazuar në konkluzionin se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, në kushtet e fshehjes se pasurisë, sipas nenit 33, pika 5, germa “c”, si dhe të deklarimit të rreme, sipas nenit 33, pika 5, germa “ç” të po këtij ligji. Nisur nga ky konkluzion i Komisionit, si dhe nga sa analizuar më sipër, edhe në versionin që Kolegji vlerësoi se nuk gjendet i bazuar konkluzioni i Komisionit se subjekti ka kryer fshehje dhe deklarimin të rremë të pasurisë, referuar hetimit administrativ, rezulton e provuar se subjekti ka dështuar të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive, për shkak të mungesës së dokumentacionit që provonte edhe përfitimin e së ardhurës në disa raste të analizuara në mënyrë të detajuar më sipër, përfshi edhe situatën e paqartë e të pasaktësuar prej saj lidhur me burimet e krijimit të pasurive të vëllait, për të cilat Komisioni ka ngritur dyshime, por që mbetën vetëm në këtë nivel, për shkak të adresimit jo në mënyrën e duhur të problematikës prej tij. Kjo situatë, megjithëse ka zhveshur subjektin nga përgjegjësia e zbatimit të nenit 33, pika 5, gjerat “c” dhe “ç” e ligjit nr. 84/2016, sërish ka ngritur çështje lidhur me këto pasuri, të cilat do të pamundësonin në çdo rast aplikimin e nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

30. Në një analizë të përgjithshme të konkluzioneve të arritura në këtë vendim, Kolegji çmon të nënvizojë peshën e balancës negative të konstatuar në shumën prej (-) 3.167.313 lekësh, për vitet 2003, 2006, 2007 dhe 2008, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, lidhur me pasuritë dhe shpenzimet e njësisë familjare të subjektit, si një përgjegjësi e drejtpërdrejtë e saj, që edhe e vetme do të passillte vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Brenda kësaj periudhe, subjekti ka qenë e martuar me personin e lidhur dhe siç është arsyetuar në këtë vendim zgjedhja e bashkëshortit, por edhe e subjektit, për sa kohë që ajo ishte subjekt deklarues sipas ligjit, për të operuar dhe krijuar të ardhura i palicencuar dhe i paformalizuar në një treg të parregulluar mirë, në të cilin minimalisht duhej të parashikohej shmangia e pagimit të detyrimeve tatimore, si pasojë e diversitetit të kërkueseve të shërbimit dhe sjelljes së tyre, e ka vendosur subjektin në kushtet e keqbesimit<sup>84</sup> në raport me shlyerjen e këtyre detyrimeve, pozitë e cila nuk lejon zbatimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, siç subjekti ka kërkuar përgjatë gjithë ankimit të saj. Kësaj shtohet në vlerësim edhe balanca negative prej 4.892.290 lekësh e konstatuar në drejtim të burimeve të financimit të blerjes së apartamentit ku subjekti jeton, e cila, ndonëse i përket bashkëshortit të saj formalisht, afekton në mënyrë të arsyeshme edhe vetë subjektin, për shkak se ajo është krijuar në limitet e lidhjes së martesës dhe në kushtet kur është e pamundur të përcaktohet saktësisht se kur bashkëshortët e ardhshëm kishin filluar të ndërtonin një të ardhme financiare të përbashkët, të gjitha këto fakte të ndodhura gjatë një kohe që subjekti ushtronte funksionet e gjyqtares.

---

<sup>84</sup> Kolegji në jurisprudencën e tij, lidhur me keqbesimin në vendimin nr. 23/2020 (JR), datë 25.09.2020, ka arsyetuar si vijon: [...] Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, me provat e sjella bashkëngjitur parashtrimeve në Kolegj, nuk provoi bindshëm se bashkëshorti i saj ka qenë në kushtet e mirëbesimit për pagimin e taksave nga ana e shoqërisë punëdhënëse dhe se nuk ka qenë në dijeni që punëdhënësi i tij po kryente veprime në kundërshtim me ligjin për shmangien e detyrimeve tatimore. Përkundrazi, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nga provat e administruara dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, u krijua bindja se bashkëshorti i saj ka qenë në kushtet e keqbesimit, sa i përket pagesës së detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, pasi ai vetë pranonte dhe firmoste që vetëm një pjesë e pagës t'i nënshtrohej tatimit. Nuk rezultoi asnjë përpjekje në kohë reale e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, drejtuar punëdhënësit, për pagimin e detyrimeve tatimore dhe pagesën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, ndaj në këto kushte nuk është bindës as pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit se detyrimin për deklarim pranë organeve tatimore e ka pasur punëdhënësi, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.



Në këto rrethana, në një vlerësim tërësor të kriterit të pasurisë, Kolegji arrin në përfundimin e njëjtë me Komisionin se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me këtë kriter, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

31. Në përfundim, pavarësisht se Kolegji i gjeti të drejta disa pretendime të subjektit të parashtruara në ankim, ato nuk arritën të cenojnë vendimin e Komisionit në tërësinë e tij në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë.
32. Në vlerësim dhe analizë të konkluzioneve të mësipërme, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, i gjendur në situatat e mësipërme të shkeljes së ligjit, nuk arrin të përmbushë kriteret kushtetuese për arritjen e një niveli të besueshëm në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, sipas kërkesave të nenit D, pikat 1, 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe, për pasojë, ajo gjendet në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë e cila urdhëron vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit të saj nga detyra. Për pasojë, vendimi nr. 299, datë 17.09.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është marrë mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 299, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Fjoralba Prifti.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 21.02.2023

#### **ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Unë gjyqtare Albana Shtylla, anëtare e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), që shqyrtoi ankimin e subjektit të rivlerësimit Fjoralba Prifti, ndaj vendimit nr. 299, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), dakordësohem me vendimin e trupit gjykues sa i përket zgjidhjes së çështjes, por po parashtroj një arsyetim paralel, të ndryshëm nga ai i shumicës, për disa çështje në këtë vendim.
2. Arsyetimi i ndryshëm është për konkluzionet e shumicës lidhur me:
  - a) Pasurinë apartament dhe garazh, në Tiranë, të krijuar mbi bazën e kontratës së sipërmarrjes së datës 15.03.2004 dhe kontratës së shitjes datë 28.07.2013, konkretisht për:
    - a.1 moskonsiderimin e huas së dhënë nga babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si burim për krijimin e kësaj pasurie;
    - a.2 konkluzionin se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare dhe kualifikimin e kësaj situatë faktike si deklaram të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
  - b) Konsiderimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në kushtet e keqbesimit për arsye se ka zbatuar një mekanizëm persistent të vepruari, me qëllim shmangien e pagimit të detyrimeve tatimore.
  - c) Moskonsiderimin në vitet 2006 dhe 2008 të disa të ardhurave të fituara në këto vite si mësuës me kohë të pjesshme dhe nga shërbimi i ofruar si përkthyes i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.
3. Sa u përket fakteve të rezultuara gjatë hetimit administrativ në Komision dhe të analizuara edhe në vendim, ato nuk do të citohen në mënyrë të detajuar, përveçse kur do të nevojiten gjatë arsyetimit të këtij mendimi paralel.
4. Lidhur me pasurinë apartament dhe garazh, në Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
  - a) në deklaratën vjetore periodike (në vijim DVP) të vitit 2006, subjekti ka deklaruar në rubrikën e detyrimeve financiare detyrimin e bashkëshortit ndaj z. S. P., në shumën 30.000 euro, duke referuar dhe kontratën e huas së datës 14.02.2006;
  - b) në deklaratën *vetting*, subjekti në rubrikën e detyrimeve financiare ka deklaruar detyrimin e bashkëshortit për llogari të kontratës së huas me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.02.2006, redaktuar nga notere T. M., marrë para martese, me qëllim likuidimin e kësteve të kontratës së porosisë së apartamentit të datës 15.03.2004. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në këtë deklaratë, në rubrikën e të dhënave konfidenciale ka deklaruar se huadhënësi është babai i tij, z. S. P., por huaja është dhënë nga kursimet familjare të krijuara nga të ardhurat nga paga dhe puna privat e huadhënësit si mjek, të ardhurat nga emigracioni të djalit V. P., emigrant në Itali që prej vitit 1999, si dhe paga e bashkëshortes si arsimitare.

Po në këtë deklaratë, bashkëshorti i subjektit në rubrikën e detyrimeve financiare ka deklaruar se huaja nga i ati S. P. është marrë pa interes në vitin 2005, me qëllim pagimin e kësteve të kontratës së sipërmarrjes për apartamentin dhe garazhin në Tiranë. Huaja është marrë për një afat 5-vjeçar, megjithëse ky afat ka kaluar detyrimi nuk është përmbushur, pasi ai nuk është kërkuar të përmbushet nga huadhënësi, për shkak të marrëdhënies së posaçme prind-fëmijë me huamarrësin, por edhe as nuk është falur nga huadhënësi.

5. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se marrëdhënia e huas ka ekzistuar dhe huaja ka qenë një nga burimet për krijimin e pasurive apartament dhe garazh, në Tiranë, duke pasur në konsideratë si vijon.

- a) Marrëdhënia e huas është deklaruar në deklarimin fillestar të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, madje duke referuar dhe aktin me të cilin është vendosur kjo marrëdhënie, kontratën e huas me datë 14.012.2006. Gjithashtu, marrëdhënia e huas është deklaruar në mënyrë të plotë dhe të detajuar në deklaratën *vetting*, duke shpjeguar në të edhe elementë të dakordësuar mes palëve për kushtet e dhënies dhe shlyerjes së saj.
- b) Marrëdhënia e huas është formalizuar në vitin 2006, me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.02.2006, si dhe është nënshkruar nga palët, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe babai i tij S. P., edhe pse në kuptim të përcaktimeve të neneve 1050 e në vijim të Kodit Civil nuk është detyrim ligjor formalizimi i marrëdhënies së huas për efekt të vlefshmërisë së veprimit juridik, por është me rëndësi në drejtim të provueshmërisë së ekzistencës dhe pretendimeve për zbatimin e saj.
- c) Në DVP-në 2006, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në rubrikën e detyrimeve financiare ka deklaruar se personi i cili ka dhënë huan ka qenë babai i tij S. P., ndërsa burimin që ka shërbyer për krijimin e kësaj shume e ka deklaruar në deklaratën *vetting*. Referuar ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 9049/2003) dhe shpjegimeve në rubrikat përkatëse të formularit të deklarimit vjetor të pasurisë<sup>85</sup>, në rubrikën e detyrimeve financiare, subjektet deklaruuese kanë pasur detyrimin të pasqyronin personin fizik që kishte dhënë huan, shumën e dhënë, detyrimin e shlyer dhe detyrimin e mbetur të pashlyer. Sipas ligjit nr. 9049/2003 nuk ka qenë detyrim ligjor për subjektet deklaruuese përshkrimi në rubrikën e detyrimeve financiare i burimit/eve që kanë shërbyer për shumën e dhënë hua. Një interpretim i tillë i ligjit dhe i shënimeve sqaruese të kësaj rubrike të formularëve të DVP-së, vlerësoj se është i drejtë duke pasur në konsideratë që në këtë rubrikë deklarohen dhe huat bankare, për të cilat nuk ka kuptim deklarimi i burimit të shumave të dhëna hua, nëpërmjet kredive bankare. Për këtë arsye, kam qëndrim të ndryshëm nga shumica, për këtë çështje në vendim, e cila i jep peshë këtij fakti për konkludimin që subjekti nuk është e besueshme lidhur me deklarimin se nga huaja shuma prej 20 mijë eurosh ka si burim kursimet e të vëllait të bashkëshortit, për shkak edhe të mosdeklarimit të tij në DVP-në 2006, si kontribuues në kursimet familjare, të cilat kanë qenë burimi i shumës së dhënë hua dhe, për rrjedhojë, nuk i ka konsideruar ato.

Bazuar në argumentet e mësipërme kam qëndrim të ndryshëm nga ai i pasqyruar në vendim, edhe lidhur me vlerësimin se përfshirja në deklaratën *vetting* e kursimeve të z. V. P., si burim i krijimit të shumës së dhënë hua, është bërë me qëllim justifikimin me burime financiare të ligjshme të kësaj shume në deklaratën *vetting*<sup>86</sup>. Arsyetimi në të cilin bazohet ky qëndrim në vendim, duket se përpiqet *së pari*, të mbajë një qëndrim duke iu referuar literalisht argumentit të përdorur nga subjekti *ekonomi e përbashkët familjare*, si dhe *së dyti*, të shpjegojë se cila është logjika dhe mënyra e organizimit të një ekonomie të tillë. Ndryshe nga shumica për këtë çështje në vendim, vlerësoj se subjekti në referimin si argument të pasjes nga familja e z. S. P. të një *ekonomie të përbashkët familjare*, ka konsideruar jo veprimtarinë e përditshme me të ardhurat dhe shpenzimet përkatëse të kësaj njësie ekonomike, por mbledhjen e kursimeve të gjeneruara nga të ardhurat e anëtarëve të familjes dhe përdorimin e tyre për nevojat e saj. Duke pasur në konsideratë këtë kuptim, vlerësoj se janë anëtarët e ekonomisë së përbashkët familjare ata që vendosin për mënyrën

<sup>85</sup> *Format i miratuar në zbatim të ligjit nr. 9049/2003.*

<sup>86</sup> *Paragrafi 19.17 i vendimit.*

se si mblidhen dhe administrohen kursimet e tyre. Në këtë kontekst, është e besueshme që edhe familja e z. S. P. të ketë zgjedhur një mënyrë të administrimit të unifikuar të kursimeve të saj, bazuar në të ardhurat e përfituara nga anëtarët e familjes<sup>87</sup> dhe ai në cilësinë e kryefamiljarit të ketë dhënë huan prej 30 mijë eurosh. Kjo zgjedhje e tyre vlerësohet se nuk mund të konsiderohet si rrethanë që nuk krijon besim apo vë në dyshim vërtetësinë e deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* dhe gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, lidhur me përfshirjen në kursimet e ekonomisë së përbashkët familjare dhe të kursimeve të të vëllait të tij z. V. P.. Një mënyrë e tillë e organizimit dhe administrimit të kursimeve është pranuar dhe në çështje të tjera, siç rezulton nga jurisprudenca e Kolegjit<sup>88</sup>. Për më tepër, besueshmëria e deklarimeve të subjektit në deklaratën *vetting* dhe kontrolli i vërtetësisë së tyre nëpërmjet deklarimeve në DVP nuk mund të bazohet në vlerësimin se deklarimi do të ishte i besueshëm, nëse ai do të ishte bërë në një mënyrë, e cila siç u arsyetua më sipër nuk ishte e detyrueshme nga ligji<sup>89</sup>.

- d) Referuar jurisprudencës së Kolegjit<sup>90</sup>, nëse provohet se shuma e dhënë hua është krijuar me burime financiare të ligjshme<sup>91</sup>, si dhe është dhënë në kuadër të marrëdhënieve të posaçme familjare, deklarimi i i huave si burim krijimi pasurie në DVP, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, plotëson kërkesat për justifikimin bindshëm me dokumentacion ligjor të ekzistencës së kësaj marrëdhënie, si dhe transferimit real të shumës së dhënë hua. Legjislacioni në fuqi i kohës nuk ka pasur parashikime, të cilat detyrojnë kryerjen e transferimit të shumave të dhëna hua, në çdo rast shoqëruar me dokumentacion financiar, për më tepër kur ato ndodhin në kushtet e marrëdhënieve të posaçme. Bazuar në sa më sipër, mosprovueshmëria e transferimit të kësaj shume me dokumentacion financiar, në kë të rast, nuk mund të verë në dyshim dhënien e huas nga z. S. P., ndaj bashkëshortit të subjektit<sup>92</sup>.
- e) Në kushtet e një marrëdhënie të posaçme dhe të ngushtë familjare është e besueshme që kursimet familjare të krijuara në vite nga familja të jenë venë në dispozicion të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në vitin 2004, për të mbështetur atë për blerjen e këtyre pasurive, ndërkohë që vëllai i tij [anëtari tjetër i familjes] jetonte për një periudhë relativisht të gjatë kohe jashtë vendit.
- f) Siç edhe rezulton nga kontrata e huas me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.02.2006, huaja është dhënë në janar të vitit 2005, larg në kohë nga momenti i krijimit të bashkësisë ligjore të subjektit të rivlerësimit me z. E. P.. Gjithashtu, nuk rezulton të ketë prova të administruara në fashikull, që gjatë kësaj periudhe subjekti i rivlerësimit të kishte një marrëdhënie të konsoliduar dhe, për më tepër, bashkëjetese me z. E. P.<sup>93</sup>, fakt ky, i cili, nëse do të provohej do të krijonte dyshime lidhur me ekzistencën e marrëdhënies së huas dhe nevojës së subjektit për të simuluar një të tillë, me qëllim justifikimin me burime të ligjshme të pasurive apartament dhe garazh, në Tiranë.

<sup>87</sup> Përfshirë dhe ato të djalit të tyre V. P. emigrant në Itali, i cili ishte në një gjendje familjare me z. S. P..

<sup>88</sup> Vendimi nr.10/2022 (JR), i Kolegjit.

<sup>89</sup> Këtu i referohem qëndrimin të shumicës në vendim, që në DVP-në 2006 në rubrikën e detyrimeve financiare duhet të ishte deklaruar dhe burimi i krijimit të shumës së dhënë hua, duke nënkuptuar deklarimin që në kursimet e familjes përfshiheshin dhe ato të vëllait z. V. P..

<sup>90</sup> Vendimet nr. 4/2021 (JR) dhe nr. 20/2018 (JR), të Kolegjit.

<sup>91</sup> Siç është rasti me një mungesë të papërfillshme të burimeve financiare të ligjshme.

<sup>92</sup> Për sa nuk ka një detyrim ligjor për dhënien/kalimin e shumave vetëm, nëpërmjet gjurimit me dokumentacion financiar.

<sup>93</sup> Përkundrazi në DVP dhe në akte të tjera të administruara në fashikull rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar adresë banimi që nuk përkon me atë të apartamentit në fjalë apo atij ku jetonte më parë z. E. P.. Gjithashtu, nga sistemi TIMS rezulton që vetëm në muajin gusht 2005 ka një udhëtim të përbashkët të subjektit me bashkëshortin e saj të ardhshëm.

- g) Është i besueshëm shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se nëpërmjet kontratës së huas, z. S. P., garantonte kthimin e investimit të familjes së tij në blerjen e apartamentit dhe garazhit nga bashkëshorti i saj, pavarësisht nëse kjo martesë do të ishte ose jo afatgjatë. Për më tepër, nëpërmjet kësaj kontrate huaje, duket se z. S. P. ka dashur të provojë dhe dokumentojë që burimet e krijimit të pasurisë apartament janë edhe të ardhurat e dhëna hua<sup>94</sup>, duke i konsideruar në këtë mënyrë ato si investim të realizuar para martesës dhe shmangur në të ardhmen pretendime të mundshme të subjektit të rivlerësimit për konsiderimin e saj si kontribuuese në krijimin e këtyre pasurive. Bazuar në sa më sipër, qartësimi menjëherë pas martesës i këtij fakti, nëpërmjet kontratës së huas, vlerësoj se nuk mund ketë relevancë për të rënduar subjektin e rivlerësimit apo vënë në dyshim, siç është arsyetuar në vendim, për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare të ndërtuar dhe konsoliduar në vitet në vijim, pas martesës, me familjen e subjektit të rivlerësimit.
- h) Lidhur me mosrespektimin e afatit të përcaktuar në kontratë për shlyerjen e huas, vlerësoj duke pasur në konsideratë si vijon:
- h.1 marrëdhënien e posaçme që kishte bashkëshorti me familjarët e tij dhe ndikimin e saj në drejtim të respektimit të afateve;
  - h.2 rrethanat familjare të krijuara me jetesën e përbashkët të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj me z. S. P. dhe bashkëshorten e tij, në periudhën 2007-2015;
  - h.3 faktin që familja e z. S. P. e konsideronte veten investitor në këtë apartament me vlerën e huas, deri sa ajo të shlyhej nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj;
  - h.4 gjendjen e likuiditeteve bankare të mjaftueshme të z. S. P. në vitet pas dhënies së huas, burimet e qëndrueshme të të ardhurave për jetesën e të vëllait të bashkëshortit z. V. P., ende pa krijuar një familje të tijën e, për rrjedhojë, mospasjen e nevojës për kthimin e saj në afatin e përcaktuar në kontratë;
  - h.5 ekzistencën e likuiditeteve bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, në vlera më të mëdha se vetë shuma e huas gjatë periudhës 2010-2016, të verifikuara si të krijuara me burime financiare të ligjshme edhe nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit në Kolegj.

Ekzistenca e likuiditeteve bankare të sipërcituara në nënparagrafët h. 4 dhe h. 5, ndryshe nga arsyetimi në vendim, në vlerësimin tim provon të kundërtën, pra, që shuma e dhënë hua nuk është shlyer, jo vetëm për shkak të rrethanave të sipërcituara, por dhe mospasjes nevojë nga familjarët e bashkëshortit të subjektit për përdorimin e tyre.

Ndryshe nga arsyetimi dhe qëndrimi në vendim, vlerësoj se shlyerja e huas, me kalimin e shumës prej 30 mijë eurosh në llogarinë e z. S. P., është veprim, i cili është ndërmarrë [edhe pse në tejkalim të afatit kohor të dakordësuar] në zbatim të detyrimit/përcaktimit të kontratës së huas për kthimin e saj te ky i fundit. Transferimi i shumës takuese të vëllait i bashkëshortit<sup>95</sup> nga z. S. P. vlerësoj se nuk ka qenë një detyrim i subjektit dhe bashkëshortit të saj, gjithsesi ajo mund të transferohej në çdo moment në llogarinë e këtij të fundit nga babai i tij, nëse do ishte e nevojshme, ndaj moskryerja e këtij veprimi nga babai i bashkëshortit nuk mund të shërbejë si një rrethanë që hedh dyshime mbi ekzistencën e marrëdhënies së huas së këtij të fundit me personin e lidhur, z. E. P..

6. Në përfundim, në konsideratë të rrethanave të sipërcituara dhe bazuar në një vlerësim harmonik dhe objektiv, të provave të administruara dhe shpjegimeve të subjektit gjatë procesit

<sup>94</sup> Përveç edhe atyre të krijuara nga vetë z. E. P. para martesë.

<sup>95</sup> Shumës prej 20 mijë eurosh, pjesë e kursimeve familjare të dhëna hua nga z. S. P. në janar 2005, e cila kishte si origjinë kursimet e vëllait të bashkëshortit nga punësimi në Itali për periudhën 2002-2004, si dhe për të mbështetur argumentin që ato mund t'i nevojiteshin vëllait të bashkëshortit në rrethanat e reja, pra, emigrimin e tij në ShBA.

të rivlerësimit në Komision, të pretendimeve të paraqitura prej saj në ankim dhe parashtrimet e depozituara në Kolegj, si dhe ligjit të zbatueshëm lidhur me to, krijohet bindja se huaja e dhënë nga z. S. P.<sup>96</sup> në shumën prej 30 mijë eurosh ka qenë burim për krijimin e pasurive apartament dhe garazh, në Tiranë, për rrjedhojë subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë, në përputhje me përcaktimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

7. Lidhur me konsiderimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në kushtet e keqbesimit për arsye se ka zbatuar një mekanizëm persistent të vepruari, me qëllim shmangien e pagimit të detyrimeve tatimore, kam një qëndrim të ndryshëm për mënyrën e përzgjedhur prej tij për ushtrimin e veprimtarisë së përkthyesit të gjuhës gjermane, si dhe sjelljen e tij në raport me detyrimet ligjore.
8. Rezulton se z. E. P. ka ushtruar një veprimtari si përkthyes i gjuhës gjermane dhe përkthimet e realizuara prej tij gjatë periudhës 1997 - janar 2017, pra, para dhe pas martesës, duken se kanë qenë të konsiderueshme në numër dhe volum, duke passjelle dhe të ardhura të pretenduara të konsiderueshme. Në vijim, po paraqes rrethana dhe vlerësimin tim për këtë çështje.
  - a) Ushtrimi i kësaj veprimtarie është bërë kryesisht nëpërmjet marrëdhënies së shërbimit të vendosur ndërmjet tij si individ dhe marrësve të shërbimit, të cilët kanë qenë kryesisht institucione shtetërore vendase apo të huaja, organizata ndërkombëtare, misione ndërkombëtare, organizata jofitimprurëse ndërkombëtare, të regjistruara ose jo në Shqipëri, si dhe shërbime guide turistike gjermanfolëse.
  - b) Legjislacioni në fuqi për tatimin mbi të ardhurat, për të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti gjatë periudhës para dhe pas martese me subjektin, ka qenë ligji nr. 7786, datë 27.01.1994 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar dhe ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre. Ky legjislacion i kohës në përmbajtjen e tij parashikon si të ardhura të tatueshme individuale ato të siguruara nga shërbimet individuale, duke përcaktuar detyrimin e tatimpaguesit/marrësit të shërbimit për mbajtjen dhe derdhjen e detyrimit tatimor në burim. Konsideroj një vlerësim jo të bazuar, në rrethana, fakte të provuara dhe ligjin e zbatueshëm, konkluzionin e shumicës për këtë çështje në vendim, sipas të cilit bashkëshorti i subjekti i rivlerësimit, z. E. P., për shkak të mënyrës se si ka zgjedhur të ushtroj veprimtarinë e përkthimit të gjuhës gjermane, ka qenë në kushtet e keqbesimit për pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara, madje duke theksuar se ky ishte një mekanizëm persistent i vendosur prej tij.

Legjislacioni i sipërcituar nuk detyron profesionistët e kësaj fushe për mënyrën/formën se si duhet të realizohet shërbimi i përkthimit, por e lë në vlerësimin/zgjedhjen e ofruesit të shërbimit, nëse ai do të realizohet nëpërmjet një subjekti tregtar/personi fizik të regjistruar prej tyre, sipas legjislacionit në fuqi apo si individ në marrëdhënie shërbimi me porositësit e tij. Në të dy format e ushtrimit të veprimtarisë profesionale/shërbimit të përkthimit, për të ardhurat e përfituara duhet të paguhet detyrimi tatimor<sup>97</sup>, por subjekti që mban dhe paguan atë është i ndryshëm.

Ndryshe nga shumica për këtë çështje në vendim, vlerësoj se zgjedhja e mënyrës së ushtrimit të veprimtarisë së përkthyesit, nëpërmjet njëres nga format e lejuara nga ligji i

---

<sup>96</sup> Me burim kursimet nga paga dhe aktiviteti privat i z. S. P., pagat e bashkëshortes së tij dhe të ardhurat nga emigracioni në Itali të vëllait V. P. gjatë periudhës 2002-2004.

<sup>97</sup> Neni 2 i ligjit nr. 7786, datë 27.01.1994 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, parashikon si të ardhura të tatueshme ato të siguruara nga shërbime individuale, si dhe nenet 6 dhe 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikojnë se tatimi mbi të ardhurat personale, që më llogaritet mbi të ardhurat e individëve, me burim në Republikën e Shqipërisë.

kohës<sup>98</sup>, në rastin konkret si individ i kontraktuar/porositor për ofrimin e këtij shërbimi, nuk tregon një sjellje të qëllimshme apo veprime të vazhdueshme me vetëdije të bashkëshortit të subjektit për t'u shmangur detyrimeve tatimore, për sa kohë që prej tij është vlerësuar se ky detyrim tatimor prezumohej që do të paguhej në çdo rast nga tatimpaguesi sipas përcaktimit ligjor. Theksoj se marrësit e shërbimit kryesisht kanë qenë organizata/misione/organizata jofitimprurëse ndërkombëtare, institucione shtetërore dhe, në pak raste, subjekte tregtare. Si rregull, faturat/mandatet për shërbimin e përkthimit të ofruar duhet t'i jenë lëshuar nga marrësi i shërbimit bashkëshortit të subjektit në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 7758, datë 12.10.1993 "Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet" dhe ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke mbajtur në konsideratë dhe shumat e detyruara për t'u zbritur.

- c) Për më tepër, ushtrimi i veprimtarisë profesionale, në përputhje me format dhe brenda kufijve të lejuar nga ligji, duhet parë i ndërlidhur me të drejtën që ka çdo individ për të zgjedhur lirisht formën se si do të realizojë veprimtarinë e tij profesionale, ndaj ushtrimi i një të drejte të tillë nuk mund të vendosë individin në kushtet e keqbesimit për shmangien e detyrimeve tatimore. Më së shumti, kjo mënyrë e ushtrimit të veprimtarisë së përkthimit të bashkëshortit, para dhe pas martese, e ka penalizuar atë në drejtim të mosdokumentimit/provueshmërisë së shërbimeve të ofruara, vlerës së të ardhurave të përfituara, detyrimeve tatimore të paguara nga marrësit e shërbimit dhe, për rrjedhojë, penalizimin në kuadër të këtij procesi për moskonsiderimin e tyre si të ardhura të ligjshme, në përputhje me përcaktimet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
- d) Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit prej vitit 2011<sup>99</sup> e në vazhdim ka deklaruar në DIVA të ardhura të realizuara nga shërbimi i përkthimit. Kjo sjellje e tij, në përputhje me detyrimet ligjore, zhbën dyshimet për veprime apo mekanizma të ndërtruara prej tij, me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore, duke qenë se të ardhurat e deklaruara janë objekt i kontrollit të kryqëzuar nga vetë organi tatimor për vjeljen e detyrimeve tatimore përkatëse.
- e) Nuk rezulton e provuar nga aktet e administruara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit të ketë bashkëpunuar me marrësit e shërbimit, tatimpaguesit që ligji nr. 8438/1998 detyron për mbajtjen e tatimit në burim, me qëllim shmangien e pagimit të detyrimeve tatimore apo të ketë pasur dijeni për veprime të tyre në mospërmblidhje të ligjit.

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, vlerësoj se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë në keqbesim me mënyrën e zgjedhur për ushtrimin e veprimtarisë së përkthimit, me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore, si dhe nuk ka zbatuar një mekanizëm persistent për këtë qëllim, por ka zgjedhur ta ushtrojë atë në një nga format e lejuara nga ligji, duke prezumuar zbatimin e tij nga marrësit e shërbimit.

9. Lidhur me konkluzionin në vendim se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për krijimin e pasurisë apartament dhe garazh ,në Tiranë, në vlerën (-) 4.892.290 lekë<sup>100</sup> dhe kualifikimin e kësaj situatë faktike si deklarim të

---

<sup>98</sup> Ligji nr. 82/2021 "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar", i cili rregullon vetëm një pjesë të shërbimit të përkthimit, nuk ka përcaktuar si kusht ligjor për ushtrimin e veprimtarisë së përkthyesit zyrtar regjistrimin si person fizik.

<sup>99</sup> Bazuar në ndryshimet që iu bënë në këtë vit ligjit nr. 843,8 datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

<sup>100</sup> Në këtë mungesë burimesh përfshihet: moskonsiderimi i huas prej 30 mijë eurosh të dhënë nga babai i bashkëshortit të subjektit, z. S. P., si dhe moskonsiderimi si të ardhura të ligjshme të të ardhurave të bashkëshortit E. P., nga shërbimet e përkthimit deri në vitin 2005, në vlerën rreth 1.214.785 lekë.

pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ndryshim nga shumica mbaj në konsideratë si vijon.

**9.1** Bazuar në konkluzionin e referuar në paragrafin 6 më sipër, që shuma prej 30 mijë eurosh e dhënë hua nga z. S. P. ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament dhe garazh, si dhe në analizën e pasqyruar në paragrafin 19.31 në vendim, dukej se familja Prifti kishte pasur mundësi për kursime me burime financiare të ligjshme në shumën prej 29.031 eurosh. Analiza e kryer nga Komisioni dhe e kontrolluar nga Kolegji, për këtë mundësi kursimi të familjes Prifti, nuk ka mbajtur në konsideratë të ardhurat e pretenduara, por të paprovuara të z. S. P. nga aktivitetit privat si mjek në klinikën private “{\*\*\*}”, në Korçë, si dhe të ardhurat e pretenduara dhe të paprovuara të vëllait të bashkëshortit nga emigracioni, të paktën për periudhën 2000-2002. Duke pasur në konsideratë rrethanat e sipërcituara, vlerësoj se mungesa e burimeve financiare të ligjshme në vlerën 969 euro, për shumën prej 30 mijë eurosh të dhënë hua, nuk mund të konsiderohet me një peshë të tillë që të bëjë të pabesueshme ekzistencën e marrëdhënies së huas dhe, për më tepër, të vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për këtë pjesë të burimit të krijimit të pasurive apartament dhe garazh, në Tiranë.

**9.2** Sa i përket moskonsiderimit si të ligjshme të të ardhurave të përfituara nga veprimtaria e përkthimit para martesës, të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtyre pasurive, rezulton se z. E. P. gjatë periudhës 1997-2005 ka pasur përkthime të konsiderueshme në lloje të ndryshme shërbimesh, por dhe në volum, duke passjelle dhe të ardhura të pretenduara në vlera të mëdha. Në konsideratë të qëndrimit të mbajtur në paragrafin 7 më sipër, vlerësoj se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur burim të ligjshëm për të ardhurat e përfituara nga shërbimi i përkthimit në gjuhën gjermane, por ato nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për shkak të mosprovueshmërisë së vlerës së tyre dhe mosdokumentimit të pagimit të detyrimeve tatimore.

**9.3** Rezulton që kontrata e sipërmarrjes për pasuritë apartament dhe garazh, në Tiranë, është nënshkruar nga bashkëshorti i subjektit në datën 15.03.2004 dhe 78.500 euro nga çmimi prej 83.500 eurosh, për këto pasuri, janë paguar nga bashkëshorti para se të lidhte martesë me subjektin e rivlerësimit, pra, para datës 08.02.2006.

**9.4.** Nuk rezulton e provuar gjatë procesit të rivlerësimit se: (a) subjekti i rivlerësimit ka kontribuar në pjesën e çmimit të paguar para martese; (b) të ketë pasur një marrëdhënie të konsoliduar apo bashkëjetese para martese, referuar adresës së deklaruar në DVP-të 2003-2005 nga subjekti i rivlerësimit, të dhënat e llogarive të saj bankare, ndërkohë që bashkëshorti në kontratën e porosisë dhe atë të kredisë referon një adresë tjetër banimi; (c) të kenë kryer udhëtime së bashku jashtë vendit, përveç atij të muajit gusht 2005, që përsëri është larg në kohë nga parapagimi i detyrimeve për pjesët e çmimit të pasurisë.

- 10.** Në përfundim, nga kontrolli i analizës së Komisionit në Kolegj, rezultoi që për pagesat e kryera, lidhur me pasuritë apartament dhe garazh, në Tiranë, në vitet 2004-2005, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për pjesën e çmimit të paguar për këto pasuri në këto vite<sup>101</sup>, për shkak të moskonsiderimit kryesisht si të ardhura të ligjshme të të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti i saj nga shërbimi i përkthimit të gjuhës gjermane para martese. Pavarësisht sa më sipër, rezultoi e provuar se, ato kanë rrjedhur nga një burim i ligjshëm, periodha në të cilën bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka investuar për pagesën e pjesës më të madhe të çmimit<sup>102</sup> për këto pasuri ka qenë përtej kohës kur personi i lidhur dhe subjekti

---

<sup>101</sup> Para martese.

<sup>102</sup> Shuma 78.500 euro.



i rivlerësimit ishin në kushtet e bashkësisë ligjore dhe kur subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur vepronin financiarisht në autonomi të plotë.

Theksoj se për të ardhurat e bashkëshortit, që kanë shërbyer si burime për këto pasuri para martese, nuk janë ngritur dyshime dhe nuk është provuar nga hetimi administrativ në Komision, se ato vijnë nga aktivitete të kundërligjshme të tij. Për këto arsye, në vlerësim të situatës së mësipërme faktike, në konsideratë dhe të jurisprudencën së Kolegjit<sup>103</sup>, por dhe vendimin e GjEDNj-së për çështjen Sevdari kundër Shqipërisë<sup>104</sup>, çmoj se mungesa e burimeve financiare të ligjshme të bashkëshortit për pagesat për pasuritë apartament dhe garazh, në Tiranë, para martese nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe ato nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në procesin e rivlerësimit kalimtar, për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit.

11. Sa i përket moskonsiderimit në vitet 2006, 2007 dhe 2008, të disa të ardhurave të fituara në këto vite nga shërbimi i ofruar si përkthyes i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, kam një qëndrim të ndryshëm për marrëdhëniet e shërbimit dhe punësimit si vijojnë.

**11.1** Lidhur me të ardhurat prej 270.000 lekësh të përfituara nga bashkëshorti prej Liceut “{\*\*\*}”, konfirmohet nga vërtetimi i shkollës së mesme të përgjithshme jopublike “{\*\*\*}” se bashkëshorti i subjektit ka qenë mësues me kohë të pjesshme me pagë mujore 300 mijë lekë. Në ndryshim nga shumica për këtë çështje në vendim, vlerësoj se këto të ardhura duhet të konsiderohen, pavarësisht faktit se nuk provohet pagimi i tatimit në burim, si dhe pagesa e sigurimeve shoqërore si mësues me kohë të pjesshme për z. E. P., për arsyet si vijojnë.

Nga vërtetimi i sipërcituar provohet që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë i punësuar pranë liceut “{\*\*\*}”, për një periudhë të caktuar kohe me pagën 30 mijë lekë në muaj. Në mungesë të një kontrate pune, vërtetimi i sipërcituar provon natyrën e marrëdhënies së vendosur ndërmjet z. E. P. dhe punëdhënësit të tij, kohën që ai ka qenë në dispozicion të punëdhënësit, si dhe shpërblimin për punën që do të kryente. Bazuar në këto elementë provohet se shumica prej 270 mijë lekësh rrjedh nga një burim i ligjshëm, siç janë marrëdhëniet e punës. Sa i përket provueshmërisë së përfitimit të saj, neni 118 i Kodit të Punës, dispozita në fuqi në kohën e zbatimit të kësaj marrëdhënie pune, njëjtte mundësinë e pagimit dhe me mënyra të tjera përtej atyre të sistemit bankar. Në këto kushte, është e besueshme që shumica e pagës mujore e referuar në vërtetimin e liceut “{\*\*\*}” të jetë përfituar në *cash* çdo muaj, përkundrejt firmosjes në dokumentacionin financiar të punëdhënësit. Sa i përket pagimit të detyrimeve tatimore mbi pagën e bashkëshortit të subjektit, në konsideratë të konkluzionit të mësipërm se natyra e kësaj marrëdhënie është e një marrëdhënie juridike pune, si dhe bazuar në nenet 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998, tatimi në burim mbahet në burim nga paguesi i shumave, pra, nga punëdhënësi. Po kështu, në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbajtja, evidentimi dhe derdhja e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore është përgjegjësi e punëdhënësit. Mungesa e dokumentacionit të punëdhënësit që provon pagesën e këtyre detyrimeve apo dhe mospagimi i këtyre detyrimeve nga punëdhënësi, në kushtet kur nga procesi i hetimit në Komision nuk ka rezultuar që bashkëshorti i subjektit të ketë bashkëpunuar me punëdhënësin apo vepruar në keqbesim për shmangien nga detyrimet tatimore, nuk mund të penalizojë bashkëshortin e subjektit në drejtim të njohjes si të ardhura të ligjshme të pagës së përfituar në shumën prej 270 mijë lekësh, pranë liceut “{\*\*\*}”. Në analizë të situatës faktike të sipërcituar dhe ligjit të zbatueshëm lidhur me të, vlerësoj se shumica

<sup>103</sup> Vendimet nr. 15/2021 (JR) dhe nr. 19/2022 (JR), të Kolegjit.

<sup>104</sup> Paragrafët 88-93 të këtij vendimi të GjEDNj-së.

prej 270 mijë lekësh e përfituar si pagë në liceun “{\*\*\*}” plotëson kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe duhet të konsiderohej si e ardhur e ligjshme dhe të përfshihej në analizën financiare të këtij viti, duke rezultuar në përfundim me mungesë burimesh të ligjshme për krijim pasurish dhe kryerje shpenzimesh në vlerën (-) 304 271 lekë.

11.2 Lidhur me shumën e përfituar nga shoqëria “{\*\*\*}” në vlerën prej 550 eurosh, rezulton se me shkresën e datës 05.04.2008 të kësaj shoqërie vërtetohet se nga bashkëshorti i subjektit është marrë në dorëzim shuma prej 550 eurosh dhe 3.200 lekësh për shërbimin për përkthim simultant dhe përkthim me shkrim, për konferencën e organizuar në datën 31.01.2008. Nga vërtetimi provohet se z. E. P. ka pasur një marrëdhënie shërbimi për përkthime me shoqërinë “{\*\*\*}”. Vërtetimi nuk ka të përcaktuar në përmbajtjen e tij një rregull për pagimin e detyrimeve tatimore, ndaj bazuar në nenet 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998, tatimi mbahet në burim nga marrësi i shërbimit/paguesi i shumave, pra, nga shoqëria “{\*\*\*}”. Mungesa e dokumentacionit që provon pagesën e detyrimeve tatimore apo dhe mospagimin e këtyre detyrimeve nga shoqëria “{\*\*\*}”, në kushtet kur nga procesi i hetimit në Komision nuk ka rezultuar që bashkëshorti i subjektit të ketë bashkëpunuar me këtë shoqëri apo vepruar në keqbesim për shmangien nga detyrimet tatimore, nuk mund të penalizojë bashkëshortin e subjektit në drejtim të njohjes si të ardhura të ligjshme të pagës së përfituar në shumën prej 550 eurosh dhe 3.200 lekësh. Në analizë të situatës faktike të sipërcituar dhe ligjit të zbatueshëm lidhur me të, vlerësoj se shumat e sipërcituara të përfituara nga shërbimi i përkthimit me shoqërinë “{\*\*\*}” plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe duhet të konsiderohej si e ardhur e ligjshme dhe të përfshihej në analizën financiare të vitit 2008.

12. Në përfundim, pavarësisht qëndrimeve të ndryshme për çështjet e sipërtrajtuara, përsëri subjekti i rivlerësimit rezultonte me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën (-) 2.834.113 lekë, ndaj çmova se subjekti i rivlerësimit nuk kishte arritur një nivel të besueshëm në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme për vitet 2006, 2007 dhe 2008, duke konkluduar që vendimi nr. 299, datë 17.09.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është marrë mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

**GJYQTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e anëtares, jam dakord me vendimin nr. 5, datë 21.02.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Fjoralba Prifti, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 299, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), por kam mendim paralel, me shumicën e trupit gjykues, për sa i përket qëndrimit të mbajtur dhe konkluzionit të arritur, lidhur me konsiderimin si person tjetër të lidhur të babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për huanë prej 30.000 eurosh, moskonsiderimin e një pjese të të ardhurave të siguruara nga puna e bashkëshortit nga shërbimet e përkthimit gjatë viteve 2003 – 2008, si dhe mosaplikimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për pamundësinë objektive të të provuarit me dokument justifikues të ligjshmërisë së krijimit të një pjese të të ardhurave, të cilat nuk mund të merreshin në rrugë tjetër.
2. Kolegji, në paragrafin 19.38 të vendimit, lidhur me një nga burimet e pasurisë apartament dhe garazh të ndodhur në Tiranë ka konkluduar se: *Në konkluzion të analizës së bërë më sipër lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament dhe garazh, të huasë në vlerën prej 30.000 euro, Kolegji çmon se deklaratimet e subjektit për ekzistencën e këtij veprimi juridik, vlerën e deklaruar të marrë hua, kohën e kthimit të saj, personat të cilët kanë disponuar shumat në favor të bashkëshortit të subjektit, kthimin e kësaj shume si derivat i kësaj marrëdhënieje, mundësinë e këtyre individëve për të krijuar me burime të ligjshme këtë shumë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, mbetën të paprovuara dhe nuk krijuan bindjen e trupit gjykues se kanë ekzistuar në versionin e deklaruar prej subjektit.*
3. Pas njohjes me aktet në fashikull, ankimin dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësoj se huaja prej 30.000 eurosh, që bashkëshorti i subjektit ka marrë nga babai i tij S. P. dhe që ka shërbyer si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament dhe garazh, në Tiranë, nuk duhej të vlerësohej nga Komisioni dhe nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit me pasojën e deklaratimit të pamjaftueshëm, sipas nenit 33/5/b të ligjit nr. 84/2016, duke përbërë shkak për të dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas nenit 61/3 të po këtij ligji. Arsyetimin tim e bazoj në argumentet sa më poshtë.
  - 3.1. Babai i personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit (bashkëshortit) është cilësuar nga Komisioni dhe nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit si person tjetër i lidhur, për shkak të huasë dhënë të birit përpara lidhjes së martesës ligjore me subjektin e rivlerësimit më 08.02.2006.
  - 3.2. Huaja i është dhënë bashkëshortit të subjektit, nga babai i tij, nën një marrëdhënie të posaçme atë e bir (pa qenë nevoja që të dokumentohej me një akt të posaçëm në kohën e dhënies), pasi ky i fundit kishte porositur apartamentin dhe garazhin me anë të kontratës së sipërmarrjes në mars të vitit 2004, pra, qartësisht shumë kohë përpara se të lidhej martesa ligjore me subjektin e rivlerësimit.
  - 3.3. Nënshkrimi i kontratës së huasë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., më datë 14.2.2006, ndërmjet vjehrrit dhe bashkëshortit, vetëm pak ditë pas lidhjes së martesës ligjore të subjektit, kur kishin lindur marrëdhënie të reja në kuptim të Kodit të Familjes, ka shërbyer për të garantuar kthimin e huasë nga ana e bashkëshortit të subjektit familjes së tij të origjinës, sipas afatit 5-vjeçar të përcaktuar në kontratë (edhe pse ky afat nuk rezulton të jetë përmbushur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit). Po sipas situatës faktike, rezulton e provuar që *de facto* efektet e kësaj kontrate ishin

dhënë që në vitin 2005, kur bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e kishte paguar shumën prej 30.000 eurosh, si një nga këstet e apartamentit, sipas kontratës së sipërmarrjes.

**3.4.** Lidhur me konkluzionin e Kolegjit, në paragrafin 19.39<sup>105</sup> të këtij vendimi, sa u përket rrethanave që janë analizuar në lidhje me huanë, të shprehura në mënyrë të përmbledhur në këtë paragraf, ndaj këtë qëndrim të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues:

**3.4.1.** Provohet nga deklaratat *vetting* dhe nga deklarimi për herë të parë i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në vitin 2006 se pasuritë apartament dhe garazh, sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 15.03.2004, janë pasuri individuale të bashkëshortit, të krijuara para martesës dhe përgjegjësinë për shlyerjen e detyrimeve të marra e kishte vetëm bashkëshorti si person i lidhur.

**3.4.2.** Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë bërë një deklaram të saktë dhe të detajuar të kontratës së huasë në deklaratën *vetting*, lidhur me faktin që në këtë deklaratë rezulton të jetë shtuar vëllai i bashkëshortit si huadhënës në vlerën prej 20.000 eurosh, ndërsa në kontratën e huasë dhe deklarimet në vite është përcaktuar si huadhënës vetëm babai i bashkëshortit të subjektit, se, duke mbajtur në konsideratë se nga aktet në dosjen e Komisionit rezulton që në atë periudhë babai, nëna dhe vëllai i bashkëshortit kanë qenë në një ekonomi të përbashkët familjare. Gjithashtu, rezulton që në vitet 2000 – 2004 (dhe më pas) vëllai i bashkëshortit të subjektit ka qenë emigrant në Itali dhe ka krijuar të ardhura duke kontribuar në familjen e origjinës.

**3.4.3.** Sa i përket analizës së detajuar të kryer nga Komisioni dhe Kolegji, për mundësinë e babait të bashkëshortit dhe familjes së tij (nënës dhe vëllait), për të krijuar të ardhura të ligjshme, sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, për shumën e dhënë hua prej 30.000 eurosh, vlerësoj se ky kontroll nuk duhej të ishte bërë, për sa kohë që huaja e dhënë deri në fillim të vitit 2005 nuk afekton subjektin e rivlerësimit dhe, si rrjedhojë, babai i bashkëshortit nuk duhet të konsiderohet person tjetër i lidhur, në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016. Sikurse konstatohet nga aktet në fashikull, subjekti në atë kohë ishte ende larg konceptimit të krijimit të lidhjes në martesë ligjore dhe në këtë kuptim subjekti nuk duhet që të ngarkohet me barrën e kontrollit të një pasurie të krijuar përpara martesës<sup>106</sup>, duke tejkaluar qëllimin e rivlerësimit e për të cilën Kolegji ka arsyetuar dhe në vendime të tjera. Pra, dhënia nga shumica e atributit si person tjetër i lidhur i babait të bashkëshortit të subjektit, duke zgjeruar rrethin e subjekteve që i nënshtrohen kontrollit për efekt të rivlerësimit kalimtar, çon në deformim të qëllimit dhe objektit të ligjit nr. 84/2016.

<sup>105</sup> 19.39. Në këtë konkluzion, Kolegji mbajti në konsideratë, një sërë rrethanash të analizuar gjerësisht si më lart, të cilat përmblihen në vijim: i) koha e nënshkrimit të kontratës vetëm pak ditë pas martesës së subjektit; ii) fakti që në kontratën e huasë dhe deklarimet në vite është përcaktuar si huadhënës babai i bashkëshortit dhe në deklaratën *vetting* shtohet si kontribuues edhe vëllai i tij madje në vlerën 20.000 euro që përfaqëson 2/3 e gjithë shumës, element që do të duhej të ndryshonte edhe përcaktimin mbi titullarin e marrëdhënies; iii) pamundësinë e babait të bashkëshortit që të krijonte me të ardhura të ligjshme sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016 të gjithë shumën e dhënë hua prej 30.000 euro; iv) moskthimin e shumës së huas jo vetëm sipas përcaktimit të kontratës brenda 5 viteve por edhe në tejkallim të paarsyeshëm e të pabesueshëm të këtij afati dhe mundësimin e këtij veprimi vetëm me nisjen e hetimit administrativ në funksion të procesit të rivlerësimit; v) mosprovueshmërinë e motiveve që subjekti ka deklaruar për të justifikuar kthimin me vonesë të huasë pikërisht në vitin 2019 që lidhen me nevojën për likuiditet të vëllait të bashkëshortit, kur kjo nevojë nuk rezulton e materializuar me transferimin e parave në favor të tij; vi) krijimin e kësaj marrëdhënie për financimin e pasurisë në të cilën subjekti ka banesën e saj familjare, në kufij të paqartë kohorë e që duken se ndërthuren me periudha në të cilat, subjekti natyrshëm mund të ketë filluar të ndërtojë një të ardhme familjare me bashkëshortin, përfshirë edhe atë ekonomike; vii) pamundësia për të ndërtuar sipas rrethanave që kanë rezultuar nga hetimi një tablo të qartë lidhur me këtë financim, (nëse kanë ndikuar të ardhurat e subjektit apo të bashkëshortit të paprovuara për financimin e apartamentit) [...].

<sup>106</sup> Vendimet nr. 15/2021 dhe nr. 19/2022 të Kolegjit.

3.4.4. Në referim të arsyetimit në paragrafin e mësipërm, vlerësoj se mungon relevanca e analizimit në vendim të konkluzionit lidhur me moskthimin e shumës së huasë, në tejkalim thuajse dyfish të afatit kohor 5-vjeçar të përcaktuar në kontratë dhe shlyerjen e saj më 15.07.2019, rreth kohës së fillimit të hetimit administrativ në funksion të procesit të rivlerësimit (më 16.12.2019)<sup>107</sup>, duke e çuar në tejkalim të kontrollit për rivlerësimin e kësaj pasurie. Por nga ana tjetër, tejkalimi i afatit pesëvjeçar nuk mund të shërbejë si argument për të penalizuar subjektin e rivlerësimit, për sa kohë kjo gjë nuk është bërë nga huadhënësi, sipas mënyrës së parashikuar në kontratën e huasë mes palëve<sup>108</sup>.

3.4.5. Në lidhje me analizën e shumicës për mosprovueshmërinë e motiveve që subjekti ka deklaruar për të justifikuar kthimin me vonesë të huasë, kufijtë e paqartë kohorë kur subjekti mund të ketë filluar të ndërtojë një të ardhme familjare me bashkëshortin dhe pamundësinë për të ndërtuar një tablo të qartë lidhur me këtë financim<sup>109</sup>, vlerësoj se në të njëjtën linjë qëndrimi të shprehur më lart, thellimi në këto argumente nuk i përgjigjet qëllimit të rivlerësimit, për sa kohë që nuk janë relevante për kontrollin e ligjshmërisë së shumës prej 30.000 eurosh të dhënë hua nga babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

4. Lidhur me qëndrimin e shumicës së trupit gjykues të Kolegjit për moskonsiderimin e të ardhurave të siguruara nga puna e bashkëshortit me shërbimet e përkthimit, që gjejnë pasqyrim në analizën financiare të viteve 2003 – 2008, sipas Komisionit dhe të konfirmuar nga Kolegji, që korrespondojnë me të ardhura të krijuara nga puna përpara lidhjes së martesës ligjore, si dhe të ardhurat e krijuara pas martesës, ndaj qëndrim të ndryshëm si më poshtë.

4.1. Sa u përket të ardhurave të personit të lidhur (bashkëshortit) të subjektit të rivlerësimit, të krijuara në periudhën para martesë (1997 – 2005), e që kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë apartament dhe garazh, në Tiranë, referuar jurisprudencës së Kolegjit, jam shprehur për konsiderimin e tyre, pa iu nënshtruar kontrollit të ligjshmërisë nën regjimin e ligjit nr. 84/2016, duke mos e vendosur subjektin në pamundësi për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të bashkëshortit të krijuara para martesë e duke i ngarkuar në mënyrë joproporcionale një barrë prove që e kishte të pamundur për ta përmbysur.

4.2. Në vlerësimin tim, ngarkimi i subjektit me këtë barrë prove është joproporcional e në tejkalim të jurisprudencës së krijuar në Kolegji, referuar më lart, si dhe interpretimit në kuptimin literal të parashikimit ligjor të nenit 3, pika 13<sup>110</sup> e ligjit nr. 84/2016, ku personat e lidhur (bashkëshorti)

---

<sup>107</sup> Nga aktet në dosjen e Komisionit, konstatoj se rezulton i besueshëm shpjegimi i subjektit të rivlerësimit që huaja nuk është kërkuar nga babai, sepse prindërit e bashkëshortit kanë jetuar së bashku me subjektin dhe personin e lidhur për një periudhë të gjatë kohore në Tiranë (2007 – 2015), duke i ndihmuar në mbajtjen dhe rritjen e fëmijëve, për shkak se subjekti i rivlerësimit kishte largësi me vendin e punës, si dhe mungesa e dijenisë së subjektit se çfarë kishte bërë vjeçri me këtë shumë pas transferimit të saj nga llogaria e bashkëshortit në "Raiffeisen Bank" në llogari të babait të tij në BKT (vlera në lekë prej 3.660.000 lekësh).

<sup>108</sup> Kontrata notoriale e huasë me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.02.2006, lidhur përpara notere T. M., parashikon se: "Në rast se nuk do respektohet afati nga huamarrësi, huadhënësi kishte të drejtë të vendoste dorë mbi çdo lloj pronësie të huamarrësit, të luajtshme apo të paluajtshme".

<sup>109</sup> Referuar shkronjave (v), (vi) dhe (vii), të paragrafit 19.39 të këtij vendimi.

<sup>110</sup> Neni 3, pika 13 parashikon se: "Person i lidhur", është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, për periudhën e rivlerësimit".

deklarojnë për pasuritë e krijuara për periudhën e rivlerësimit, për kohën që kanë qenë të lidhur me martesë ligjore ose bashkëjetesë të deklaruar për periudhën e rivlerësimit.

**4.3.** Rezulton e provuar që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit pjesën më të madhe të të ardhurave të tij ta ketë siguruar përmes ofrimit të shërbimit të përkthimit të gjuhës gjermane, për të cilat ai është shpërblyer sipas rastit nga: institucione shtetërore vendase e të huaja, institucione ndërkombëtare në kuadër të projekteve të ndryshme të lidhura me shtetin shqiptar, institucione arsimore jopublike, organizata jofitimprurëse, agjenci/projekte të ndryshme, pranë ambasadave të regjistruara në Shqipëri<sup>111</sup>, në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, konkretisht, me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 33<sup>112</sup> i tij. Bazuar në këtë parashikim ligjor, duke qenë se mbajtja e tatimit në burim është një detyrim i organit që kryen pagesën, organet e rivlerësimit duhet të konsiderojnë si të ardhura nga burime të ligjshme të ardhurat që krijohen për shkak të ligjit<sup>113</sup>. Në rastin konkret të gjitha të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit që janë siguruar nga pagesat<sup>114</sup> e përftuara nga subjekte/institucione/organizata konform nenit 33 të ligjit nr. 8438/1998 dhe që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i provon me deklarin në deklaratat periodike vjetore, si dhe me faturat e pagesave të kryera në favor të tij, janë të ligjshme dhe duhet të ishin bërë pjesë e analizës financiare të viteve 2003 – 2008.

**4.4.** Rezulton e provuar, gjithashtu, që të ardhurat e mësipërme, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit t’i ketë deklaruar rregullisht, me saktësi e me korrektësi në deklaratat periodike vjetore nga viti 2006 e në vijimësi (larg në kohë dhe i pa ndikuar nga procesi i rivlerësimit), por që në pamundësi objektive<sup>115</sup>, sipas pretendimit të subjektit referuar nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, një pjesë të tyre nuk ka arritur që t’i shoqërojë me dokumentacion tjetër provues për pagimin, (mbajtjen në burim), të tatimit mbi të ardhurat e siguruar nga shërbimi i përkthimit i ofruar prej tij.

---

<sup>111</sup> Shërbime përkthimi për: GTZ (“German Agency for Technical Cooperation”), “Ministrinë e Brendshme Austriake- Byroja Federale për Hetimet Kriminale në Austri, Sektori i Menaxhimit të Projekteve, (Programi trevjeçar – Emigracioni Ilegal 2006-2009 dhe Projekti ILECU në vitet 2009-2010, “Agjencia Austriake për Zhvillim”, Liceu “{\*\*\*}”, me NIPT {\*\*\*} (2006), Fondacioni “K-Education”, Agjencia Turistike “{\*\*\*}”, subjekt tatimor i regjistruar me NIPT {\*\*\*}, Ministria e Arsimit Austriake, projekti “Kultur Kontakt” (2007), Agjencia Turistike “{\*\*\*}”, person fizik A. Y. (me emrin tregtar “{\*\*\*}” me NIPT {\*\*\*}, ku janë konsideruar pjesërisht të ardhurat e krijuara nga kontratat me këtë person fizik.

<sup>112</sup> Neni 33 – “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” përcakton: “1. Të gjithë personat residentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë, sipas shkallëve të mëposhtme: 1.1. 15 për qind për: a) interesat dhe pagesat e ngjashme me to; b) pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale; c) pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet e konsulencës, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit; ç) pagesat për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues; d) pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikëqyrëse që lidhen me to; dh) pagesat për qiratë; e) pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve, përfshirë pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artistë ose sportistë apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre; ë) të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë. 1.2. 8 për qind për: a) dividendët; b) ndarjet e fitimit”.

<sup>113</sup> Konkretisht, referuar vendimit, një shembull si argument për këtë çështje: “Mbajtja e tatimit në burim nga Ministria e Drejtësisë tregon se zbatimi korrekt i neneve 33 e 35 të ligjit nr. 8438/1998 detyron institucionin apo subjektin që kryen pagesën që për shërbimin e marrë nga individi të mbajë tatimin në burim nga të ardhurat që i paguan individit. Ligji ka qenë i detyrueshëm për zbatim në të njëjtën mënyrë për të gjithë subjektet që kanë kryer pagesën. DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. 14877/1, datë 29.06.2020, konfirmon zbatimin e ligjit me korrektësi nga Ministria e Drejtësisë”.

<sup>114</sup> Një pjesë e pagesave janë me dokument të thjeshtë (fatura) dhe një pjesë e tyre me dokument bankar.

<sup>115</sup> Pamundësia objektive konsiston në faktin që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka mundur që të sigurojë dokumente që provojnë pagimin e tatimit për të ardhurat për një pjesë të të ardhurave të krijuara para dhe pas martesë, për të cilat ka kaluar afati 5-vjeçar për ruajtjen e tyre.

5. Nga ankimi i subjektit të rivlerësimit, konstatohet më së shumti se, në përpjekje për të siguruar dokumentacion provues për të justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave të bashkëshortit, është gjendur përpara faktit të pamundësisë objektive për të provuar pagimin e detyrimeve tatimore, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Si në Komision edhe në Kolegj nuk u gjet i bazuar pretendimi i subjektit për të zbatuar nenin 32, pika 2 të ligjit. Në kuadër të provimit të pretendimeve dhe mungesës së dokumentacionit provues të rregulluar nga neni 32/2 i ligjit, mendoj se Kolegji mund të kishte vlerësuar dhënien e mundësisë për subjektin e rivlerësimit për verifikimin e pretendimeve për plotësimin e kushteve, sipas nenit 32/2 të ligjit. Aneksi i Kushtetutës në nenin Ç dhe neni 52 i ligjit nr. 84/2016 parashikojnë se barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për procesin e rivlerësimit dhe, në këtë kuptim, zbatimi i ligjit nga organet e rivlerësimit duhet t'i krijojë kushtet subjektit të rivlerësimit që ta ezauroj në mënyrë shteruese mundësinë për të përmbysur barrën e provës duke garantuar një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Në rast se subjektit do t'i ishte krijuar mundësia për të provuar pretendimet e paraqitura në ankim dhe pamundësinë objektive dhe shteruese të gjetjes së dokumentacionit<sup>116</sup>, Kolegji mund të kishte vazhduar me vlerësimin e rrethanave dhe gjetjeve për subjektin.
6. Duke pasur parasysh rrethanat e zhvillimit shoqëror në gjithë këto vite në Shqipëri, informalitetin e marrëdhënieve financiare, përcaktimet ligjore që rregullojnë mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit dhe kohëzgjatjen e kësaj mbajtjeje, mendoj se për subjektin e rivlerësimit duhej të ezaurohej në mënyrë shteruese krijimi dhe dhënia e mundësive për të provuar pretendimet, sipas parashikimit të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016. Vlerësoj se pavarësisht se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk arritën që me provat e sjella dhe me shkresat zyrtare të organeve tatimore të mund të konfirmonin pagimin e tatimit për periudha më të gjata se 5 vite, deklaratat e rregullta dhe korrekte në deklaratat periodike nga ana e bashkëshortit të subjektit për shërbimin e përkthimit, të ofruara në mënyrë permanente ndaj një numri të madh institucionesh/organizatash/entitetesh vendase dhe të huaja duhet të kishin krijuar bindje të shumica se nuk kemi të bëjmë me përpjekje për të shmangur detyrimin e pagimit të tatimit mbi të ardhurat.

**GJYQTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

---

<sup>116</sup> Vendimi nr. 17/2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.